VENDIM
Nr. 551, datë 31.7.2019

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PESTË DHE TË GJASHTË PERIODIK KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E KONVENTËS SË OKB-së "PËR TË DREJTAT E FËMIJËS" DHE TË DY PROTOKOLLEVE OPSIONALE TË SAJ "PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKT TË ARMATOSUR" DHE "PËR SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN E FËMIJËVE DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 7531, datë 11.12.1991, "Për ratifikimin e konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijës"", të ligjit nr. 9834, datë 22.11.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë", dhe të ligjit nr. 9833, datë 22.11.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të pestë dhe të gjashtë periodik kombëtar për zbatimin e konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijës" dhe të dy protokolleve opsionale të saj "Për përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur" dhe "Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KOMITETI PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

RAPORTI I PESTË DHE I GJASHTË PERIODIK I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI ZBATIMIN E KONVENTËS SË OKB-SË "PËR TË DREJTAT E FËMIJËS" DHE DY PROTOKOLLEVE OPSIONALE TË SAJ: "MBI PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKT TË ARMATOSUR", "MBI SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN E FËMIJËVE DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË".

A. Hyrje

1. Republika e Shqipërisë ka nderin të paraqesë raportin e pestë dhe të gjashtë periodik para Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, i cili përmban informacione për ndjekjen e Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit të Konventës në lidhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe dy Protokollet Opsionale (PO): "Për Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura" (POPFKA) dhe "Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijë dhe Pornografinë me Fëmijë" (POSHFPPF). Raporti paraqet informacion mbi masat e ndërmarra për zbatimin e dispozitave të Konventës, Protokolleve të saj dhe zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit të

Konventës[1] dhe Vëzhgimet Përfundimtare mbi Protokollet e Konventës (KDF)[2] gjatë periudhës janar 2013 – prill 2019.

2. Raporti është hartuar nga Grupi Ndërministror i Punës, i ngritur në vitin 2017, mbështetur në urdhrin e Kryeministrit nr.112, datë 5.3.2014 "Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut". Grupi ndërinstitucional i punës u drejtua bashkërisht nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHMDF). Institucionet që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij Raporti janë: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, si dhe institucionet në varësi të institucioneve qendrore si: Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijës; Instituti i Shëndetit Publik, Shërbimi Social Shtetëror; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve etj. Institucionet e pavarura që kanë dhe kontribut në hartimin e Raportit janë: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave dhe të Drejtën e Informimit, Autoriteti i Mediave Audio-Vizuale.

3. Në qershor të vitit 2018, u zhvillua një workshop për Raportimin pranë Komitetit për të Drejtat e Fëmijës me qëllim përmirësimin dhe konsolidimin e procesit. Procesi i konsultimit, i zhvilluar në gusht dhe shtator të vitit 2018, synoi përftimin e pikëpamjeve dhe mendimeve të fëmijëve dhe shoqërisë civile[3]. Projekt raporti i është diskutuar në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Vendore në muajin dhjetor 2018 me qëllim informimin mbi këtë proces dhe marrjen e kontributeve jo vetëm në nivel qendror, por edhe vendor. Në muajin shkurt 2019 projekt raporti u diskutua në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Në muajin prill 2019 Grupi i deputetëve "Miqtë e fëmijëve", në drejtimin e Kryetarit të Kuvendit shqyrtoi projekt Raportin e pestë periodik të qeverisë shqiptare mbi zbatimin e Konventës së OKB për të drejtat e fëmijëve.

4. Raporti është përgatitur gjatë një periudhe kur po ndërmerreshin ndryshime të rëndësishme strukturore dhe ishte përshpejtuar ecuria në fushën e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht në aspektin legjislativ dhe politik. Ky proces përfshin rishikimin dhe miratimin e legjislacionit dhe strategjive gjithëpërfshirëse në fushën e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes sociale dhe drejtësisë për të miturit, të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri në vitet e ardhshme.

5. Raporti mbi zbatimin e Konventës dhe dy Protokolleve opsionale të saj është miratuar me VKM nr. datë...

B. MASAT E PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT

Kuadri ligjor[4]

6. Gjatë periudhës së raportimit, janë miratuar dhe ndryshuar disa ligje për forcimin e kuadrit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", që u miratua dhe hyri në fuqi në qershor të vitit 2017, u mbështet në ligjin e shfuqizuar nr. 10347/2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës". Ligji i ri (18/2017) parashikon detyrat dhe forcon institucionet, strukturat dhe mekanizmat që do të garantojnë dhe do të sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja dhe shteti. Ligji zgjeron horizontin e të drejtave të fëmijëve, ndërkohë që thekson forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, duke përfshirë edhe nivelin vendor në veçanti. Ligji

---

[1] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit mbi zbatimin e Konventës "Për të drejtat e fëmijës", pas shqyrtimit të zbatimit të Konventës, 5 tetor 2012 (CRC/C/ALB/CO/2–4).

[2] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit mbi zbatimin e Protokolleve: CRC/C/OPSC/ALB/1; CRC/C/OPAC/ALB/1, 6 dhjetor 2012.

[3] Aneksi 3 bashkëlidhur këtij Raporti.

[4] Rekomandimi 10 i vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4.

parashikon ndërveprim ndërmjet shërbimeve për fëmijët dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale, si dhe bashkërendim me ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe me kuadrin e ri ligjor dhe administrativ të krijuar nga ndarja e re administrative territoriale në vend.

7. Ligji është përafruar me KDF-në dhe mund të krahasohet me standardet më të përparuara evropiane në këtë fushë. Kuadri rregullator për zbatimin e tij u përgatit në fillim të vitit 2018, duke miratuar 18 akte nënligjore dhe akte të tjera ligjore, që do të miratohen gjatë muajve në vijim.

8. Ligji nr. 18/2017 u hartua pas një procesi të gjatë konsultimesh me të gjitha palët përkatëse të interesit dhe u mbështet në vlerësimet e situatës së përgjithshme të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, si dhe nga boshllëqet në zbatimin e ligjit nr. 10347/2010.

9. Ligji i ri nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë" rregullon shërbimet e kujdesit shoqëror, duke nxitur mirëqenien dhe përfshirjen sociale të personave në nevojë dhe familjeve të tyre në kujdesin shoqëror.

10. Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018, forcon konsiderueshëm sistemin e drejtësisë dhe e bashkërendon me KDF-në dhe me standarde dhe norma të tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin mbështetur në interesin e tyre më të lartë. Në zbatim të Kodit janë hartuar shtatë akte nënligjore dhe pesë urdhra ministrorë.

11. Ligji nr. 7895/1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i janë bërë disa shtesa dhe ndryshime, duke përfshirë disa vepra penale, i cili parashikon dënime më të rënda në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë abuzimin seksual dhe shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.

12. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" u ndryshua për të forcuar veprimet në fushën e dhunës në familje dhe trafikimit, si dhe masave mbrojtëse për fëmijët dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

13. Ndryshimet e tjera përkatëse përfshijnë ndryshimet në vitin 2015 të ligjit nr. 9062/2003 "Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë" (rishikimi i deklarimit të braktisjes së fëmijës", ligjit nr. 7961/1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (rritja e moshës së punës deri në 16 vjeç dhe disa masa mbrojtëse për fëmijët që punojnë), ligjit nr. 7905/1995 "Kodi i Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë". Ligji nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" u miratua në vitin 2018, i cili parashikon disa dispozita për mundësimin e aksesit të fëmijëve në situata të cenueshme në programet e strehimit social, si dhe ligji nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti", që synon ofrimin e shërbimeve profesionale që mundësojnë ndihmë ligjore për grupet e cenueshme, duke përfshirë fëmijët në kontakt me ligjin dhe fëmijët që janë nën kujdes alternativ.

Politikat dhe strategjitë gjithëpërfshirëse[5]

14. Në vitin 2017, u miratua Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020 (AKDF), e cila përbëhet nga tri shtylla strategjike: (i) mirëqeverisja për promovimin, zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me qëllim forcimin e kuadrit rregullator dhe institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve; (ii) eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve; dhe (iii) sistemet dhe shërbimet e përshtatshme për fëmijët dhe adoleshentët, kryesisht zhvillimi dhe arsimi, drejtësia, shëndeti dhe ushqyerja, si dhe mbrojtja sociale me qëllim identifikimin e masave kyçe të strategjive sektoriale që shënojnë ecuri kundrejt zbatimit të të drejtave të fëmijëve. Për këtë arsye, agjenda është shumësektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe përfshin të gjitha planet e tjera të veprimit sektoriale lidhur me fëmijët.

15. Axhenda u hartua me pjesëmarrjen e ministrive të linjës, aktorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe fëmijëve. Axhenda është hartuar në përputhje me KDF-në, Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit të KDF-së 2012, Strategjinë e Këshillit të Evropës (KE)

---

[5] Rekomandimi 12 i Vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4.

për të Drejtat e Fëmijës 2012 –2015 dhe 2016 – 2021, si dhe me Axhendën e Bashkimit Evropian (BE) për të Drejtat e Fëmijës. Krahas monitorimit të vazhdueshëm, rishikimi afatmesëm i zbatimit të Axhendës do të kryhet në fund të vitit 2018, i ndjekur nga rishikimi i planit të veprimit për vitet pasardhëse të zbatimit të AKDF-së deri në vitin 2020.

16. Axhenda mbështetet në arritjet e Planit të Veprimit për Fëmijët 2012 – 2015 (PVF 2012 – 2015) dhe në mësimet e nxjerra nga zbatimi i tij. Në vitin 2015, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) kreu një vlerësim të zbatimit të PVF 2012 – 2015, së bashku me një analizë të gjerë të situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Sipas raportit të vlerësimit, mesatarisht 62% e masave të parashikuara në PVF ishin arritur ose ishin nën zbatim për shkak të natyrës së tyre afatgjatë (70% e masave në seksionin e mbrojtjes, përfshirjes sociale dhe shëndetit, 60% e masave në seksionin e arsimit dhe vetëm 35% e masave në fushën e drejtësisë për të miturit). Gjetjet e raportit dhe rekomandimet parësore shërbyen si bazë dhe u pasqyruan në AKDF.

17. Strategjia për Mbrojtjen Sociale 2015–2020 i integron këto tri reforma madhore të ndërmarra nga Qeveria e Shqipërisë me qëllim ngritjen e një sistemi të konsoliduar dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale, për të luftuar pabarazitë ekonomike sociale dhe për të mbrojtur të gjithë personat në nevojë. Strategjia parashikon transformimin e ndihmës ekonomike në një skemë aktive të riintegrimit social, rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, ndërhyrjet dhe riintegrimin e fëmijëve në familje dhe komunitete, duke iu ofruar kujdes të veçantë jetimëve socialë ose biologjikë, duke i dhënë përparësi të madhe interesit më të lartë të fëmijës dhe duke ofruar shërbime të integruara.

18. Në vijim të miratimit të Kodit të Drejtësisë Penale për Fëmijë 2017, me vendimin nr. 541, datë 19.9.2018 të Këshillit të Ministrave, u miratua "Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018–2021". Vizioni i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit është Përmirësimi i drejtësisë për të mitur që garanton një drejtësi miqësore për fëmijë dhe që mbron interesin më të lartë të tyre, përbën vizionin e kësaj strategjie. Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2018–2021 është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktima, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore, kryesisht atyre penale, nëpërmjet zbatimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtave të fëmijëve. PKV-ja e zbërthen Kodin në masa dhe veprimtari konkrete për të gjitha institucionet përgjegjëse.

19. Gjatë periudhës së raportimit, janë miratuar disa strategji dhe plane të tjera veprimi në disa fusha, si në atë të strehimit social, shëndetit riprodhues dhe seksual, luftës kundër trafikimit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe integrimit të komunitetit rom dhe egjiptian, me qëllim rritjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Strategjitë sektoriale janë koordinuar me Agjencinë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës.

Bashkërendimi[6]

20. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" rivlerëson dhe rishikon strukturat dhe mekanizmat e bashkërendimit në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor dhe qendror në përputhje me ligjin nr. 10347/2010. Ai përcakton sërish përgjegjësitë e tyre dhe forcon ndërveprimin dhe bashkëpunimin për garantimin e të drejtave të fëmijëve.

21. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF), i ngritur në vitin 2011, është organi këshillimor për hartimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha fushat, duke përfshirë drejtësinë, shërbimet sociale, arsimin, shëndetësinë dhe kulturën. KKDMF-ja përbëhet nga nëntë anëtarë, që vijnë nga institucionet qeveritare, joqeveritare dhe të pavarura. Në gjysmën e parë të vitit 2018, KKDMF-ja zhvilloi dy mbledhje sipas ligjit të ri nr. 18/2018, në kuadër të miratimit të vendimit të Këshillit të

[6] Rekomandimi 14 i Vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4.

Ministrave (VKM), nr. 54.2018 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës". Rregulloret e reja dhe ligji nr. 18/2017 krijuan një shtysë për mbledhje më të shpeshta të KKDMF-së, duke siguruar pjesëmarrje më të madhe të fëmijëve si vëzhgues.

22. Ministria përgjegjës për bashkërendimin e punës në lidhje me problematikat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, aktualisht është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale autoriteti përgjegjës kryesor për bashkërendimin dhe monitorimin e ecurisë dhe zbatimit të politikave dhe masave përkatëse për zbatimin e ligjeve, strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për fëmijët, si dhe detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë. Gjithashtu, është përgjegjës për hartimin e raporteve përkatëse, monitorimin e punës së ASHMDF-së dhe miratimin e raportit të saj vjetor.

23. ASHMDF-ja, e krijuar në vitin 2011, është një institucion nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për koordinimin e punës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve. Me ligjin e ri (18/2017), është rishikuar edhe autoriteti i ASHMDF-së, duke i caktuar asaj përgjegjësi të qarta në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. ASHMDF-ja është përgjegjëse edhe për bashkërendimin e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës sipas politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, si dhe për monitorimin e zbatimit të PVF-së 2012–2015 dhe PVF-së 2017–2020, si dhe menaxhon dhe mbledh të dhëna statistikore për të drejtat e fëmijëve.

24. ASHMDF-ja ka drejtë të kontrollojë cilësinë e shërbimeve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe të analizojë nevojën për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Baza ligjore e ASHMDF-së për vendosjen e sanksioneve në rast mospërmbushjeje të detyrimeve nga ana e institucioneve përgjegjëse është forcuar me miratimin e VKM-së nr. 91/2018 (zëvendësimi i VKM-së së mëparshme për këtë fushë), që rregullon procedurat e kontrolleve dhe sanksioneve të vendosura nga Agjencia. Deri më tani, nuk është marrë asnjë masë sipas këtij mekanizmi, si rrjedhojë e mangësive ligjore në VKM-në e mëparshme.

25. Agjencia përbëhet nga sektorë të Mbrojtjes dhe Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe të Statistikave dhe Bashkërendimit, dhe që prej vitit 2013 ka shtatë punonjës. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe nga donatorë të ndryshëm dhe buxheti i saj është në rritje nga 7.140.000 lekë në vitin 2012 lekë në 12.400.000 lekë në vitin 2018. Megjithatë, me ligjin nr. 18/2017, Agjencisë iu shtuan disa përgjegjësi të reja, të cilat duhet të mbështetet nga alokimi i burimeve të përshtatshme[7].

26. Edhe ligji nr. 18/2017 parashikon ekzistencën e strukturave të ngritura nga ligji i mëparshëm në nivel vendor, si p.sh. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), si struktura përgjegjëse për bashkërendimin dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe menaxhimin e rastit, në bashkëpunim me një sërë palësh interesi nga sektorë të ndryshëm në nivel vendor. Në çdo bashki dhe njësi administrative me më shumë se 3.000 fëmijë ngrihet Grupi Teknik Ndërsektorial i Posaçëm (GTN), për adresimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve. Ky grup përbëhet nga përfaqësues të policisë, të shërbimeve sociale, të arsimit, të shëndetësisë dhe drejtësisë, OJF-ve dhe persona të tjerë, që kanë informacion për situatën e fëmijëve. VKM nr. 353, datë 12.6.2018, "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative, qartëson rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të GTS-së, të cilat pritet të forcojnë koordinimin në nivel vendor[8].

27. Udhëzimi nr. 10/2015 "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës" përcakton rolin e secilit aktor në procesin e mbrojtjes së fëmijëve, dhe ofron udhëzimet e nevojshme për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe paraqet kuadrin ligjor në mbrojtje të tyre. Është miratuar VKM nr. 578, datë 3.10.2018, "Për

[7] Referim pikat 103, 110 të Raportit
[8] Referim pikat 112 dhe 118 të Raportit.

procedurat e referimit dhe të menaxhimit të rastit, hartimin e përmbajtjes së planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes". Ky vendim është një nga aktet nënligjore më të rëndësishëm dhe thelbësor për realizimin dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, pasi adreson procese, instrumente dhe mekanizma, që qëndrojnë në bazë të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, siç janë procedurat e referimit, hartimi dhe zbatimi i Planit të Mbrojtjes së Fëmijës, marrja dhe vënia në zbatim e masave të mbrojtjes. Për herë të parë ky vendim parashikon mënyrën e financimit të ndërhyrjeve dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës. Vendimi paraqet rregullat dhe procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.

Shpërndarja e burimeve[9]

28. Me planifikimin e AKDF-së 2017–2020 u bë vlerësimi i përgjithshëm i nevojave buxhetore të fëmijëve. Përllogaritja e buxhetit të nevojshëm u krye për secilën veprimtari, objektiv specifik dhe qëllim strategjik, dhe arrinte vlerën e përgjithshme prej 2.363.099,369 lekë. Burimet kryesore të financimit të zbatimit të Axhendës janë buxheti i qeverisë vendore dhe qendrore (64,4%) dhe donatorët (26,2%). Deficiti/hendeku buxhetor (9,4% në periudhën e planifikimit) i nënshtrohet diskutimeve me donatorët, ndërsa vlerësimi afatmesëm, i parashikuar për fundin e vitit 2018, do të sigurojë një panoramë të përditësuar të menaxhimit financiar dhe të shpenzimeve për zbatimin e tij.

29. Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit për Drejtësinë për të Mitur 2018–2021 përllogariten në vlerën 681.335.963 lekë (rreth 5,1 milionë euro), me hendekun financiar për zbatimin e veprimtarive me rreth 12,3 për qind. Krahas këtyre, janë kryer edhe vlerësimet e fondeve të nevojshme për strategji të tjera kombëtare, që përfshijnë masat përkatëse për fëmijët (p.sh. shëndeti seksual dhe riprodhues, mbrojtja sociale, arsimi etj.). Shumica e strategjive dhe PKV-ve përmbajnë masa që synojnë fëmijët në situata të pafavorizuara dhe të cenueshme, për të cilët parashikohen zërat përkatës të buxhetit.

30. Megjithëse përqindja e PBB-së së alokuar për arsimin po ulet si pasojë e numrit më të ulët të nxënësve të regjistruar, vlera e alokuar për nxënës është thuajse dyfishuar gjatë periudhës së raportimit. Kostoja vjetore mesatare në vitin 2012 ishte 53.050 lekë për nxënës, ndërsa në vitin 2018 u rrit në 89.421 lekë për nxënës. Fondet e alokuara institucioneve arsimore ndjekin parimin lekë për nxënës. Fëmijët në situata të pafavorizuara dhe të cenueshme janë përfitues të masave të diskriminimit pozitiv, që rrjedhin nga akte specifike që rregullojnë ofrimin e librave shkollorë, transportit, akomodimit falas, si dhe sistemimit dhe shërbimeve pa pagesë në institucione të specializuara (p.sh., fëmijët me aftësi të kufizuara që frekuentojnë shkolla speciale).

31. Investimet në kujdesin shëndetësor (si % e PBB-së) kanë mbetur relativisht të pandryshuara gjatë periudhës së raportimit (2013, 2,69%; 2017, 2,84%).

32. Në fushën e kujdesit alternativ, fondet e shpërndara për nëntë institucione publike të kujdesit shoqëror rezidencial (IKSH) kanë qenë relativisht të pandryshuara (2013, 194.270.000 lekë; qershor 2018 233.209.000 lekë). Ndërkohë, fondet e caktuara për familjet kujdestare në dymbëdhjetë qarqet janë rritur (2014, 1.094.000 lekë; qershor 2018 5.411.000 lekë), duke pasqyruar edhe një rritje të numrit të fëmijëve të vendosur në familjet kujdestare/familjet me lidhje gjaku. Edhe fondet e alokuara për fëmijët me statusin e jetimit u rritën (2014, 907.018 lekë; 2017 3.476.376 lekë), duke pasqyruar një rritje të numrit të përgjithshëm të përfituesve të skemës (nga 280 në vitin 2014 në 553 në qershor të vitit 2018), si dhe një rritje të shumës së alokuar për fëmijë (2014 3.239 lekë, qershor 2018 5.440 lekë). Buxheti vjetor i miratuar nga Komiteti Shqiptar i Birësimit për periudhën e raportimit ishte mesatarisht 92.208.540 lekë.

[9] Rekomandimi 16 i Vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4.

33. Alokimet për Qendrën Kombëtare të Pritjes për Viktimat e Dhunës në Familje (gra dhe fëmijë) thuajse u dyfishua gjatë periudhës së raportimit (12.300 lekë në vitin 2012, 22.190 lekë në vitin 2018), ndërsa fondet për Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës për familjet në situatë të vështirë emergjence për arsye mjedisore ose socioekonomike janë rritur nga 8.600 lekë në vitin 2014, vit i fillimit të veprimtarisë së Qendrës, në 14.430 në vitin 2018. Megjithatë, fondet për Qendrën Kombëtare Pritëse së Viktimave të Trafikimit (gra dhe fëmijë) u ulën gjatë kësaj periudhe, nga 32.465 lekë në vitin 2013 në 22,190 lekë, për shkak të uljes së numrit të përfituesve. Fondi për Koordinatorin Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave është rritur vazhdimisht gjatë periudhës së raportimit.

34. Buxheti i shtetit i alokuar (përmes Shërbimit Social Shtetëror - SHSSH) për vitin 2018 për institucionet e kujdesit shoqëror, që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara (FAK) dhe gratë dhe fëmijët viktima, ishte 29.627 lekë. Bashkitë e përzgjedhura kanë investuar/përfshirë fonde shtesë nga buxhetet e tyre vendore. Megjithatë, gjurmimi i buxhetit në atë nivel vendor mbetet sfidë.

35. Me qëllim adresimin e alokimeve buxhetore për strukturat dhe shërbimet e fëmijëve në nivel vendor, ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" parashikon krijimin e një fondi të veçantë në nivel bashkie. Ky fond do të shërbejë si një mekanizëm i ri financiar për ofrimin e shërbimeve shoqërore të një cilësie më të lartë dhe më të përgjigjshme ndaj nevojave të individëve. Fondi do të bëjë të mundur prokurimin e shërbimeve sociale nga grupet e interesit ose shoqëria civile. Ai pritet të përmirësojë buxhetimin për ofrimin e shërbimeve të kërkuara në nivel vendor, duke përfshirë fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

36. Procesi buxhetor përcaktohet nga Ligji nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", që kërkon publikimin e projektbuxhetit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) në faqen e MFE-së dhe fletoren zyrtare, në çdo fazë të hartimit të tij, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë. Projektligjet në lidhje me proceset e buxhetimit dhe të gjitha informacionet mbështetëse mbi buxhetin publikohen në faqen e MFE-së dhe të Kuvendit të Shqipërisë. Në përgjithësi, të dhënat periodike për shpenzimet buxhetore publikohen në faqet e ministrive dhe të gjithë ministritë e linjës kanë detyrimin të tregohen transparentë me buxhetet dhe shpenzimet e tyre. Transparencë duhet garantuar nga të gjitha institucionet, pavarësisht sfidave që paraqiten.

37. Sistemi aktual ka nevojë për përmirësime për të mundësuar gjurmimin e drejtpërdrejtë të burimeve të shpenzuara për fëmijët dhe të drejtat e tyre, si dhe për të rritur qasjen me pjesëmarrje të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

38. Për adresimin e korrupsionit dhe krimeve përkatëse në të gjithë sektorët, është miratuar Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (2015–2020), si dhe është vijuar me Planet e Veprimit për periudhat 2015–2017 dhe 2018–2020. Strategjia e Rendit Publik 2015–2020 dhe Plani përkatës i Veprimit 2015–2017 përcaktojnë edhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si një ndër përparësitë e Policisë së Shtetit[10]. "Në këtë kuadër, në Drejtoritë Vendore të Policisë janë krijuar Seksione për Hetimin e Korrupsionit, si dhe është rritur numri i puonjësve të policisë pranë këtyre strukturave. Në vitin 2018, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), u krijua Drejtoria Hetimore Qendrore, ku ndër të tjera, fokusi i punës së kësaj strukture është lufta kundër korrupsionit. Njëkohësisht, është bashkëpunuar edhe me Prokurorinë për krijimin e njësive të përbashkëta hetimore (task- forcë). Kjo është pasuar nga një rritje e identifikimit dhe procedimit të veprave penale që kanë lidhje me korrupsionin."

39. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) që prej vitit 2015 ka zbatuar Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Në Kodin e Etikës së Mësuesit dhe në Dispozitat Normative, ndryshuar, përcaktohen masat për parandalimin e korrupsionit në arsim. Çfarëdolloj shkeljeje ose devijimi mund të raportohet në platformën *shqiperiaqeduam.al*. Nuk është raportuar asnjë akuzë për korrupsion në sistemin shkollor. Gjatë periudhës 2002 dhe 2014, rrogat e

[10] Aneksi 2.1.3, bashkëlidhur Raportit.

mësuesve janë dyfishuar dhe kanë ndikuar pozitivisht në standardin e tyre të jetesës, si dhe kanë ulur gjasat për përfshirjen në veprime korruptive.

40. Platforma elektronike e recetave elektronike e-health, sistemi i referimit të pacientëve, menaxhimi i kujdesit personal, si dhe nënshkrimi elektronik i mjekut janë disa nga masat që kontribuojnë në uljen e ndjeshme të niveleve të korrupsionit në këtë fushë.

Mbledhja e të dhënave[11]

41. Falë miratimit të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", janë forcuar proceset e menaxhimit dhe mbledhjes së të dhënave kombëtare, duke përfshirë fushën e të drejtave të fëmijëve. Ky ligj e forcoi rolin e autoritetit koordinues të organit kombëtar të statistikave, Instituti i Statistikave (INSTAT), i cili është përgjegjës për të siguruar se të gjitha agjencitë zyrtare të statistikave përdorin standardet, përkufizimet, klasifikimet dhe metodologjitë e Kombeve të Bashkuara dhe Eurostat-it. Krahas kësaj, ligji iu kërkon agjencive statistikore të paraqesin raporte periodike dhe informacione për ecurinë kundrejt detyrave të ngarkuara.

42. INSTAT-i publikon dokumente të ndryshme që përmbajnë disa tregues të ndarë sipas moshës dhe në përputhje me gjininë, duke përfshirë botimin vjetor "Gra dhe Burra". Studimi Shqiptar Demografik dhe Shëndetësor, i kryer në periudhën 2017–2018 (të dhënat do të publikohen në dhjetor), do të sigurojë një burim të pasur të dhënash, shumica e të cilave do të përdoren për të monitoruar dhe raportuar për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Aktualisht, po mblidhen të dhëna për Studimin Kombëtar për Dhunën në Familje, i planifikuar për t'u kryer çdo katër vjet. Gjithashtu, INSTAT-i po harton një listë të dedikuar treguesish të përqendruar te fëmijët, e cila do të publikohet çdo vit, duke filluar nga viti 2019.

43. ASHMDF-ja mbledh dhe përpunon çdo vit të dhëna statistikore për të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me ministritë e linjës, bashkitë dhe INSTAT-in. Si kërkesë e ligjit nr. 18/2017, është miratuar VKM nr. 636, datë 26.10.2018 "Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendrore vendor. Kjo VKM zëvendëson atë të mëparshmen, dhe autorizon ASHMDF-në të mbledhë dhe publikojë 58 tregues që synojnë fëmijët, të cilët përfaqësojnë një larmi fushash/temash (demografinë, shëndetësinë, ushqyerjen, dhunën, migracionin, punën, varfërinë, arsimin, aksesin në drejtësi, drejtësinë për të mitur). Lista e rishikuar e treguesve përputhet me listën e KDF-së për treguesit e raportimit dhe objektivat strategjike të AKDF-së 2017–2020.

44. Ministria e Drejtësisë në bazë të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, mbledh, përpunon dhe analizon të dhëna statistikore për të dënuarit të mitur, ndarja sipas gjinisë, vepra penale për të cilën dënohen dhe masa e dënimit. Gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, merren të dhëna për gjendjen dhe ndarjen e të dënuarve në IEVP. Nga Drejtoria e Shërbimit të Provës, jepet numri i të dënuarve me alternativat e dënimit me burgim për të mitur. Ministria e Drejtësisë i publikon të gjitha këto të dhëna në Vjetarin Statistikor sipas kapitujve përkatës.

45. Përgjegjësitë e ASHMDF-së përfshijnë mbledhjen e të dhënave për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor dhe mbikëqyrjen e performancës së NJMF-ve, që raportojnë pranë agjencisë çdo tre muaj për punën e tyre në lidhje me menaxhimin e rasteve të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje. Megjithatë, mënyra vertikale e mbledhjes së të dhënave mbetet një sfidë, pasi mungojnë mekanizmat efektivë të raportimit në NJMF. Kjo situatë sjell vështirësi për analizën e të dhënave nga ASHMDF-ja, si dhe për pasqyrimin e situatës reale në terren. Me fuqizimin e aktorëve për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor, pritet edhe forcimi i kapaciteteve raportuese.

[11] Rekomandimi 18 i Vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4

46. Janë ndërmarrë disa masa të tjera për përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe mbledhjes së të dhënave në fushën e të drejtave të fëmijëve në sektorë të ndryshëm, të cilët paraqiten në këtë dokument në seksionet përkatëse.

47. Krahas kësaj, vazhdimisht hartohen raportet vjetore të ASHMDF-së si edhe raportet e studimeve tematike ndërsektoriale, duke mundësuar gjurmimin e ecurisë në zbatim të ligjeve dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe duke ofruar informacione më të thelluara mbi prirjet dhe të drejtat e përzgjedhura. Disa prej këtyre studimeve janë Raporti për Situatën e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2013–2014, i hartuar nga ASHMDF-ja në vitin 2015, dhe hartëzimi gjithëpërfshirës i sistemit për mbrojtjen e fëmijëve, i kryer me mbështetjen e UNICEF dhe Maestral (2015). Në vijim u publikua dokumenti i politikave, që përcakton vizionin e qeverisë për sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijëve në të ardhmen. Këto dokumente shërbyen si bazë për hartimin e ligjit nr. 18/2017 dhe AKDF-në 2017–2020. Raportet janë të disponueshme për publikun në faqen e internetit të ASHMDF-së.

Monitorimi i pavarur[12]

48. Në vitin 2014, u ndryshua ligji për Avokatin e Popullit, duke krijuar edhe Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve i përbërë nga një Komisioner për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe tre ndihmës komisionerë. Komisionieri u emërua në vitin 2018 dhe ka ushtruar veprimtarinë e tij të plotë që prej asaj periudhe. Institucioni i Avokatit të Popullit po harton një strategji të re për t'u dhënë përparësi përpjekjeve dhe maksimizuar eficiencën e këtij organi.

49. Me krijimin e seksionit, stafit të tij iu ofrua një paketë trajnimi për legjislacionin dhe strategjitë përkatëse, duke siguruar kapacitetet e nevojshme për kryerjen e punës. Në vijim të kësaj, stafi ndoqi rregullisht disa trajnime dhe aktivitete të tjera për ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë ato të ofruara nga OJF-të.

50. Avokati i Popullit ka krijuar Zyrën Pritëse dhe të Shërbimeve për Qytetarët në Tiranë, si edhe shtatë zyra rajonale në qendrat më të mëdha administrative në vend. Me mbështetjen e Save the Children, është kryer një cikël i plotë trajnimesh mbi legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve me punonjësit e Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit. Këto zyra kanë bërë punë të mirë me promovimit të institucionit dhe të të drejtave të fëmijëve në zonat gjeografike ku operojnë.

51. Avokati i Popullit ka autoritetin të pranojë ankesa individuale me nismën e tij në lidhje me shkeljet e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë ankesat personalisht nga fëmijët, nëpërmjet disa mjeteve, me qëllim adresimin e problematikave përkatëse, si dhe kryerjen e inspektimeve në institucionet publike. Për dy vite radhazi, përkatësisht në vitin 2016 dhe 2017, Avokati i Popullit zhvilloi vizita monitoruese/inspektime në nëntë institucione rezidenciale publike për fëmijët.

52. Gjatë periudhës së raportimit, Avokati i Popullit adresoi më shumë se 440 raste, ku numri aktual i fëmijëve të arritur përmes këtyre masave po rritej, pasi disa raste përfshinin një sërë fëmijësh. Megjithatë, numri i ankesave individuale që vinin drejtpërdrejt nga vetë fëmijët ishte i ulët, ku gjatë periudhës së raportimit u regjistruan vetëm dy raste[13].

53. Zyra e Avokatit të Popullit adresoi një sërë problematikash në fushën e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë botimin e raporteve të veçanta për të drejtat e jetimëve, fëmijëve në institucione rezidenciale, punën e detyruar të fëmijëve, si edhe dy raporte për gjakmarrjen. Raportet, që janë të disponueshme për publikun në faqen e internetit të institucionit, i janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e tij.

54. Janë hartuar dokumente orientuese, të cilat janë në proces konsultimi me fëmijët dhe shoqërinë civile, duke përfshirë projekt-udhëzimin Për Bashkëpunimin e Zyrës së Avokatit të Popullit me Fëmijët dhe Shoqërinë Civile. Projekt-Standardet për Pjesëmarrjen e Fëmijëve në Procesin e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve synojnë të zhvillojnë mekanizma dhe

[12] Rekomandimi 20 i Vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4.

[13] Aneksi 2.1.4 bashkëlidhur Raportit.

instrumente për të garantuar pjesëmarrjen e fëmijëve në procesin e monitorimit të institucioneve që ofrojnë shërbime për fëmijët. Këto standarde u pilotuan në tri institucione të kujdesit për fëmijë.

55. Raporti *Zëri i të Rinjve në Shqipëri* u hartua në vitin 2017, dhe paraqet perspektivat e fëmijëve për problemet me të cilat ata përballen në përputhje me KDF-në. U vendos partneriteti ndërmjet Zyrës së Avokatit të Popullit dhe rrjetit Zëri i të Rinjve në Shqipëri – "Grupi i të Rinjve 16+" për të garantuar pjesëmarrjen e përmirësuar të fëmijëve në monitorimin e të drejtave të tyre dhe mbështetjen e advokacisë dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve në të gjitha nivelet. Janë zhvilluar disa veprimtari nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me "Grupin e të Rinjve 16+".

56. Në një kohë relativisht të shkurtër, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve ka rritur nivelin e vizibilitetit, advokacisë dhe bashkëpunimit me OSHC-të, që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, përmes Ditëve të Hapura të organizuara pothuajse në të gjitha bashkitë e vendit, median sociale dhe mjetet e tjera të komunikimit tradicional. Gjithashtu, fëmijët informohen në mënyrë të gjithanshme në lidhje me të drejtat e tyre, duke përfshirë mekanizmat e ankesave për të gjitha nivelet e arsimit, të vëna në dispozicion nga Avokati i Popullit. Seksioni merr pjesë në mënyrë aktive në Rrjetin Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë.

57. Në nëntor të vitit 2013, pas miratimit të Rezolutës nga Kuvendi i Shqipërisë "Për Mbrojtjen dhe Respektimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri", u formalizua grupi Parlamentar "Miqtë e Fëmijëve" (GMF), si grup i posaçëm pranë Kuvendit të Shqipërisë. "Miqtë e Fëmijëve" përfshijnë 23 parlamentarë që angazhohen me deputetët dhe synojnë të mbështesin një klimë të favorshme në Parlament për çështje që lidhen me fëmijët, duke përfshirë prezantimin e legjislacionit lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe garantimin e llogaridhënies për zbatimin e tij nga institucionet përgjegjëse.

58. I krijuar në vitin 2010, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) funksionon si një organ kombëtar i barazisë në Shqipëri me kompetencë adresimin e çështjeve të diskriminimit të fëmijëve në sektorët publikë dhe privatë. KMD-ja është anëtare e Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë dhe KKMDF-së[14].

Shpërndarja, rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi

59. Gjatë periudhës së raportimit, shumë agjenci fitimprurëse dhe jofitimprurëse dhe institucione kanë zhvilluar një sërë veprimtarish ndërgjegjësuese dhe trajnimesh në fushën e të drejtave të fëmijëve. Përpos disa veprimtarive të mbështetura në projekte, aspekte të ndryshme të të drejtave të fëmijëve janë bërë pjesë në mënyrë sistematike e kompetencave dhe detyrave të institucioneve përkatëse, si ASHMDF-ja, Shërbimi Social Shtetëror, Policia e Shtetit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Institucioni i Avokatit të Popullit, KMD-ja, Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike[15].

60. Ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut, sidomos për të drejtat e fëmijëve, është qëllimi kryesor i kurrikulës së arsimit, duke u nisur nga arsimi parashkollor. Të drejtat e fëmijëve janë përfshirë në kurrikul dhe në librat shkollorë të arsimit fillor dhe përbëjnë pjesë qendrore si të punës arsimore të kryer nga mësuesit, ashtu edhe të planit shkollor vjetor. Edukimi për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijës është integruar në lëndën e qytetarisë dhe edukimit shoqëror për klasat 1–10. Në shkolla, realizohen edhe veprimtari jashtëshkollore dhe projekte mësimore për të drejta të veçanta (arsimi, jeta, kujdesi shëndetësor etj.), por edhe për ditët ndërkombëtare në lidhje me këto të drejta. Veç këtyre, rregulloret e brendshme të shkollave mbështeten në parimet kryesore të KDF-së, disa prej të cilave janë afishuar edhe në mjediset e shkollave.

C. Përkufizimi i fëmijës[16]

[14] Referim edhe te pikat 65–67.

[15] Aneksi 2.1.5 bashkëlidhur Raportit.

[16] Neni 1 i Konventës Rekomandimi 26, 126 Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4

61. Ligji nr. 18/2017 e përkufizon fëmijën si çdo person nën moshën 18 vjeçare. Përkufizimi i fëmijës në akte të tjera ligjore është në përputhje me përkufizimin ndërkombëtar të parashikuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe në ligjin nr. 18/2017.

62. Mosha e pranueshme për vendosjen në institucionet rezidenciale është rritur nga 15 në 18 vjeç falë miratimit të VKM-së nr. 839/2014, që ndryshoi VKM-në nr. 425/2012 "Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore"[17].

63. Neni 100 i Kodit Penal u ndryshua në 2013, duke parashikuar dënime më të rrepta për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me të miturit, që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeçare ose nuk kanë arritur moshën e pjekurisë seksuale. Neni 101 nuk është ndryshuar. Të dy nenet janë në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare.

D. Parimet e përgjithshme

Mosdiskriminimi[18]

64. Gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), ndërmori një iniciativë *kryesisht* dhe ndihmoi më shumë se 35 raste të diskriminimit që përfshin fëmijët. U identifikuan disa probleme në fushën e arsimit, duke përfshirë regjistrimin në shkollë, shpërndarjen në shkolla dhe klasa, veçimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, ofrimin e librave shkollorë falas për kategoritë ligjërisht përfituese, dhe refuzimin për regjistrimin në shkolla të fëmijëve me aftësi të kufizuara ose të atyre nga komuniteti rom. Problemet e tjera përfshinin mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, sigurinë dhe shëndetin e fëmijëve në qendrën e trajtimit të viktimave të dhunës në familje, sjelljen fyese të punonjësve të policisë ndaj fëmijëve romë, dhunën dhe qëndrimet neglizhuese ndaj fëmijëve në parashkollor, kushtet e vështira të jetesës, dhe mungesën e furnizimeve mjekësore të duhura dhe në kohë.

65. Përpos këtyre, Komisioneri ka dhënë rekomandime të ndryshme për ligjet, aktet nënligjore dhe strategjitë kyçe në lidhje me të drejtat e fëmijëve, ka zhvilluar një sërë veprimtarish ndërgjegjësuese dhe trajnuese për stafin arsimor dhe nxënësit, si dhe ka realizuar eventin e "Ditët e Hapura" kundër diskriminimit. Shumë nga rekomandimet e KMD-së mbeten pjesërisht ose tërësisht të pa-adresuara[19][20].

66. KMD-ja ka tri zyra rajonale, përkatësisht në Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër, që shërbejnë për të garantuar mbulim më të gjerë të territorit, për të rritur vizibilitetin, ndërgjegjësimin dhe aksesin e individëve dhe institucioneve në Zyrën e Komisionerit.

67. KMD-ja monitoron zbatimin e ligjit "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) dhe kompetencat e ligjit nr. 10221/2010 'Për mbrojtjen nga diskriminimi', duke përfshirë situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në VKM-në nr. 708/2015, të cilat i ngarkojnë institucionet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave për aftësinë e kufizuar në fusha të ndryshme (arsim, shëndetësi, strehim), përbën një sfidë në këtë fushë.

68. Ligji nr.96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSh-së" miratuar në tetor 2017 garanton gëzimin e të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare të nevojshme për të mbrojtur identitetin e veçantë të pakicave kombëtare (pakica greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare).

69. Në vijim të dokumenteve të ndryshme politike dhe rekomandimeve nga seminaret e organizuara në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së, u hartua Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020 në bashkëpunim të ngushtë me organizatat rome dhe egjiptiane. Plani mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të

---

[17] Referim edhe pikës 178 të Raportit.

[18] Rekomandimi 26, 126 - Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4.

[19] Aneksi 2.2.1 bashkëlidhur Raportit.

[20] Aneksi 2.2.1.

Jetesës së Romëve dhe Egjiptianëve dhe në Planin Kombëtar të Veprimit 2010–2015, që janë pjesë e aktivitetit shumëkombëtar "Dekada e Përfshirjes së Romëve".

70. Në lidhje me integrimin, PKV-ja ofron masa për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse situatën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri në fushën e arsimit dhe dialogut ndërkulturor, gjendjes civile dhe drejtësisë, mbrojtjes sociale, punësimit, arsimit dhe formimit profesional, strehimit urban, kujdesit shëndetësor, si dhe bashkërendimin dhe monitorimin e politikave. Burime të mjaftueshme janë alokuar për zbatimin e PKV-së, ndërsa MSHMS-ja garanton gjurmimin e progresit të tij.

71. Për përmirësimin e koordinimit në fushën e integrimit të komunitetit rom dhe egjiptian është krijuar një rrjet prej shtatë pikash fokale ndërmjet ministrive kyçe përgjegjëse për arsimin, regjistrimin civil, shëndetësinë, punësimin, strehimin social dhe formimin profesional. Gjithashtu, është krijuar edhe një bazë të dhënash prej 57 pikash fokale në nivel bashkie, të cilat koordinojnë politikat për komunitetin rom dhe egjiptian.

72. Është zhvilluar sistemi elektronik RomAlb.org, i cili shërben si aplikacion i centralizuar për mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve për pakicat rome dhe egjiptiane në të gjitha nivelet. Aktualisht sistemi po përmirësohet për harmonizimin e treguesve me PKV-në. Janë organizuar dymbëdhjetë trajnime për nëpunësit publikë në nivel qendror dhe vendor në vitin 2017, ku 190 nëpunës publikë janë trajnuar dhe mbikëqyrur në vendin e punës për të vëzhguar përdorimin e sistemit nga ana e tyre. Dy raportet e para u hartuan në vitin 2016 dhe 2017, dhe paraqesin përmirësimet e shënuara në adresimin e diskriminimit dhe garantojnë gëzimin e të drejtave të fëmijëve që i përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane në shumë fusha[21].

73. Plani Kombëtar i Veprimit "Për mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor 2012–2014" dhe Plani Kombëtar i Veprimit "Për Personat LGBTI 2016–2020", parashikojnë disa masa për adresimin e diskriminimit dhe integrimit të këtyre grupeve. Qëllimet strategjike janë: 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe ndërgjegjësimi për mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI, në përputhje me standardet ndërkombëtare; 2. Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të strukturave ligjzbatuese; dhe 3. Përmirësimi i aksesit në punësim, arsim, shëndetësi, strehim dhe sporte për komunitetin LGBTI, duke garantuar mundësi të barabarta.

74. Studimi për Vëzhgimin e Diskriminimit në Shkolla u krye në Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër, dhe synonte të vlerësonte perceptimet aktuale të mësuesve të shkollave të mesme, nxënësve dhe psikologëve për çështjen e LGBT-së, diskriminimin dhe trajtimin e barabartë.

Interesi më i lartë i fëmijës[22]

75. Interesi më i lartë i fëmijës vjen si një parim qendror, i cili theksohet në të gjitha ligjet, aktet nënligjore dhe politikat kyçe që lidhen me fëmijët, duke përfshirë Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, ligjin për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, Kodin Penal, të ndryshuar, si dhe strategjitë dhe PKV-të. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton shprehimisht kuptimin dhe mënyrën se si duhet të zbatohet interesi më i lartë i fëmijës. Ky parim duhet të zbatohet në mënyrë të unifikuar nga të gjitha organet ligjzbatuese me fokus te fëmijët.

76. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe zbatimi praktik i tij, duke përfshirë edhe përcaktimin në ligjin nr. 18/2017, është integruar në të gjithë librat shkollorë, manualë dhe trajnime të profesionistëve që punojnë me fëmijët.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit[23]

77. Gjatë viteve të fundit, Qeveria Shqiptare ka bërë përpjekje të mëdha për të adresuar problemin e gjakmarrjes dhe ka zhvilluar proceset e nevojshme legjislative, organizative dhe operacionale për ta trajtuar këtë fenomen. Në vitin 2012, u hartua Plani Kombëtar i Veprimit

[21] Aneksi 2.2.1

[22] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4– Rekomandimi 30

[23] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4– Rekomandimi 32

"Për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale ndaj veprave penale të vrasjeve të kryera për motive të gjakmarrjes dhe hamarrjes", i cili u përditësua në vitin 2014, me synim forcimin e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me pushtetin vendor, Prokurorinë, Drejtoritë Arsimore dhe shkollat si dhe OSHC-të për të zgjidhur konfliktet, për të përmirësuar hetimet dhe për të ndjekur penalisht krimet, si dhe për ta sjellë arsimin në frymën e tolerancës dhe parandalimit të krimit.

78. Kodi Penal u ndryshua në vitin 2013, duke kriminalizuar dhe duke forcuar dënimet për vrasje për shkak të gjakmarrjes, për kërcënime serioze për shkak të gjakmarrjes, kërcënime kundër një personi që ngujohet në shtëpi, si dhe nxitjen për gjakmarrje.

79. Në mars të vitit 2015, Kuvendi miratoi një rezolutë që e nxiste Këshillin e Koordinimit për Luftën kundër Gjakmarrjes të merrte masa për parandalimin e fenomenit në Shqipëri. Pranë DPPSH, është ngritur Shtabi i Drejtimit kundër Krimit me Motive Hakmarrjeje dhe Gjakmarrjeje, është përgjegjës për udhëzimin, mbikëqyrjen, dhe bashkërendimin e punës së strukturave vartëse në këtë fushë. Shtabi i Drejtimit së bashku me "Drejtorinë kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë" në Departamentin e Policisë Kriminale pranë DPPSH-së monitorojnë zbatimin e PKV-së.

80. Sipas statistikave të DPPSH-së, 60 familje janë prekur nga gjakmarrja dhe 143 persona janë të ngujuar, 40 prej të cilëve janë fëmijë. Prania e kësaj dukurie vërehet më tepër në qarkun e Shkodrës (46 familje, 116 persona të ngujuar dhe 28 fëmijë nuk ndjekin shkollën). Janë ndjekur penalisht disa raste lidhur me gjakmarrjen. Që prej vitit 2012, 41 të dyshuar janë shpallur fajtorë për vrasje me motive gjakmarrjen (39 të dyshuar janë liruar), shtatë për vepra penale të kërcënimeve serioze për hakmarrje ose gjakmarrje, dhe një person u gjobit për veprën penale të nxitjes së gjakmarrjes (aneksi 2.2.2).

81. Në vitin 2017, u instalua një program kompjuterik që shërben si bazë të dhënash për identifikimin dhe regjistrimin e të dhënave të personave që janë përfshirë në vepra penale me motiv gjakmarrjen, i cili u pasua me hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) që drejtonin operimin e tij. Ky sistem do të përmirësojë identifikimin, mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e krimeve me motiv gjakmarrjen.

82. Në vitin 2014, u miratua udhëzimi nr. 36 'Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngujuar', sipas të cilit u hartuan kurrikula dhe programe të veçanta lëndore për arsimimin e fëmijëve të ngujuar. Që prej vitit shkollor 2013–2014, 39 fëmijë kanë përfituar arsim bazë në shtëpi (tre gjatë vitit shkollor 2016–2017). Gjatë vitit shkollor 2014–2015, projekti "Shkolla është streha ime" i pajisi 14 nënat e fëmijëve të ngujuar në qarkun e Shkodrës me kompjutera. Kompjuterat e dhuruar përmbajnë programe mësimore për të lehtësuar të nxënit e fëmijëve.

83. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit, kryesisht në qarqet më të prekura, si në Shkodër, Lezhë, Kukës, Durrës dhe Dibër, kanë bashkëpunuar me autoritetet e qeverisë vendore dhe me organizatat jofitimprurëse për të organizuar takime periodike për diskutimin e çështjeve që lidhen me gjakmarrjen, si dhe për ndërgjegjësimin e publikut për pasojat negative të kësaj dukurie.

84. Në vitin 2015, Avokati i Popullit nxori një raport të posaçëm ku kërkonte marrjen e masave gjithëpërfshirëse nga policia e shtetit, prokurori dhe gjyqtarët për adresimin e gjakmarrjes. Zyra e Avokatit të Popullit në Shkodër organizoi një takim si dhe veprimtari ndërgjegjësuese.

Aborti

85. Aborti kryhet ligjërisht vetëm në maternitetet e licensuara publike ose private, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me standardet dhe legjislacionin dhe përmirësimin e mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave. Ndërprerja e shtatzanisë me kërkesë të gruas shtatzënë (ndërprerje e vullnetshme e shtatzënisë) lejohet deri në javën e 12–të të shtëzanisë, bazuar në ligjin nr.8045, datë 7.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatzënisë", si në institucionet shëndetësore publike dhe ato private. Në vitin 2013, për sektorin shëndetësor privat u vendos që ndërprerja e shtatzënisë të kryhet vetëm në institucionet shëndetësore private me shtretër dhe që ofrojnë shërbimin e anestezisë dhe reanimacionit. Në vitin 2015, MSHMS-ja miratoi *"Udhërrëfyesin e praktikës klinike për abortimin e sigurt"*, që mbështetet në rekomandimet dhe të dhënat bashkëkohore për metodat e

sigurta të abortit, si dhe përgatiti fletëpalosje informuese për të promovuar botimin e tij. Udhërrëfyesi do të përdoret nga të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime aborti në vend. Ndërkohë, numri i rasteve të abortit në sektorin publik për vajzat 18-vjeçare ose më të reja është ulur: në vitin 2013, 17 aborte të provokuara dhe 52 spontane; në vitin 2017, 5 aborte të provokuara dhe 29 spontane.

Respektimi i mendimeve dhe pikëpamjeve të fëmijës

86. E drejta e fëmijëve për t'u dëgjuar parashikohet në të gjitha ligjet kryesore që lidhen me fëmijët. Ligji nr. 18/2017 parashikon të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar në çdo procedurë gjyqësore apo administrative që ka lidhje me të, qoftë drejtpërdrejt apo nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo procedural, dhe ajo që është më e rëndësishme në prani të një psikologu. Gjithashtu, ai garanton lirinë e shprehjes dhe të mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar. Ligji nr. 18/2017 parashikon të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe konsultuar gjatë proceseve të planifikimit dhe zbatimit të politikave përkatëse. Në Programin Kombëtar "Edukimi Përmes Kulturës" të prezantuar nga Ministria e Kulturës është caktuar që çdo institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës harton kalendarin e veçantë vjetor për këtë program ku përfshihet edukimi i fëmijëve nga mosha 6–18 vjeç përmes kulturës. Këto programe të veçanta si arkeologu i vogël, miku i monumentit, piktorët e vegjël etj kanë për qëllim edukimin e brezit të ri me vlerat e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore".

87. Pjesëmarrja e fëmijëve në të gjitha fushat dhe proceset që prekin jetën e tyre, dhe kërkojnë që fëmijët dhe familjet e tyre të jenë plotësisht të informuara për çështje të tilla, është një nga elementet ndërsektoriale të të gjitha shtyllave strategjike të Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020. Axhenda parashikon hartimin e një udhëzuesi për pjesëmarrjen e fëmijëve në ngritjen e mekanizmave sektorialë dhe ndërsektorialë për të mundësuar pjesëmarrjen dhe përfshirjen kuptimplotë të fëmijëve, si dhe për të forcuar kapacitetet e aktorëve të ndryshëm të fushës. Axhenda parashikon edhe krijimin e një faqeje interneti ndërvepruese për t'u konsultuar me fëmijët. Në faqen web të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është ndërtuar portali "Zëri i Fëmijëve".

88. Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset demokratike të vendimmarrjes dhe krijimin e infrastrukturës së përshtatshme është objektivi i parë strategjik i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020. Në sistemin arsimor, zëri i fëmijëve përfaqësohet nëpërmjet organeve të ngritura në secilën shkollë, si qeveria e nxënësve dhe bordi i shkollës.

89. Fëmijët kanë statusin e vëzhguesit në mbledhjet e KKMDF-së. Udhëzuesi për Përzgjedhjen e Përfaqësuesve të Fëmijëve në këtë Këshill u miratua në qershor të vitit 2018.

90. Përfshirja e fëmijëve në hartimin e politikave dhe ligjeve për të drejtat e fëmijëve është shndërruar në standard. Fëmijët kanë dorëzuar rekomandime për PKVF-në, ndërsa ekspertët që hartojnë Kodin e Drejtësisë Penale për Fëmijët kanë organizuar konsultime me grupe të ndryshme fëmijësh, duke përfshirë edhe ata të vendosur në burgun e Kavajës.

91. Mbështetur në standardet e institucioneve të kujdesit shoqëror, fëmijët gëzojnë të drejtën për t'u dëgjuar dhe të flasin për kujdesin, trajtimin dhe shërbimin e ofruar në këto institucione. Është e detyrueshme që hartimi dhe zbatimi i planeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor të kryhen me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe, kur është e mundur, të prindërve të tyre. Ekipet shumëdisiplinore në institucionet publike të kujdesit shoqëror i kryejnë praktikat e tyre në interesin më të lartë të fëmijës. Standardi nr. 3 për Shërbimet e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve [VKM nr. 573/2015] kërkon përfshirjen aktive të fëmijës dhe familjes në procesin e menaxhimit të rastit, duke përfshirë pajisjen e fëmijëve me informacione të mjaftueshme dhe mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe me vetëbesim në procesin e vendimmarrjes. Miratimi i planit individual të fëmijës dokumentohet

92. ASHMDF-ja e ka shtuar vëmendjen ndaj veprimtarive ndërgjegjësuese për të drejtat e fëmijëve dhe ndaj forcimit të pjesëmarrjes së fëmijëve në mekanizmat vendimmarrës në nivel qendror, që variojnë nga organizimi i dialogut për të drejtat e fëmijëve midis përfaqësuesve të qeverisë shqiptare në vitin 2014 tek angazhimi i 482 fëmijëve në vitin 2016 (me mbështetjen e

World Vision) në katër bashki për të mbledhur pikëpamjet, kontributet dhe rekomandimet lidhur me mekanizmin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtat e të tyre, si dhe konceptin dhe veprimtaritë e Planit Kombëtar të Mobilizimit # UnëMbrojFëmijët.

93. ASHMDF-ja, UNICEF-i, Save the Children dhe World Vision po bashkëpunojnë për t'i angazhuar fëmijët në mbarë vendin në workshop-e konsultuese, me qëllim përgatitjen e një versioni miqësor me fëmijët të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Ky proces do të pasohet me përgatitjen e materialeve miqësore me fëmijët dhe shpërndarjen e tyre në masë.

94. Pjesëmarrja e fëmijëve nxitet edhe nëpërmjet medias. Që prej shtatorit të vitit 2015, çdo të shtunë pasdite transmetohet emisioni për fëmijë *"Tangram"*. Gjatë emisionit, fëmijët paraqesin idetë e tyre për "Shqipërinë më të mirë" dhe marrin pjesë në panele me personalitete të fushave të ndryshme. *Underdio* është një platformë dhe emision radiofonik i drejtuar nga fëmijët me qëllim nxitjen e fëmijëve për të folur hapur dhe për të ngritur zërin mbi problematikat që i shqetësojnë në shkollë, familje dhe komunitet. Emisioni drejtohet nga fëmijët që marrin pjesë në mënyrë proaktive në të drejtat e fëmijëve dhe ftojnë përfaqësues të qeverive të nxënësve dhe fëmijë në situatë rruge. Platforma radiofonike mbështetet nga Save the Children.

95. Forcimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në monitorimin e të drejtave të tyre është një nga përparësitë e Seksionit të Avokatit të Popullit për të Drejtat e Fëmijës.

E. Të drejtat dhe liritë civile

Regjistrimi i lindjes[24]

96. Regjistrimi i të gjithë fëmijëve (dhe parandalimi i mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve romë dhe joromë të lindur brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe brenda ose jashtë institucioneve shëndetësore) është një nga prioritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), e cila është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shërbimit të gjendjes civile.

97. Regjistrimi i lindjeve është pa pagesë, pa asnjë tarifë, si dhe personat që deklarojnë lindjen e fëmijës brenda 60 ditësh (90 ditë për lindjet jashtë vendit) përfitojnë një bonus prej 5.000 lekësh nga buxheti i shtetit. Që *nga 1 janari 2019 për fëmijën e parë të lindur, familja përfiton 40 000 lekë, për fëmijën e dytë, përfiton 80 000 lekë dhe për të tretin përfiton 120 000 lekë".*

98. Për të pasur një kontroll mbi numrin e fëmijëve të paregjistruar dhe për të vlerësuar tipologjinë e rasteve të paregjistruara, me qëllim zgjidhjen e tyre deri në regjistrim, me mbështetjen e UNCHR-së, në zbatim të ndryshimeve të ligjit nr. 10129 /2009 dhe udhëzimit të miratuar në zbatim të tij, për këtë qëllim, është krijuar "Regjistri i përkohshëm për regjistrimin e personave të paregjistruar" - Modul i RKGJC-së. Në këtë regjistër do të regjistrohen të gjitha rastet e identifikuara si të paregjistruara.

99. Nga viti 2012 deri në qershor 2018, 3,359 fëmijë janë identifikuar si të paregjistruar dhe është mbajtur dokumentacioni i nevojshëm për ta (701 në vitin 2016, dhe 631 në vitin 2017). Në vitin 2017, 427 romë dhe egjiptianë u identifikuan si të paregjistruar dhe 235 fëmijë përfituan dokumentet me ndihmën e OJF-ve. Ndihma ligjore falas u ofrua për procedimet gjyqësore lidhur me regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë spitalit dhe të atyre me informacion regjistrimi të pasaktë, për të zgjidhur mosmarrëveshjet ligjore lidhur me kujdestarinë, rastet e divorcit dhe çështje të tjera të ndërlikuara. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile bashkëpunon ngushtë edhe me organizatat jofitimprurëse të cilat operojnë në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut e veçanërisht ato të fëmijëve, siç është shërbimi ligjor falas TLAS. Nga viti 2013 deri në dhjetor 2018, janë identifikuar si të paregjistruar dhe janë regjistruar 3,209 fëmijë, përkatësisht: gjatë vitit 2013 janë regjistruar 296, gjatë vitit 2014 janë regjistruar 530, gjatë vitit 2015 janë regjistruar 515, gjatë vitit 2016 janë regjistruar 701, gjatë vitit 2017 janë regjistruar 631 dhe gjatë vitit 2018 janë regjistruar 536 raste. Ky proces do të lehtësohet edhe më shumë pas ndryshimeve në ligjin nr.

[24] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 - Rekomandimi 36.

10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile" të ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij**.**

100. Me urdhër të MASR-së, për regjistrimin në parashkollor ose shkollë nuk kërkohet certifikatë lindjeje, dhe fëmijët regjistrohen pavarësisht statusit të tyre civil ose të regjistrimit. Si pjesë e nismës së përbashkët për të identifikuar fëmijët pa shtetësi, 400 fëmijë të paregjistruar në zyrën e gjendjes civile ndoqën arsimin parauniversitar. Në këtë rast, DPGJC-ja ofron ndihmë ligjore për regjistrimin e fëmijëve. Ky proces do të lehtësohet edhe më shumë pas ndryshimeve në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile" të ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

101. Në tetor të vitit 2018, u miratuan ndryshimet në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009,"Për gjendjen civile", të ndryshuar. Këto ndryshime erdhën si pasojë e nevojës së domosdoshme nga shqyrtimi i rasteve të paregjistruara, që lidhen me mungesë dokumentacioni, me dokumentacion të paplotë, si dhe me dokumentacion me të dhëna të pasakta, të cilat nuk mund të zgjidheshin me kuadrin ekzistues ligjor. Ndryshimet e miratuara, lejojnë dhe lehtësojnë zgjidhjen e rasteve të paregjistruara në dy forma, atë administrative dhe gjyqësore. Gjithashtu, këto ndryshime rregullojnë raportet e komunikimit midis institucioneve spitalore ku ndodhin lindjet me zyrat e gjendjes civile, pasi institucioni ku ndodh lindja detyrohet të raportojë të gjithë të sapolindurit, në zyrat e gjendjes civile. Ndryshimet theksojnë se roli i strukturave të shtetit nuk është vetëm konstatues. Në këtë rast zyra e gjendjes civile, pasi vëren se kalojnë afatet e përcaktuara në ligj për regjistrimin e fëmijëve nga personat që parashikon ligji, njofton NJMF-të, për të ndërmarrë procedurat e regjistrimit në rastin kur prindërit nuk e regjistrojnë fëmijën brenda 60 ditësh. Janë miratuar dy udhëzime të ministrit të Brendshëm: udhëzimi nr. 284, datë 11.3.2019 "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes të fëmijëve në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre brenda 60 ditësh nga data e lindjes"; udhëzimi nr. 285, datë 11.3.2019 "Për krijimin, administrimin dhe përditësimin e regjistrit të përkohshëm për lindjet e raportuara"; udhëzimi nr. 286, datë 11.3.2019 "Për përcaktimin e procedurës administrative që zbatohet nga zyra e gjendjes civile kur në aktin e lindjes së mbajtur jashtë RSH-së është e paplotësuar rubrika e emrit. Nëpërmjet këtyre akteve nënligjore u zgjidhën këto çështje: ngritja dhe funksionimi i modulit elektronik; Regjistri i përkohshëm për rastet e paregjistruara; procedurat që kryejnë nëpunësit e gjendjes civile në bashkëpunim me punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në bashki; zgjidhja e rasteve kur në aktin e mbajtur nga shërbimi i gjendjes civile jashtë territorit të RSh-së mungon rubrika e emrit të fëmijës".

Aksesi në informacione të përshtatshme[25]

102. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton detyrimet e medias për sa i përket raportimit për fëmijët. Pas proceseve të konsultimit, në 2017 u miratua Kodi i ri i Transmetimit të Medias Audiovizive, që integron dispozitat dhe mbrojtjen përkatëse, siç parashikohen edhe në ligjin nr. 18/2017.

103. Ligji nr. 18/2017 i jep ASHMDF-së kompetencën për të monitoruar shkeljet e të drejtave të fëmijëve dhe të standardeve etike të raportimit për fëmijët. Për periudhën 2016–2017, 237 rastet e fëmijëve (në nevojë për mbrojtje), që u bënë publikë/identifikuan nga media, u referuan në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve për të vijuar me menaxhimin e rastit. Gjithashtu, u depozituan 70 ankesa për median e shkruar dhe audiovizive për publikim lajmesh në shkelje të të drejtave të fëmijëve (19 ankesa të depozituara pranë Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) dhe 51 pranë gazetave, portaleve dhe Këshillit Shqiptar të Medias)[26].

104. Monitorimi i medias nga ASHMDF-ja tregon një përmirësim të madh të raportimit të lajmeve për fëmijët. Megjithatë, mbeten ende sfida, sidomos për median e shkruar, median *online* dhe portalet *online* që kanë mbulim dhe përdorim të gjerë. Me qëllim forcimin e reagimit, në

[25] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 - Rekomandimi 38.
[26] Aneksi 2.3.2 bashkëlidhur Raportit.

bashkëpunim me gazetarët është identifikuar nevoja për të hartuar Kodin e Sjelljes për gazetarët e mediave *online* dhe për të përmirësuar njohuritë e tyre.

105. AMA ka detyrime funksionale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 'Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe kryen rishikime dhe monitorim të vazhdueshëm dhe periodik të programeve kombëtare dhe vendore. Gjithashtu, AMA merr dhe adreson ankesa të publikut për mosrespektimin e të drejtave të fëmijëve në programet audiovizive. Që prej vitit 2016, kur u krijua edhe Këshilli i Ankesave, trajtimi i ankesave mbulohet nga kjo njësi. AMA ka vendosur disa gjoba dhe monitoron nga afër ofruesit që mund të shkelin Kodin e Transmetimit dhe ligje të tjera në këtë fushë [27].

106. Janë marrë disa masa për mbrojtjen e fëmijëve nga informacionet dhe përmbajtjet e dëmshme në një mjedis digjital[28].

F. Dhuna ndaj fëmijëve

Sistemi shumësektorial i mbrojtjes së fëmijëve [VP 44B]

107. Është ngritur një sistem shumësektorial për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe janë rivlerësuar dhe riaktivizuar sistemet, strukturat dhe mekanizmat e përshtatshëm në kuadër të ligjit nr. 17/2018 dhe të Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020. Ligji nr. 18/2017 qartëson strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe forcon masat që mund të përdorin punonjësit kur identifikojnë rastet e fëmijëve në rrezik për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit ose shfrytëzimit, duke përfshirë masat emergjente për ta larguar menjëherë fëmijën nga situata e rrezikshme.

Gjithashtu, ai vendos detyrimin e menjëhershëm për të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët që duhet të raportojnë abuzimin e fëmijëve.

108. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve përbën një shtyllë strategjike të Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020. Vëmendje e veçantë për axhendën i kushtohet parandalimit si strategji kyçe për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, duke përfshirë promovimin e prindërimit pozitiv jo të dhunshëm.

109. Në nivel kombëtar, ASHMDF-ja ka detyrën të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, duke iu ofruar ndihmë në menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje dhe në zhvillimin e veprimtarive profesionale lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë, në nivel vendor, bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen dhe ofrimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë ngritjen e strukturave të përshtatshme, programet e financimit, dhe shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimit.

110. Ligji nr. 10347/2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" dhe ligji nr. 17/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" institucionalizoi NJMF-të dhe PMF-të si struktura kyçe për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor. Në vitin 2015, VKM-ja nr. 573/2015 "Për Miratimin e Standardeve për Shërbimet e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës" përcaktoi proceset e vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës në bashki, si dhe ofroi bazën për inspektimin e tyre nga strukturat në nivel qendror.

111. NJMF-të identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë rastet e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje. Në vitin 2018, janë 235 punonjës për mbrojtjen e fëmijës, që janë aktualisht funksionalë në të gjithë vendin, duke shënuar një rritje nga 49 të tillë që ishin në vitin 2012. Menaxhimi i rastit institucionalizohet si metodë ose sistem i standardizuar që përdoret për të garantuar reagimet e duhura ndaj rasteve të fëmijëve në rrezik, brenda afateve të caktuara, dhe në përputhje me standardet e shërbimit. Numri i rasteve të menaxhuara nga NJMF-të është rritur: Ka pasur 1.650 raste në vitin 2017, dhe 1897 për vitin 2018 krahasuar me 1.333 raste në vitin 2012) [29].

---

[27] Aneksi 2.3.2 bashkëlidhur Raportit

[28] Referim pikat 147-152.

[29] Aneksi 2.4.1 bashkëlidhur Raporti.

112.Secila bashki me më shumë se 3.000 fëmijë duhet të ketë PMF, të cilët veprojnë si menaxherë rasti dhe janë përgjegjës për detyrat lidhur vetëm me mbrojtjen e fëmijëve. Këta punonjës duhet të trajnohen në punën sociale dhe të punojnë pranë njësive të vlerësimit të nevojave dhe të referimit nën varësinë e drejtorive të shërbimit social. Në rast se bashkia ka më pak se 3.000 fëmijë, kjo detyrë mund të përfshihet në përshkrimin e punës të një prej punonjësve të njësisë.

113. VKM-ja nr. 578/2018 "Për Procedurat për Referimin dhe Menaxhimin e Rasteve, Hartimin dhe Përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes, Shpenzimet Financiare për Zbatimin e Masave Mbrojtëse" përmban udhëzime për zbatimin dhe funksionimin e efektshëm të elementeve kyçe të sistemit të mbrojtjes së fëmijës. Për herë të parë, kjo VKM mbulon buxhetimin për ndërhyrjet dhe shërbimet e mbrojtjes së fëmijës. Ajo përcakton procedurat e referimit dhe procedurat e menaxhimit të rasteve me shtatë hapa për t'iu përgjigjur fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

114. Pavarësisht këtyre përmirësimeve, ka ende disa sfida. Megjithëse, numri i NJMF-ve është trefishuar gjatë periudhës së raportimit, ato nuk janë ngritur në të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative me më shumë se 3.000 fëmijë. Funksionimi efikas i NJMF-ve ndikohet edhe nga qarkullimi i lartë i stafit dhe mungesa e përputhshmërisë me kriteret për punësimin e PMF-ve, duke përfshirë edhe nivelet arsimore dhe formimin profesional të nevojshëm. Ka ende mbivendosje të rolit të NJMF-së me funksione të tjera (p.sh., administratori social) dhe mungojnë mekanizma të efektshëm raportimi që mundësojnë përpunimin e informacioneve nga NJMF-të vendore në nivel kombëtar. Në vitin 2017, vetëm 45 PMF (20%) ushtruan funksionin e PMF-së, ndërsa vetëm 78 PMF (35%) ishin punonjës socialë. Në veçanti, në njësitë administrative të thella, është shumë e vështirë të identifikohen punonjësit e kualifikuar ose me përvojën e nevojshme. Mungesa e burimeve të kualifikuara njerëzore kufizon ofrimin e shërbimeve nga PMF-të, si dhe ul cilësinë e menaxhimit të rasteve.

115. Në çdo bashki dhe njësi administrative me më shumë se 3.000 fëmijë është ngritur një grup i posaçëm teknik ndërsektorial (GTN) për adresimin e rasteve të fëmijës. GTN-ja mbështet punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit gjatë vlerësimit të rastit, hartimit të planeve individuale të mbrojtjes, lehtësimit të referimeve, si dhe gjatë zbatimit të ndërhyrjeve të planit. Për të mbështetur punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, kjo strukturë garanton se vlerësimi ndërsektorial, i cili shërben si bazë për secilin plan individual të mbrojtjes, kryhet për çdo fëmijë në nevojë. E miratuar në qershor të vitit 2018, VKM-ja nr. 353 "Për Rregullat e Funksionimit të Grupit Teknik Ndërsektorial që Qartëson Rolet dhe Përgjegjësitë e Anëtarëve të Grupit Teknik Ndërsektorial" pritet të forcojë reagimet ndërsektoriale në nivel vendor.

116. Për shkak të reformës administrative dhe sfidave të njohura në zbatimin e NJMF-ve, ASHMDF-ja dhe partnerët e saj po punojnë në përkufizimet ligjore dhe rregullatore, si dhe në ngritjen e strukturave të përmirësuara të NJMF-ve mbështetur në mësimet e nxjerra.

117. Në kuadër të objektivave strategjike të reformës administrative dhe territoriale, të miratuar në korrik të vitit 2014, bashkitë kanë edhe përgjegjësinë kryesore për ofrimin dhe miratimin e shërbimeve shoqërore, duke përfshirë ato për fëmijët në nevojë. Ekzistojnë një sërë shërbimesh që qeveria, OJF-të ose të dyja ia ofrojnë familjes dhe fëmijës. Megjithatë, mungojnë shërbime të mjaftueshme dhe të specializuara për fëmijët viktima ose në rrezik abuzimi, dhune, shfrytëzimi dhe neglizhimi, teksa shërbimet ekzistuese gjenden kryesisht në qytetet kryesore.

118. Në nivel shkolle, është forcuar sistemi i mbrojtjes së fëmijës, duke përfshirë ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial. Çdo shkollë e mesme me më shumë se 700 nxënës duhet të ketë një psikolog ose një punonjës social, bazuar në urdhrin nr. 344, datë 19.8.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial", të ndryshuar. Në drejtoritë e shëndetit publik janë ngritur pika fokale për rastet e dhunës dhe mbrojtjes së fëmijëve viktima, të cilët raportojnë te MSHMS-ja në mënyrë periodike për rastet.

119. Në vitin 2017, u ristrukturuan strukturat e Policisë së Shtetit për të përmirësuar reagimin ndaj dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës në familje. Në Drejtorinë e Policisë Kriminale pranë DPPSH-së është ngritur Sektori për Dhunën në Familje dhe të Miturit, i cili përbëhet nga shefi i sektorit dhe dy specialistë. Pjesë e Sektorëve të Krimit të 12 Drejtorive të Policisë janë një specialist dhe një punonjës i specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe dhunës në familje. Komisariatet e Policisë, në varësi të territorit që mbulojnë dhe numrit të ngjarjeve të identifikuara, kanë nga një në tre punonjës të specializuar në fushën e hetimit të krimeve kundër fëmijëve dhe të dhunës në familje.

120. Në vitin 2014, MSH-ja (sot MSHMS) hartoi një raport të unifikuar për institucionet shëndetësore lidhur me identifikimin, diagnozën dhe adresimin e rasteve të dhunës: VKM nr. 327/2014 'Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes dhe raportimit të të dhënave nga ofruesit publikë dhe jopublikë të shërbimit të kujdesit shëndetësor'.

121. Midis periudhës mars-qershor 2016, ASHMDF-ja dhe në atë kohë Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (sot MSHMS-ja), me mbështetjen e partnerëve, prezantuan Planin Kombëtar të Mobilizimit #UnëMbrojFëmijët për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës. Plani i mobilizimit ka ndihmuar në përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për denoncimin dhe raportimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve. Në 26 bashki janë përfshirë më shumë se 10.000 fëmijë. Gjatë periudhës së raportimit u organizuan edhe disa veprimtari të tjera ndërgjegjësuese[30].

Dhuna në familje[31]

122. Zero tolerancë ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është motoja e qeverisë shqiptare. Pas një procesi të gjatë konsultimesh, u ndryshua ligji nr. 47/2018 "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" për të garantuar përputhshmërinë më Konventën e KiE-së për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), si dhe për të adresuar nevojat, mangësitë dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i tij.

123. Në vitin 2013 u ndryshua Kodi Penal i vitit 1995, i cili njeh si vepër penale dhunën në familje, dhunën seksuale, angazhimin në veprimtari seksuale nëpërmjet forcës ndërmjet bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, si dhe zhdukjen me forcë të grave shtatzëna, fëmijëve dhe personave të pambrojtur. Në ligjin nr. 18/2017 përfshihen edhe disa masa mbrojtjeje, veçanërisht lidhur me dhunën në familje[32].

124. Me përfundimin dhe vlerësimin e zbatimit të saj, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011–2015 u zëvendësua me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2016–2020. Kjo strategji e re dhe plan veprimi parashikojnë një reagim gjithëpërfshirës shumësektorial ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe përfshin masa me ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj fëmijëve, dhe në mbështetjen e fëmijëve viktima. Gjithashtu, strategjia parashikon masa për rehabilitimin e dhunuesit.

125. Pas miratimit të VKM-së [Nr. 334/2011], Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) për rastet e dhunës në familje është ngritur në nivel vendor në 61 bashki (nga 66 bashki që ishin në total në atë periudhë). MKR-ja përbëhet nga tri struktura: komiteti drejtues, ekipi teknik, dhe koordinatori vendor, që bashkëpunojnë për të ofruar ndihmën e nevojshme për viktimat e dhunës në familje. Në shumicën e rasteve, koordinatori vendor është edhe punonjës në NJMF, i cili lehtëson një qasje më të bashkërenduar për adresimin e rasteve të dhunës në familje. Janë hartuar standardet e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje (DHF) dhe me VKM-në nr.

[30] Aneksi 2.1.5 bashkëlidhur Raportit.

[31] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimet 44a dhe 49 c.

[32] Aneksi 2.1.1 bashkëlidhur Raportit

430/2016 janë miratuar standardet kombëtare të shërbimit këshillimor për viktimat e dhunës në familje.

126. Sistemi i regjistrimit online që regjistron të dhëna statistikore për dhunën në familje në nivel vendor është funksional. Sistemi regjistron çdo rast dhune të identifikuar dhe adresuar përmes mekanizmit vendor të referimit. Që prej prezantimit të sistemit, janë regjistruar gjithsej 2,649 raste të dhunës në familje, me 861 raste në vitin 2016 dhe 758 raste në vitin 2017. Informacioni regjistrohet nga sistemi për autorët dhe viktimat, dhe ndahet, ndër të tjera, sipas cenueshmërisë, etnisë, gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe statusit të punësimit.

127. Është përmirësuar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje. Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Dhunës në Familje, e ngritur në varësi të SHSSH-së në vitin 2011, ofron shërbime shumëdisiplinore 24–orëshe, duke përfshirë strehimin afatgjatë (më shumë se gjashtë muaj, ose më gjatë në rast të një urdhri mbrojtjeje) për gratë, vajzat dhe djemtë deri në moshën 16-vjeçare. Numri i fëmijëve të akomoduar çdo vit është relativisht i qëndrueshëm ndërmjet 38 deri në 59 raste në vit. Krahas qendrës kombëtare, gjashtë subjekte jopublike, të financuara nga buxheti i shtetit, ofrojnë shërbime rezidenciale, dy në Tiranë dhe nga një në Berat, Korçë, Elbasan dhe Vlorë.

128. Pas akomodimit në qendër, për çdo fëmijë hartohet një plan i përshtatur i shërbimit të integrimit që përfshin, ndër të tjera, regjistrimin e tyre dhe monitorimin e ndjekjes së shkollës. Gjithashtu, organizohen disa veprimtari argëtuese dhe ndërgjegjësuese me qëllim zhvillimin e aftësive të tyre sociale dhe njohëse. Punonjësit e specializuar socialë dhe psikologët në qendër i mbështesin nënat për t'u përfshirë në skemat e punësimit dhe strehimit që ofron qeveria vendore ose organizatat jofitimprurëse, me qëllim përmirësimin e situatës së tyre financiare. Shërbime të tjera të disponueshme për viktimat, që ofrohen nga qendrat publike dhe private janë, ndër të tjera, strehimi, mbështetja psikosociale, referimi për kujdes mjekësor, ndihma ligjore, kurset e formimit profesional, ndërmjetësimi për punësim etj.

129. Në bashkëpunim me UNDP-në, qendrat e emergjencës për gratë dhe vajzat viktima të dhunës në familje në nevojë për akomodim të përkohshëm janë ngritur në katër qytete: Pogradec, Sarandë, Përmet dhe Roskovec. Po hartohet një kuadër rregullator që synon përcaktimin e standardeve të shërbimeve që duhen ofruar nga strukturat bashkiake të emergjencës për viktimat e DHBGJ-së dhe DHF-së, duke përfshirë të mbijetuarat e ngacmimit seksual dhe dhunës seksuale.

130. Në shkurt të vitit 2017 u vu në funksion Linja Kombëtare e Këshillimit për Viktimat e Dhunës në Familje, e cila ofron 24 orë mbështetje pa pagesë nga psikologë, avokatë dhe profesionistë të tjerë.

131. Gratë dhe fëmijët e mbijetuar të dhunës në familje dhe dhunës seksuale, si dhe të trafikimit të qenieve njerëzore do të përfitojnë nga sistemi i ri i ndihmës ligjore falas dhe nga masat e shtuara të mbrojtjes për viktimat e krimit, falë ligjit të ri për ndihmën ligjore falas dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (korrik 2017). Janë organizuar fushata ndërgjegjësuese për të sfiduar stereotipat gjinorë që nxisin dhunën, si dhe për t'i informuar gratë për shërbimet e disponueshme[33].

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual[34]

132. Neni 26 i ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" parashikon mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzim seksual me fëmijë.

133. Nenet 107 dhe 108 të Kodit Penal janë ndryshuar për të ofruar mbrojtje ndaj krimeve seksuale kundër fëmijëve dhe për ta rritur dënimin për këto krime në 25 vjet burgim. Neni 117

---

[33] Aneksi 2.1.5 bashkëlidhur Raportit

[34] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 46.

për pornografinë është ripërkufizuar dhe tashmë përfshin posedimin dhe rekrutimin e fëmijëve për pornografi. Neni 124 është zgjeruar për të mbuluar ë gjitha format e shfrytëzimit të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik. Me këto ndryshime, legjislacioni penal shqiptar u përafrua me legjislacionin ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e KE-së Lanzarote "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual".

134. Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2016–2020 parashikon vendosjen e shërbimeve të specializuara për viktimat fëmijë të abuzimit seksual dhe formave të tjera të dhunës, si një ndër objektivat specifike.

135. Sektori për Krimet në Internet, i krijuar që prej vitit 2009 pranë Departamentit të Policisë Kriminale të DPPSH-së, ka vijuar monitorimin *online* për materiale abuzive për fëmijët dhe identifikimin dhe hetimin e rasteve të përdoruesve shqiptarë ose të huaj të filmimeve ose imazheve pornografike me fëmijë në internet. Në vitin 2015, si rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet policore gjermane dhe italiane, u organizuan dy operacione policore 'Pedofili' dhe 'Pedofili 2' për identifikimin e veprës penale të 'Pornografisë' siç parashikohet në nenin 117 të Kodit Penal, të cilat u përmbyllën me arrestimin e dy personave.

136. Studimi për Abuzimin Seksual të Fëmijëve brenda Rrethit të Besimit (2015) u krye në bashkëpunim me ASHMDF-në dhe *Terre des Hommes*. Studimi i përgjigjet nevojës për monitorimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Lanzarote dhe raundit të parë të monitorimeve që përqendrohen në kuadrin ligjor për abuzimin seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Si pjesë e bashkëpunimit me Komitetin e KE-së, që mbikëqyr Konventën Lanzarote, nga ana e ASHMDF-së u plotësua pyetësori "Mbrojta nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual i fëmijëve të prekur nga kriza e refugjatëve".

137. Të dhënat statistikore për krimet e regjistruara tregojnë se abuzimi dhe shfrytëzimi seksual prekin në masë vajzat. Gjatë periudhës 2012–2017, u regjistruan 365 krime[35].

Ndëshkimi trupor[36]

138. Ligji "Për arsimin parauniversitar" u ndryshua në vitin 2013, duke forcuar mekanizmat ligjore për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijëve në mjediset e shkollës, përmes parashikimit të penaliteteve për mësuesit e dhunshëm, dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e dhunës.

139. Në të gjitha shkollat janë ngritur Komisione të Etikës**,** të cilat ndër të tjera, merren me rastet e sjelljes së dhunshme në institucione arsimore. Çdo Komision, që përbëhet nga mësues, prindër dhe nxënës, duhet shqyrtojë ankesat e nxënësve, prindërve dhe punonjësve në lidhje me shkeljet e normave etike dhe sjellore, si dhe të propozojë zgjidhje për drejtorin e institucionit. Komisionet e Etikës trajtuan 2,824 raste të dhunës gjatë vitit akademik 2015/2016, dhe 2,342 raste gjatë atij 2017/2018, nga të cilat 530 ishin raste të dhunës nxënës-mësues dhe 1,812 ishin raste të dhunës nxënës-nxënës.

140. Gjatë vitit akademik 2017/2018, në të gjitha shkollat u përdorën një sërë mjetesh dhe instrumentesh për identifikimin e dhunës, duke përfshirë vëzhgimet e shpeshta të nxënësve dhe mësuesve, pyetësorët dhe anketimet për dhunën. U organizuan edhe takime bashkëpunimi me mësuesit dhe qeverinë e nxënësve për identifikimin e personave të dhunshëm dhe të abuzuar, dhe për përcaktimin e masave për trajtimin e tyre. Nuk janë shënuar raste ku institucionet arsimore nisin procedura gjyqësore ndaj personave që ndëshkojnë fizikisht fëmijët.

141. Programi kombëtar për Komunikimin për Ndikimin e Sjelljes, një nismë e MASR-së (emri aktual), MSHMS-së dhe ASHMDF-së, është vënë në zbatim në të gjitha shkollat fillore, me mbështetjen e UNICEF-it, me qëllim eliminimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet arsimore duke promovuar disiplinën pozitive. Si pjesë e programit, janë zhvilluar 66 seanca rajonale orientimi në të gjitha shkollat e vendit dhe janë trajnuar 2.645 drejtorë dhe nëndrejtorë të shkollave, mësues, psikologë dhe staf. Janë zhvilluar mjete dhe materiale komunikimi dhe janë

---

[35] Aneksi 2.4.1 bashkëlidhur Raportit

[36] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 42

paraqitur në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit. Çdo shkollë ka caktuar një specialist për trajtimin e problemeve të dhunës, që bashkërendon punën me ASHMDF-në dhe raportimin e rasteve të dhunës në institucionet arsimore, reagimin ndaj rasteve të dhunës dhe ndaj masave të ndërmarra për reduktimin e fenomenit.

142. Viti shkollor 2015–2016 ishte viti i nismës "Stop dhunës në shkollë", i shtrirë në të gjitha shkollat e vendit. që pasqyroi një veprim kombëtar të bashkërenduar ndërmjet shkollës, familjes, komunitetit, institucioneve shtetërore dhe OSHC-ve, të angazhuara me parandalimin e dhunës dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve në shkolla. Kjo nismë u shtri në 42 shkolla, duke shpërndarë njëkohësisht materiale edukuese që përmbanin programe për parandalimin e dhunës. Ky plan pasqyroi një veprim kombëtar të bashkërenduar ndërmjet shkollës, familjes, komunitetit, institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile, të angazhuara me parandalimin e dhunës dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve në shkolla. Kjo nismë ka vijuar çdo vit shkollor, ku çdo shkollë përfshin në planin vjetor aktivitete për parandalimin dhe raportimin e dhunës. Në udhëzimin e vitit shkollor orientohen shkollat për të vijuar nismën "Stop dhunës në shkolla.

143. Në vitin 2016, MASR-ja miratoi Manualin për Sistemin e Paralajmërimit të Braktisjes së Shkollës, një manual trajnimi për institucionet e arsimit bazë, ku një kre i dedikohet disiplinës pozitive. Janë shpërndarë edhe manuale të tjera (Manuali Praktik i UNICEF-it për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe Bazat e Zgjidhjes së Konfliktit dhe të Mosmarrëveshjes), të cilat synojnë parandalimin e dhunës dhe edukimin e fëmijëve për paqen, tolerancën dhe mirëkuptimin. Më datë 9.10.2018 është miratuar vendimi nr. 600 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë", përmes së cilit është synuar rritja e sigurisë publike në shkolla, si një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative, si brenda edhe jashtë mjediseve të shkollës. Menaxhimi i sigurisë në shkolla kërkon një ndërveprim të vazhdueshëm me nxënësit dhe personelin mësimor, gjë të cilën merr përsipër ta realizojë oficeri i sigurisë në shkolla. Për këtë arsye, duke synuar rritjen e sigurisë publike nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme nëpërmjet marrëveshjes së datës 1.6.2018 së nënshkruar ndërmjet tyre dhe nëpërmjet përcaktimeve të këtij vendimi kërkon të krijojë një qasje të re nëpërmjet krijimit të rolit të oficerit të sigurisë në shkolla. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian, në periudhën 2016–2019 u zbatua projekti "Të luftojmë bullizmin dhe ekstremizmin në sistemin arsimor shqiptar". Projekti u shtri në 21 shkolla në shkallë vendi, arsimi bazë, i mesëm dhe profesional, publik dhe privat. U realizua studimi i parë mbi këtë fenomen në sistemin arsimor shqiptar. Në secilën prej shkollave u ngritën ekipet shkollore për trajtimin e fenomenit. U trajnuan trajnerët në çdo shkollë për ketë fenomen dhe u hartua paketa informuese. Kjo paketë u akreditua nga Komisioni i Akreditimit të programeve/trajnimeve dhe është një material trajnimi për të gjithë mësuesit. U organizua një konferencë rajonale për të ndarë përvojat dhe trajtimin e fenomenit. U organizuan veprimtari në shkolla të trajtuara si "Ditët e hapura kundër bullizmit", ku shkollat prezantuan mënyra mbi qasjen ndaj këtij fenomeni. Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, u hartua një udhërrëfyes për këtë aspekt, i cili përbën një dokument politikash në të ardhmen. Data 21 nëntor u përcaktua si Dita e luftës kundër bullizmit në sistemin arsimor parauniversitar. Janë realizuar shkëmbime përvojash mes skuadrave të 21 shkollave dhe dy përvoja ndërkombëtare në këtë aspekt. U binjakëzua një shkollë shqiptare me një shkollë në Norvegji, për të ndarë përvojë në fushën e bullizmit

144. MASR-ja dhe Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) po zbatojnë një projekt pilot "Shkollat e sigurta–Përgjegjësit e sigurisë në shkollë", me qëllim garantimin e një mjedis të sigurt të të nxënit për nxënësit, stafin dhe komunitetin e shkollës. Projekti pilot është zbatuar në 15 gjimnaze të Tiranës, ku janë caktuar 15 punonjës sigurie.

Mbrojtja e fëmijëve në mjedisin digjital

145. Neni 27 i ligjit nr. 18/2017 adreson mbrojtjen e fëmijës nga aksesi në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të jashtëligjshme në internet, duke e përcaktuar si "përmbajtje të

dëmshme për fëmijën". Ligji parashikon që gjithë ofruesit e internetit, institucionet arsimore, dhe çdo institucion publik ose privat që ofron akses në internet të përdorin mjete teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesi i përmbajtjes së të jashtëligjshme ose të dëmshme.

146. Ligji nr. 18/2017 përcakton përgjegjësinë e ASHMDF-së për të raportuar tek autoritetet përgjegjëse për çdo rrjet informacioni ose kompjuterik dhe për faqe interneti që paraqesin materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijët. Do të hartohet një VKM për përcaktimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesi i përmbajtjes së jashtëligjshme ose të dëmshme në internet, për të cilën Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe UNICEF-i organizuan një workshop njëditor dhe seancë konsultimi me publikun në qershor të vitit 2018.

147. Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2016–2020 parashikon disa masa për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin elektronik dhe digjital. Këto masa shtjellohen më me hollësi në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, të lidhur midis ministrive përgjegjëse[37] dhe në Planin e saj të Veprimit 2018–2020 "Për internet më të sigurt për fëmijët". Plani i Veprimit paraqet nisma të bashkërenduara ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, bullizmi dhe shfrytëzimi në internet. Me qëllim, zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit "Për sigurinë online të fëmijëve në Shqipëri" të nënshkruar në Shkurt të vitit 2016, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurtë, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe CRCA Shqipëri, nënshkruan Planin e Veprimit 2018–2020 "Për internet më të sigurt për fëmijët", me detyrat përkatëse për secilën prej tyre, duke përfshirë edhe AKCESK, si autoriteti rregullator i fushës së sigurisë kibernetike. Plani Strategjik do të shërbejë si një udhërrefyes për të caktuar qëllimet, objektivat, punën dhe veprimtarinë e institucioneve, organizatave, industrisë dhe të gjithë aktorëve socialë të interesuar për sigurinë e fëmijëve në internet, përgjatë 2 viteve të ardhshme.

148. Palët nënshkruese ranë dakord për ngritjen e Komitetit Teknik Këshillimor për Sigurinë e Fëmijëve në Internet pranë KKMDF-së. Anëtarët e Komitetit shërbejnë si pika kontakti për institucionet e tyre përkatëse në lidhje me raportimin, referimin dhe shkëmbimin e informacioneve konfidenciale për rastet e dhunës, bullizmit dhe shfrytëzimin e fëmijëve në internet.

149. Sipas VKM-së nr. 141/2017, Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ka zhvilluar një platformë për bllokimin e aksesit në faqet me përmbajtje të jashtëligjshme për institucionet e ngarkuara me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës. Deri më sot nuk ka raporte për faqet e mbyllura të internetit përmes përdorimit të kësaj platforme.

150. Në kuadër të nismës "Internet më i sigurt dhe më i mirë për fëmijët në Shqipëri", AKCESK-ja dhe UNICEF kanë ndërmarrë disa masa për përmirësimin e sigurisë dhe sigurimit të fëmijëve dhe të rinjve në mjedisin digjital. Kjo nismë parashikohet të shërbejë si katalizator për hartimin e udhëzimeve për sektorit privat dhe operatorët e industrisë në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në internet.

151. Në vitin 2013, falë bashkërendimit të Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), u nënshkrua Kodi i Sjelljes për përdorim të sigurt dhe të përgjegjshëm të rrjeteve të komunikimit elektronik nga operatorët kryesore të komunikimit elektronik në Shqipëri. Kodi i detyron operatorët të garantojnë kontrollin dhe klasifikimin e duhur të përmbajtjes tregtare të ofruar nga ata ose përmes tyre për personat nën moshën 18-vjeçare.

152. Në këtë fushë, janë organizuar një sërë veprimtarish ndërgjegjësuese si pjesë e nismës "Ditët e Internetit të Sigurt". Siguria në internet dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve janë pjesë e

[37] Në momentin e miratimit të Agjendës Kombëtare për Fëmijët në vitin 2016 institucionet përgjegjëse sipas strukturës së kabinetit qeveritar kanë qenë: Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit.

përbërëse e lëndëve kryesore në kurrikulën për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), që është pilotuar në arsimin bazë. Krahas kësaj, institucionet arsimore kanë ndërmarrë edhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga informacionet e dëmshme[38].

Praktikat e dëmshme[39]

153. Gjatë periudhës 2016–2018, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (OJF kombëtare) dhe Shkolla e Magjistraturës hetuan dhe monitoruan vendimet gjyqësore të periudhës 2011–2017 në nëntë gjykata të rretheve gjyqësore për çështjen e martesave nën moshë, duke përfshirë identifikimin dhe analizimin e situatës në praktikën gjyqësore dhe në përdorimin e masave të duhura nga sistemi i drejtësisë. Gjetjet pasqyrohen në dy raporte. Për këtë temë u organizuan gjashtë trajnime me pjesëmarrjen e 80 gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë këtyre trajnimeve u theksua nevoja për ngritjen e mekanizmave të monitorimit dhe reagimit për të njohur situatën në vend lidhur me martesat e fëmijëve, të cilat janë ende të pranishme, veçanërisht në komunitetin rom.

Linjat e këshillimit[40]

154. Që prej vitit 2012, Linja Kombëtare e Këshillimit të Fëmijëve ALO 116 111, një shërbim i mbështetur financiarisht nga UNICEF-i, ka qenë funksionale dhe ofron mbështetje online për fëmijët. Në prill të vitit 2016, ASHMDF-ja nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me ALO 116 111. Marrëveshja synon përmirësimin e sistemit të referimit për fëmijët në rrezik. Deri më tani, kjo linjë ka raportuar 44 raste pranë ASHMDF-së, dhe 56 raste pranë NJMF-ve. ALO 116 111 është anëtare e KKMDF-së. Linja telefonike transmetohet vazhdimisht në emisione televizive dhe fushatat ndërgjegjësuese, në mbledhjet dhe trajnimet e organizuar nga ALO 116 në bashkëpunim me partnerët. Posterat #Unë Mbroj fëmijët dhe MOS heshtni janë printuar dhe shpërndarë profesionistëve. Ligji nr. 18/2017 parashikon vendosjen e një numri pa pagesë për referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë të mbrojtjes.

155. Në vitin 2016, ASHMDF-ja nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin "Together Albania" për promovimin e faqes për këshillimin e të rinjve *www.nukjevetem.al*. Faqja e internetit ofron ndihmë falas për fëmijët dhe të rinjtë, duke e mbajtur të fshehtë identitetin e tyre. Në Durrës, ASHMDF-ja së bashku me ish Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë prezantuan aplikacionin "I Count Children", i cili ofron mundësinë e raportimit anonim të dhunës ndaj fëmijëve dhe referimin pranë institucioneve përgjegjëse.

Tortura apo trajtimet ose ndëshkimet e tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese

156. Për të përmirësuar monitorimin dhe dorëzimin e ankesave në sistemin penitenciar dhe institucione të tjera policore, si dhe për të adresuar dhe parandaluar keqtrajtimin e fëmijëve në institucionet shtetërore u ndryshuan një sërë aktesh ligjore. Ndryshimet në ligjin për policinë e shtetit në vitin 2014 përcaktuan të drejtën e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar për t'u ankuar, si dhe detyrimin e strukturave të policisë për të ndjekur dhe për t'iu përgjigjur ankuesit brenda muajit. Gjithashtu, ky ligj i ofron OJF-ve akses në monitorimin dhe vëzhgimin e strukturave të sigurisë së rajoneve të policisë. Këto masa zbatohen për të gjithë të paraburgosurit, duke përfshirë edhe të miturit.

157. Në vitin 2012, u ndryshuan urdhri nr. 371 "Për krijimin dhe funksionimin e regjistrit për identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave nga personat e mbajtur në mjediset e Policisë së Shtetit" dhe urdhri nr. 372 "Për procedurat standarde të punës (PSP) për rendin dhe sigurinë publike", për të siguruar procedurat e një sistemi të efektshëm për menaxhimin e ankesave. Gjithashtu, VKM-ja nr. 437/2015 "Për rregulloren e përgjithshme të burgjeve", e ndryshuar, përmban standardet dhe dispozitat e rëndësishme në përputhje me Kodin 37/2017 dhe rregulloret evropiane të burgjeve.

---

[38] Aneksi 2.1. 5 bashkëlidhur Raportit.

[39] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 48

[40] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 51

158. Çdo institucion ku mbahen fëmijët të cilëve iu është mohuar liria disponon të dhëna dhe kontakte për mekanizmat kombëtarë dhe OSHC-të që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Administrata e Burgjeve organizon rregullisht seanca informimi për fëmijët në çdo institucion për të miturit, si dhe shpërndan fletëpalosje për të drejtën e ankimit dhe procedurat e adresimit të ankesave.

159. 50 kuti postare për kërkesat dhe ankesat e të burgosurve, të cilat administrohen nga Avokati i Popullit, u instaluan në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit së bashku me një numër telefoni pa pagesë, ndërsa një linjë telefonike 24–orëshe është e disponueshme për marrjen e ankesave apo njoftimeve që i adresohen Avokatit të Popullit.

160. Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve ka mundësuar akses për organet e pavarura, si Avokati i Popullit, KMD-ja dhe katër OJF, për monitorimin e rregullt të ambienteve të privimit të lirisë, duke përfshirë institucionet për të miturit. Marrëveshjet me OJF-të rinovohen çdo dy vjet.

161. Në vitin 2016, me mbështetjen e UNICEF-it dhe Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, Avokati i Popullit bëri vizita monitorimi në institucione të ndryshme policore dhe penitenciare për të monitoruar respektimin e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin. Raporti përfundimtar hedh dritë mbi kushtet dhe trajtimin e fëmijëve në vendet ku ata mbahen dhe ku vuajnë heqjen e lirisë, si dhe sjell në vëmendjen e publikut zërin e këtyre fëmijëve që ndodhen larg syrit të publikut (Aneksi 2.4.4).

162. Gjatë periudhës 2015–2017, janë evidentuar raste dhune ndaj fëmijëve në strukturat e kujdesit të fëmijëve në Shkodër, Durrës dhe Vlorë. Autoritetet përgjegjëse iu kundërpërgjigjën menjëherë akuzave, duke marrë masa ligjore dhe duke i ofruar mbështetjen e nevojshme fëmijëve të prekur. Në përgjigje të rasteve të identifikuara, në tetor të vitit 2016 u ngrit task forca për monitorimin dhe inspektimin e të gjitha shërbimeve publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror rezidencial për fëmijët në nevojë. MSHMS-ja mundësoi testimin profesional të të gjithë punonjësve të kujdesit rezidencial. Për më tepër, SHSSH-ja hartoi një sërë masash për monitorimin dhe identifikimin e rasteve të mundshme të dhunës ndaj fëmijëve në institucionet rezidenciale, duke përfshirë edhe organizimin e diskutimeve me fokus grupet, intervistat dhe anketimet me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të afërmve të tyre.

163. Në përputhje me standardet për institucionet publike rezidenciale, duke përfshirë qendrat ditore për fëmijët, u identifikuan procedurat e qarta për secilin institucion lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Zbatimi i procedurave monitorohet rregullisht nga SHSSH-ja, ndërsa kutitë e ankesave vendosen në çdo institucion, së bashku me njoftimet informuese që shpjegojnë procedurat që duhen ndjekur. Që prej vitit 2016, Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së kanë kontrolluar rregullisht kutitë e ankesave dhe kanë ndjekur në mënyrë strikte se si janë adresuar rekomandimet dhe masat e specifikuara gjatë vizitave të monitorimit. Çdo vit, merren dhe iu jepet përgjigje mesatarisht 20 ankesave nga fëmijët, duke dokumentuar në këtë mënyrë procesin, dhe shpeshherë duke angazhuar edhe vetë fëmijët (Aneksi 2.4.4).

164. Për të ulur përhapjen e dhunës, për të përmirësuar sigurinë e fëmijëve dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve që atyre iu ofrohen, në qershor të vitit 2018, MSHMS-ja instaloi kamerat e sigurisë në hapësirat e përbashkëta në të gjitha institucionet e kujdesit shoqëror. Nisma është në përputhje me legjislacionin, duke mundësuar marrjen e masave nga institucionet publike dhe është e përafruar me ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

165. Shërbimi Social Shtëror (SHSSH-ja) organizon trajnime vjetore për ofruesit e shërbimeve në institucionet e kujdesit shoqëror, të ofruara nga ekspertë të jashtëm ose të brendshëm. Që prej vitit 2015, janë ofruar trajnime në vendin e punës në institucionet publike për tema që përfshijnë disiplinimin pozitiv të fëmijëve, terapinë përmes lojës, procedurat e mbrojtjes së fëmijëve, menaxhimin e konflikteve në vendin e punës dhe komunikimin. Të gjitha institucionet disponojnë dokumentet e nevojshme, si Kodin e Sjelljes, Deklaratën e Vizitorit dhe Politikat e Mbrojtjes së Fëmijës, të nënshkruara nga të gjithë punonjësit.

166. Institucioni i Avokatit të Popullit në funksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kompetencë të kryejë inspektim sistematik dhe të pavarur në sistemin

penitenciar, si dhe institucionet e tjera rezidenciale. Në vitin 2016, ai nxori raporte për gjetjet nga institucionet penitenciare, dhe në vitin 2017, për vizitat në të gjitha institucionet publike rezidenciale për fëmijët.

G. Mjedisi familjar dhe kujdesi alternativ

Mjedisi familjar[41]

167. Krahas dispozitave të Kodit të Familjes, ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton kritere të hollësishme për mënyrën se si fëmija duhet të komunikojë me prindin me të cilin nuk jeton, apo me të afërm të tjerë që fëmija duhet, ose dëshiron të mbajë kontaktet. Ligji përcakton edhe mekanizmat dhe ndërhyrjet në gjykatë për vendosjen e komunikimit, në rast se prindi ose kujdestari ligjor refuzon t'i përmbushë detyrimet e tij, si dhe për rishqyrtimin e vendimit për kontakti me prindin.

168. AKDF 2017–2020, si pjesë e objektivit për "Përmirësimin e Aksesit dhe Cilësisë së Kujdesit dhe Arsimit në Fëmijërinë e Hershme 0–6 vjeç" parashikon edhe zhvillimin e moduleve të trajnimit për programet e prindërimit pozitiv në fëmijërinë e hershme dhe transferimin e profesionistëve në çerdhe dhe kopshte, për të zhvilluar programe të pjesëmarrjes pozitive në njësitë vendore. Departamenti i Promovimit të Shëndetit pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) ka organizuar vazhdimisht veprimtari ndërgjegjësuese për fëmijët me fokus te prindërimi pozitiv

169. Ligji nr. 121/2016 (neni 14) "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (objektivi 3) trajtojnë masat që synojnë mbështetjen e familjes dhe parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve përmes, ndër të tjera, shërbimeve komunitare, mbështetjes së drejtpërdrejtë për familjet në nevojë, këshillimit dhe trajnimeve të familjeve. Gjithashtu, ligji nr. 18/2017 përcakton shprehimisht procesin vendimmarrës për masën e mbrojtjes së menjëhershme dhe vendosjen në kujdes alternativ, duke parashikuar të drejtën e fëmijës për të qëndruar me prindërit dhe për të mos u ndarë prej tyre kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se ndarja është në interesin më të lartë të fëmijës.

Fëmijët e privuar nga mjedisi familjar[42]

170. Me miratimin e ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", sistemi i kujdesit alternativ është riformësuar, duke i dhënë përparësi masave për mbështetjen e shërbimeve në familje dhe duke përfshirë ndërhyrje për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi. Parimet e deinstitucionalizimit dhe fuqizimit të familjes janë përcaktuar si parimet bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

171. Një prej objektivave të ligjit nr. 121/2016 është edhe shndërrimi i institucioneve të kujdesit shoqëror rezidencial në shërbime alternative përmes shërbimeve të përkohshme të kujdestarisë dhe ngritjes së qendrave shumëfunksionale dhe shumëdisiplinore. Për të arritur këtë objektiv, në vitin 2018 u hartua "Dokumenti i Politikave për Deinstitucionalizimin e Sistemit të Kujdesit Shoqëror Rezidencial" dhe Plani i tij trevjeçar i Veprimit.

172. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" rishikoi masat ekzistuese të mbrojtjes. Ai parashikon, për herë të parë, masat për rehabilitimin prindëror, duke synuar kthimin e fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në gjirin e familjes, përmes fuqizimit dhe mbështetjes së familjes, ose ndërhyrjes për të përmirësuar marrëdhëniet në familje nëse fëmija jeton ende me të. Plani i nxjerrjes së fëmijës nga institucioni dhe kthimin në familje hartohet nga ekipi shumëdisiplinor. Këshillimi kryhet me prindërit. Kjo masë pritet të shtojë rastet e kthimit të fëmijëve pranë familjeve të tyre biologjike.

173. Planet individuale për kthimin e fëmijës në familje, sistemimin në familje kujdestare ose në familje birësuese përbëjnë objektivin kryesor të punës së ekipit shumëdisiplinor, të ngritur në institucionet e kujdesit shoqëror. Secili ekip përbëhet nga një psikolog, punonjës social, mjek,

---

[41] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 53.

[42] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 55

mësues dhe specialistë të tjerë të fushës. Që prej vitit 2012, performanca e tyre është monitoruar nga SHSSH-ja. Ekipi shqyrton dosjen e fëmijës, duke përfshirë kontaktet e regjistruara rregullisht me familjen, motrat dhe vëllezërit, dhe të afërmit e tjerë. Çdo institucion nxitet të organizojë mbledhje të rregullta të ekipit shumëdisiplinor, ku ftohen të marrin pjesë prindërit ose familjarët, nëse kjo përfshihet në planin e zhvillimit dhe kujdesit të fëmijës. Të gjitha procedurat detajohen në 'Standardet e Kujdesit Shoqëror për Institucionet Rezidenciale të Fëmijëve' (VKM nr. 659/2005).

174. Pamundësia ekonomike nuk i justifikon vendimet e autoriteteve shtetërore për ta ndarë fëmijën nga familja, apo të afërmit me të cilët jeton, ose për të hequr përgjegjësinë prindërore. VKM-ja nr. 425/2012 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumenteve të nevojshme për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike të kujdesit shoqëror", i dha fund vendosjes së fëmijëve në institucione për shkaqe ekonomike, duke shfuqizuar VKM-në nr. 209/2006. Varfëria dhe problemet e tjera socio-ekonomike mbeten një arsye për sistemimin e fëmijëve në institucione. Megjithatë, numri i rasteve të tilla ka rënë gjatë viteve të fundit (nga 76 fëmijë në vitin 2013, në 50 në vitin 2017) falë masave të marra për trajtimin e varfërisë, ngritjes së qendrave komunitare ditore për fëmijët dhe familjet, forcimit të NJMF-ve etj.

175.umri i IPKSH-ve nuk ka ndryshuar që prej vitit 2012, ndërsa numri i IKSH-ve jopublike është rritur nga = 15 në vitin 2012 në 17 në vitin 2018. Megjithatë, qëllimi i gjithë këtij procesi është t'i shndërrojë IKSH-të në shtëpi-familje dhe të mundësojë ofrimin e shërbimeve të kujdesit ditor brenda këtyre qendrave. Një lloj i tillë kujdesi është ofruar në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" që prej vitit 2013, në Shtëpinë e Foshnjës në Durrës për fëmijët 0–6 vjeç që prej vitit 2012, dhe në Shtëpinë e Fëmijëve në Shkodër për fëmijët 3–6 vjeç që prej vitit 2015. Ka kohë që ko e fundit e ka ndryshuar llojin e kujdesit duke u shndërruar në një qendër shtëpi-familje për fëmijët 16–18 vjeç.

176. Nga qershori i vitit 2018, 553 fëmijëve iu është njohur statusi i jetimit, një rritje në numër krahasuar me 280 që ishin në vitin 2014. Kjo rritje është shënuar falë masave të marra për të mbështetur nënat dhe fëmijët e lindur jashtë martese, një kategori që njihen si përfitues sipas ligjit për statusin e jetimit. Prandaj, pretendimet për këtë kategori janë rritur gjithnjë e më shumë me kalimin e viteve.

177. Ndërkohë, numri i fëmijëve jetimë në IKSH-të publike është ulur. Në vitin 2017, kishte vetëm 189 fëmijë në nëntë IKSH publike, krahasuar me 306 fëmijë në vitin 2013. Megjithatë, numri i fëmijëve në 18 IKSH-të jopublike ka mbetur relativisht i pandryshuar, ku në fund të vitit 2017 në këtë lloj kujdesi kishte 350 fëmijë. Vërehet një prirje e përgjithshme e sistemit drejt shkurtimit të kohëzgjatjes së qëndrimit të fëmijës në institucion. Kohëzgjatja e qëndrimit të fëmijëve 0–6 vjeç në institucionet rezidenciale është mesatarisht 2–3 vjet, ndërsa për fëmijët 6–18 kjo shifër shkon në 4–5 vjet[43].

178. Vendimi për kohëzgjatjen e qëndrimit merret nga ekipi shumëdisiplinor bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Në vitin 2017, u krijua një lloj i ri shërbimi me VKM nr. 106/2017, sipas të cilit fëmijët vendosen në institucione të përshtatshme për kategoritë e fëmijëve 0–5, 6–15 dhe 16–18 vjeç. Ndryshe nga e shkuara, jo vetëm që tani ofrohet kujdes për këta fëmijë, por për këtë kategori po ndiqet një qasje e re kujdesi, e cila përqendrohet në ndërhyrjet deri në kthimin e tyre në familje, ose në integrimin e tyre të plotë në shoqëri.

179. Vendimet e marra nga strukturat përgjegjëse për vendosjen e fëmijëve në institucione rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit shoqëror i japin përparësi vendosjes së fëmijëve me vëllezërit ose motrat pavarësisht grup-moshës. Megjithatë, kjo qasje, e ndërthurur me kufizimet në kapacitetet e strehimit, krijon ndonjëherë vështirësi. Në këto raste, konsiderohet vendosja e tyre në IKSH jopublike pa kufi moshe. Në vitin 2017, më shumë se 90 për qind e fëmijëve të sistemuar në fshatrat SOS ishin motra dhe vëllezër, ndërsa 60 për qind në IKSH të tjera jopublike. Në IKSH-të publike, 50 për qind e fëmijëve janë motra dhe vëllezër.

[43] Aneksi 2.5.1 bashkëlidhur Raportit

180. Midis periudhës 2014 dhe maj 2018, 447 fëmijë u rikthyen te familjet e tyre biologjike. Nga këta, 166 jetonin në IKSH publike dhe 69 në qendra publike të zhvillimit për personat me aftësi të kufizuara.

181. Të gjitha institucionet kanë pasur që prej vitit 2012 të njëjtën strukturë; përjashtim bën IKSH në Sarandë ku janë caktuar dy kujdestarë dhe një psikolog shtesë (VKM nr. 101/2015). Sipas nevojës, disa institucione nën administrimin e bashkisë mund ta shtojnë numrin e personelit, që mbulohen nga fondet e bashkisë. Raporti i personelit me përfituesit në IKSH rezidenciale publike ndjek standardet e miratuara, ndërsa përbërja e personelit është shumëdisiplinore. SHSSH-ja vlerëson rregullisht nevojën për personel dhe sipas rastit propozon ndryshime pranë MSHMS-së. Propozimi më i fundit që është hartuar për ndryshimet në personel pritet të miratohet në vitin 2019.

182. Masat për përgatitjen e fëmijëve për jetesë të pavarur pas largimit nga institucioni janë pjesë e punës së IKSH-ve. Ato përfshijnë mbështetjen e fëmijëve lidhur me aksesin në shërbime dhe përfitime (p.sh. programet e strehimit, bursat për konviktet e shkollës së mesme) dhe gjetjen e një vendi pune (regjistrim për vendosjen në punë, zhvillimin ose përshtatjen e aftësive me biznese dhe punëdhënës të ndryshëm). Në disa raste, kur nuk është i mundur kthimi pranë familjes pasi kanë mbushur moshën 18 vjeç, fëmijët akomodohen në qendra rinore gjysmë të pavarura ose apartamente, që ofrohen nga OJF-të. PMF-ja e monitoron fëmijën edhe pas daljes nga institucioni rezidencial.

183. VKM-ja nr. 149/2018, e cila shfuqizon VKM-në nr. 89/2012 dhe udhëzimin nr. 11/2015 rregullon ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të organizuara të kujdestarisë. Kjo VKM forcon sistemin, duke specifikuar strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët në familjet kujdestare, dhe proceset, identifikimin, vlerësimin, sistemimin, dhe monitorimin e fëmijës në familjen kujdestare, si dhe kostot financiare përkatëse. Gjithashtu, VKM-ja parashikon krijimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve, i cili do të lehtësojë procedurat e zbatimit dhe do të përmirësojë menaxhimin dhe ndjekjen e çdo rasti në të gjitha nivelet. Janë zbatuar projekte të ndryshme për nxitjen e zhvillimit të kujdesit alternativ për familjet kujdestare kryesisht në Shkodër dhe Tiranë, si dhe janë ndërmarrë veprimtari ndërgjegjësuese në bashki të tjera. Gjatë periudhës 2012–2017, numri i fëmijëve në familjet kujdestare ose me lidhje gjaku është rritur nga 66 në vitin 2012 në 271 në vitin 2017.

184. Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social", i cili do të hyjë në fuqi në nëntor të vitit 2018, parashikon të drejtën e fëmijëve pa kujdes prindëror, ose në kujdes rezidencial, të cilët po përgatiten të jetojnë në mënyrë të pavarur, dhe të fëmijëve në konflikt me ligjin, pas lirimit nga burgu, ose pas përfundimit të programit të masave alternative, që janë në nevojë për strehim, për të përfituar nga programet e specializuara të strehimit social.

185. Janë hartuar disa module të ndryshme trajnimi për të gjithë rrjetin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilët përqendrohen tek IKSH-të për fëmijët. SHSSH-ja bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me OJF ndërkombëtare dhe vendore, të cilat kanë ofruar ekspertizën e tyre përmes seancave trajnuese dhe studimeve të ndryshme për IKSH-të[44].

Birësimi[45] [VP 57]

186. Krahas konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, Kodi i Familjes (ligji nr. 9062/2003, i ndryshuar), ligji nr. 9695/2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit", i ndryshuar me ligjin nr. 132/2015, ligji nr. 10428/2011 'Për të drejtën ndërkombëtare private', dhe Rregullorja e Brendshme e Komitetit Shqiptar të Birësimit (KSHB) drejtojnë procedurat e birësimit. Strukturat përkatëse sigurojnë se të gjitha procedurat e birësimit i kushtojnë vëmendje të madhe interesit më të lartë të fëmijës.

---

[44] Aneksi 2.1.5

[45] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 57

187. Neni 15 i ligjit nr. 9695/2007 garanton të drejtën e fëmijëve mbi 10 vjeç për të shprehur mendimet e tyre, të cilat merren në konsideratë në varësi të moshës dhe pjekurisë, ndërsa për sa i përket fëmijëve 12-vjeçarë, duhet marrë pëlqimi i tyre për birësim. KSHB-ja ka një procedurë të mirëpërcaktuar për të siguruar respektimin e të drejtës për t'u dëgjuar, të cilëve iu kërkohet të shprehin mendimet e tyre me mbështetjen e psikologut në disa raste. Për të miturit nën moshën 10 vjeç, zbatohen parimet e përgjithshme të parashtruara në Kodin e Familjes, sipas të cilit fëmija ka të drejtë të dëgjohet në të gjitha procedurat e lidhura me të në varësi të moshës dhe aftësisë për të kuptuar.

188. Pas konsultimeve të shumta, neni 250 i Kodit të Familjes për deklarimin e braktisjes së fëmijës u ndryshua në vitin 2015. Dispozitat caktuan kuadrin e ri të lëshimit të deklarimit të braktisjes në disa institucione, duke synuar kështu lehtësimin e zgjidhjeve që duhen zbatuar brenda periudhave të arsyeshme kohore dhe me masat e nevojshme mbrojtëse.

189. Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Familjes përmbajnë dispozita të përgjithshme, të cilat parashikojnë se vendimet duhet të merren brenda një kohe të arsyeshme. Mesatarisht kërkohen katër muaj që të përfundojë një proces gjyqësor për birësim. Zgjatja e afatit bëhet për fëmijët me probleme të rënda shëndetësore. Në prill të vitit 2014, KSHB-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët për çështjet lidhur me procedurat dhe afatet gjyqësore në rastet e birësimit për administratën e KSHB-së dhe gjyqtarët. Hyrja në fuqi e ndryshimeve të reja në kod lidhur me procedurat gjyqësore (deklaratat e mbrojtjes dhe mesatarisht 3 seanca gjyqësore) mund të sjellin zgjatjen e afatit kohor mesatar për përfundimin e procedurës së birësimit.

190. KSHB-ja ushtron rregullisht kontroll në strukturat publike dhe private të kujdesit për fëmijët që përmbushin kushtet për birësim, dhe verifikon raportet periodike që iu paraqiten atyre në Komitetin për Statusin e Fëmijëve. Kur në procedurën e birësimit vihet re mosrespektim i detyrimeve ligjore, kryetari i KSHB-së mund të propozojë që: a) autoriteti shtetëror përgjegjës të marrë masa disiplinore për menaxherët ose punonjësit e institucionit shtetëror të kujdesit shoqëror, dhe b) Inspektorati i Ndihmës Ekonomike dhe Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar i heq licencën institucionit privat ose shtetëror të kujdesit. Gjatë monitorimit nuk u vunë re shkelje nga institucionet lidhur me deklaratat e braktisjes së fëmijëve.

191. Gjatë periudhës 2012–qershor 2018, u birësuan 335 fëmijë, prej të cilëve 34 kishin probleme të rënda shëndetësore dhe 36 ishin mbi 10 vjeç. Gjatë periudhës së raportimit kishte 126 raste të birësimit ndërshtetëror. Para birësimit të tyre, 84.4 për qind e fëmijëve kanë qenë të vendosur në institucione. Birësimi i fëmijëve mbi dhjetë vjeç dhe i fëmijëve me nevoja të veçanta mbetet një sfidë[46].

H. Aftësia e kufizuar, shëndeti dhe mirëqenia

Fëmijët me aftësi të kufizuara[47]

192. Ratifikimi i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka sjellë ndryshime në kuadrin ligjor, në përputhje me standardet e parashtruara në Konventë. Ligji nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara" dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara u miratuan me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe përfshirjen e efektshme të personave me aftësi të kufizuara (PAK). MSHMS-ja po monitoron aktualisht zbatimin e PKV-së.

193. Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara, i krijuar në vitin 2015 (VKM nr. 48) për të drejtuar përpjekjet ndërministrore, përfshin OSHC-të që përfaqësojnë të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të prindërve të tyre.

194. Ligji nr. 18/2017 i garanton fëmijëve me aftësi të kufizuara të drejtën për të përfituar nga shërbimet shëndetësore, sociale, arsimore dhe çdo shërbim tjetër i nevojshëm, të përcaktuar nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Pagesa e aftësisë së kufizuar është pjesë

[46] Aneksi 2.5.2 bashkëlidhur Raportit.

[47] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 59E

e programit të mbrojtjes sociale dhe shërben për t'i mbështetur njerëzit me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës. Në vitin 2013, 18.474 fëmijë (8.189 vajza), dhe në vitin 2017, 14.155 fëmijë (6.060 vajza), përfituan nga skema. Shpenzimet e aftësisë së kufizuar janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit dhe aktualisht, po thithin pjesën më të madhe të buxhetit të mbrojtjes sociale. (Aneksi 2.6.1)

195. Sistemi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar po i nënshtrohet një procesi reformimi, duke kaluar nga modeli mjekësor në atë bio-psiko-social. Mbështetur në ndryshimet legjislative (në ligjin nr. 9335 "Për ndihmën ekonomike", VKM nr. 431/2016, e ndryshuar në vitin 2018, dhe udhëzimet ministrore shtesë), që prej vitit 2017 po pilotohet një skemë e re shoqërore e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në dy njësi administrative të Bashkisë së Tiranës. Po pilotohet edhe Regjistri Elektronik Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar, i cili përbën një element të rëndësishëm të reformës së sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

196. Mbështetur në VKM-në nr. 813/2017, individët me aftësi të kufizuara shkojnë në institucionet shëndetësore për diagnoza dhe ekzaminime, kështu që vlerësimi i aftësisë së kufizuar kryhet nga komisioni në bazë të dokumentacionit, duke shmangur praninë e përsëritur të individëve në hapa të ndryshëm të procesit.

197. Në përputhje me objektivin e Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, që përqendrohet në përmirësimin e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme, janë parashikuar dy masa që do të forcojnë mekanizmin e identifikimit të hershëm. Këto përfshijnë hartimin e protokolleve për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e problemeve zhvillimore të fëmijëve, dhe rishikimin e protokolleve për identifikimin e hershëm të problemeve të shëndetit mendor te fëmijët deri në moshën 18-vjeçare.

198. Ligji 121/2016 "Për shërbimet shoqërore në RSH-së" parashikon tipologjinë e qendrave të zhvillimit për personat me aftësi të kufizuara. Për personat me aftësi të kufizuara të grup-moshës 0–21 vjeç ka njëmbëdhjetë qendra rezidenciale zhvillimore (gjashtë publike dhe pesë jopublike). Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në këto qendra ka rënë gradualisht nga 130 në vitin 2012 në 84 në qershor të vitit 2018. Deri më sot, funksionojnë 37 qendra komunitare dhe të kujdesit ditor për personat, duke përfshirë edhe fëmijët, me aftësi të kufizuara, të cilat janë shtrirë në të gjithë vendin, krahasuar me vetëm 19 të tilla në vitin 2013. Qendrat në Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Bulqizë dhe Shijak janë hapur së fundmi me mbështetjen e UNDP-së. Qendrat e tjera, në Dibër, Përmet, Urë Vajgurore, Krujë dhe Korçë, janë në proces ndërtimi.

199. Aksesi në aparatet dhe teknologjinë ndihmëse me kosto të përballueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara është përmirësuar, por mbetet ende sfidë. VKM-ja nr. 308/2014 parashikon paketën e impiantit koklear për fëmijët me dëmtime në dëgjim, me financim të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor si në institucione publike, ashtu edhe në ato jopublike.

200.Pjesëmarrja dhe integrimi në shoqëri i PAK-ve është një prej parimeve të ligjit nr. 93/2014. Janë zhvilluar disa veprimtari në bashkëpunim me Qendrat e Kujdesit për Zhvillimin lidhur me promovimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në ditët e veçanta, si p.sh në ditën e personave që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë, ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, javën botërore të arsimit dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara etj., synohet ndërgjegjësimi për të drejtat e tyre[48].

Kujdesi dhe shërbimet shëndetësore[49]

201. Në mbështetje të VKM-së nr. 101/2015, paketa e kujdesit shëndetësor parësor përbëhet nga udhëzimet dhe rekomandimet e shëndetit riprodhues, gratë, të porsalindurit, foshnjat dhe kujdesit për fëmijët. Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet falas për të gjithë qytetarët shqiptarë dhe asnjë person nuk mbetet pa kujdes për shkak të gjendjes financiare. Këtu përfshihen të gjitha

[48] Referim edhe pikës 261.

[49] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 61

shërbimet e kujdesit shëndetësor gjatë shtatzënisë dhe lindjes (duke përfshirë edhe gratë pa sigurime shëndetësore).

202. Platforma e lëshimit të recetave elektronike (e-Health), sistemi i referimit të pacientëve, menaxhimi i kujdesit personal, dhe nënshkrimi elektronik i mjekut janë që të gjitha elemente të modernizimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Sikundër, janë rishikuar të gjitha standardet infrastrukturore për pajisjet mjekësore, qendrat shëndetësore dhe spitalet. Njëkohësisht, janë hartuar udhëzimet dhe protokollet klinike për sëmundjet më të përhapura kronike, si dhe për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve më të shpeshta në shërbimin spitalor.

203. Janë marrë masat e nevojshme për përmirësimin e menaxhimit të të dhënave të sistemit shëndetësor. Krahas platformës elektronike të recetave, është hartuar edhe manuali *Treguesit e Përbashkët të Kujdesit Shëndetësor* (2014) për Shqipërinë, i cili mbulon mbi 100 tregues, duke përfshirë edhe ato të ushqyerjes dhe mirëqenies së fëmijës.

204. Përmirësimi i performancës dhe cilësisë së qendrave të këshillimit për nënat dhe fëmijët në Kujdes Shëndetësor Parësor (KSHP) ka qenë pjesë e reformës të sistemit të shëndetësisë. Madje, për këto qendra u hartuan edhe standardet, udhëzimet, protokollet dhe instrumentet përkatëse. Këtu përfshihet urdhri i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 469/2013 'Për miratimin e udhëzimeve për klinikën praktike në kujdesin shëndetësor parësor për monitorimin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0–6 vjeç'. Ky është ndjekur nga një sërë protokollesh të tjera klinike. Për më tepër, përmes urdhrit të ministrit të Shëndetësisë nr. 470/2013 është përgatitur dhe miratuar një paketë treguesish për shërbimet e qendrave të këshillimit për nënat dhe fëmijët, e cila mbështetet nga udhëzimet për monitorimin e grave gjatë shtatzënisë, dhe pas lindjes, si dhe për rritjen e fëmijëve 0–6 vjeç. Të gjitha këto akte janë të përafruara me praktikat e mira ndërkombëtare dhe me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

205. Në qershor të vitit 2016, u përgatitën Strategjia dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017–2021(SHSR), të cilët synojnë përmbushjen e standardeve më të larta të shëndetit riprodhues për të gjithë qytetarët, duke u përqendruar veçanërisht te shëndeti i grave, fëmijëve dhe adoleshentëve. Strategjia u mbështet te gjetjet e rishikimit të strategjisë së parë për SHSR 2009–2015. Ndërhyrjet dhe objektivat e strategjisë mbështeten te rekomandimet ndërkombëtare lidhur me SHSR-në dhe mbulojnë ndërhyrjet e integruara dhe gjithëpërfshirëse, të cilat përfshijnë mëmësinë e sigurt, planifikimin familjar, shëndetin e foshnjave dhe fëmijëve (përmirësimin e situatës së ushqyerjes, parandalimin e sëmundjeve infektive të parandalueshme, mirërritjen dhe zhvillimin), shëndetin e adoleshentëve (SHSR-në e adoleshentëve, edukimin për aftësitë e jetës), kancerin e sistemit riprodhues, dhunën në familje (identifikimi, parandalimi dhe menaxhimi i dhunës ndaj grave dhe fëmijëve nga punonjësit e sistemit të shëndetësisë), shterpësinë dhe shëndetin elektronik. Për çdo fushë me përparësi, janë përcaktuar objektivat me treguesit e tyre përkatës.

206. Udhëzimet dhe protokollet janë hartuar për të garantuar ofrimin e shërbimeve të integruara të SHSR-së. Ofruesve të shërbimit iu mundësohet forcimi i kapaciteteve për përdorimin e këtyre shërbimeve. Paketa e Shërbimeve Minimum Fillestare për SHSR-në në kriza humanitare dhe situata emergjencash është zbatuar përmes mbështetjes nga donatorët. Përmes disa workshop-eve, tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave është përmirësuar krijimi i koalicioneve dhe koordinimi ndërmjet palëve kyçe të interesit për prioritetet e SHSR-së. Është krijuar edhe një rrjet i edukatorëve shëndetësore të SHSR-së. Me nisjen e vitit akademik 2017–2018, kurrikula e sistemit arsimor parauniversitar përfshiu edhe edukimin seksual.

207. Në Paketën Bazë të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor janë përfshirë edhe shërbimet e planifikimit familjar. Në janar të vitit 2016, me urdhrin nr. 25, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratoi një paketë udhëzimesh dhe protokollesh për planifikimin familjar si standard kombëtar për ofrimin e shërbimeve të planifikimit familjar në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, që nga qendrat e kujdesit ambulator deri te shërbimet e referimit në maternitet. Udhëzimet dhe protokollet janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përshtatura me

kontekstin shqiptar. Shërbimet e planifikimit familjar ofrohen falas përmes sistemit të shëndetit publik në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, qendrat ambulatore të kujdesit, qendrat e planifikimit familjar dhe në maternitetet e rretheve, ose nga OJF-të. Numri i qendrave të planifikimit familjar në të 36 rrethet është 425, të cilat janë të integruara në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor dhe ofrojnë kontraceptivë modernë falas. Në zonat rurale, mamitë ofrojnë këshillim lidhur me planifikimin familjar për gratë shtatzëna gjatë vizitave në shtëpi.

208. Janë marrë një sërë masash për parandalimin e kancerit të mitrës falë dhënies përparësi të parandalimit, diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit të sëmundjeve kanceroze në sistemin riprodhues të grave në rang kombëtar. Është hartuar Programi Kombëtar për Kontrollin e Kancerit 2011–2020. Në tetor të çdo viti, organizohen një sërë veprimtarish ndërgjegjësuese për kancerin e gjirit. Me urdhrin e ministrit të Shëndetësisë në tetor të vitit 2013, personat që vuanin nga kanceri dhe gratë shtatzëna u përjashtuan nga tarifa e shërbimeve mjekësore.

209. Në bashkëpunim me OBSH-në dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), u hartua paketa e trajnimit "Kujdesi efikas perinatal" për personelin e maternitetеve në vend. Kjo paketë trajnimi ishte pjesë e programit të arsimit në vazhdim për certifikimin e personelit të shëndetësisë. Janë trajnuar punonjësit e disa maternitetеve rajonale, si në Shkodër, Vlorë, Korçë, Kukës, Durrës dhe Tiranë, si dhe janë organizuar disa seanca të tjera trajnimesh për personelin shëndetësor. Në vitin 2017 u miratua Plani i Veprimit të promocionit Shëndetësor 2017–2021, dokument i cili adreson nevojën për ndërhyrje për përmirësimin e shëndetit të fëmijëve. Dokumenti specifikon objektiva që synojnë përmirësimin e stilit të jetesës së fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të ushqyerjes dhe aktivitetit fizik, redukimit të sjelljeve të rrezikshme shëndetësore dhe përmirësimit të higjienës personale.

Aksesi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në kujdesin shëndetësor

210. Në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet UNICEF-it, ISHP-së dhe Drejtorive të Shëndetit Publik, aksesi i komunitetit rom dhe egjiptian në kujdes shëndetësor po përmirësohet gjithnjë e më shumë. Në vitet 2016 dhe 2017 iu është ofruar informacion, diagnostikim bazë dhe ndihmë e parë përmes ekipeve mjekësore të lëvizshme 10.258 romëve dhe egjiptianëve në vendbanime të padeklaruara, që nuk figuronin në sistemin kryesor (p.sh për shkak të mungesës së dokumenteve personale, certifikatave të banimit ose sigurimit shëndetësor). Për më tepër, në vitin 2016, u krye vlerësimi i njohurive rreth shëndetit dhe praktikës së rritjes së fëmijëve 0–5 vjeç në nivel komuniteti në Durrës, duke përfshirë edhe komunitetet rome dhe egjiptiane, ndjekur nga një sërë rekomandimesh, të cilat synonin përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës në këto komunitete.

211. Imunizimi ofrohet falas për të gjithë popullsinë, por vëmendje e veçantë i kushtohet identifikimit dhe ofrimit të imunizimit për grupet e margjinalizuara/në rrezik (komuniteti rom, popullsia në zonat rurale). Për të identifikuar fëmijët e pavaksinuar në komunitetin rom dhe egjiptian, ISHP-ja kryen ekzaminimin e përvitshëm në zonat ku jetojnë këto familje. Infermieret e imunizimit bashkëpunojnë me punonjësit socialë, ose me ndërmjetësit për të përmirësuar komunikimin me komunitetin dhe vaksinuar sa më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë, teksa shkojnë derë më derë për të identifikuar fëmijët dhe kryer vaksinat.

Kequshqyerja e fëmijëve dhe ushqyerja vetëm me gji[50]

212. Janë marrë disa masa për parandalimin dhe trajtimin e kequshqyerjes dhe pasigurisë ushqimore për nënat dhe foshnjat. Në vitin 2014 me mbështetjen e UNICEF-it u pilotua Sistemi i Mbikëqyrjes së Praktikave të Ushqyerjes së fëmijëve 0–5 vjeç. Ky sistem është një platformë online për raportimin dhe analizimin e treguesve të praktikave të ushqyerjes së fëmijëve 0–2 vjeç dhe indikatorëve të rritjes për fëmijët 0–5 vjeç në ato qarqe që kishin nivele të larta anemie dhe kequshqyerje (Kukës, Shkodër, Tiranë – zonat periurbane). Bazuar në urdhrin e ministrit të Shëndetësisë janë trajnuar të gjithë punonjësit shëndetësorë që janë përgjegjës për shëndetin e fëmijëve në kujdesin shëndetësor parësor (qendrat shëndetësore dhe konsultoret e fëmijës) mbi

[50] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimet 61 adhe 61 f

raportimin e këtyre indikatorëve. Prej vitit 2017 drejtoritë e shëndetit publik raportojnë indikatorët e mësipërm në platformën on line të këtij sistemi.

213. Gjatë periudhës 2011–2013, me mbështetjen e OBSH-së, UNICEF-it dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë u zbatua Programi Kombëtar për Reduktimin e Kequshqyerjes së Fëmijëve në Shqipëri. Dokumenti strategjik i Komunikimit për Ushqyerjen u miratua me urdhër të ministrit të Shëndetësisë nr. 86/2012 dhe në mars të vitit 2012 u organizuan fushata ndërgjegjësuese për përmirësimin e ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve në Shqipëri. Gjatë periudhës 2011–2013, në rajonet verilindore, u organizuan fushata për të komunikuar ndryshimet lidhur me përdorimin e televizorit, reklamave radiofonike dhe posterave, duke përfshirë pajisjen e qendrave shëndetësore me aparate TV dhe DVD për transmetimin e reklamave dhe mesazheve lidhur me ushqyerjen e fëmijëve. U krijua faqja e internetit www.fëmijaim.com dhe një faqe Facebook-u për të informuar dhe ftuar të gjitha nënat e reja të shkëmbenin mendimet e tyre për ushqyerjen e fëmijëve.

214. Në vitin 2012–2013, Kryqi i Kuq Shqiptar, në bashkëpunim me MSH-në (aktualisht MSHMS), zbatoi projektin "Përmirësimi i Praktikave të Ushqyerjes për Fëmijët 0–5 vjeç" me mbështetjen e UNICEF-it në katërmbëdhjetë komuna të qarqeve Kukës dhe Shkodër, si dhe në zonat periurbane të Tiranës. Projekti promovonte ushqyerjen me gji, ushqimin suplementar me ushqime të shumëllojshme, të përshtatshme dhe cilësore, si dhe edukimin për elementët ushqyes. Nga projekti përfituan 14.191 persona, prej të cilëve: 7.251 fëmijë 0–5 vjeç, 1.200 gra shtatzëna, 5.500 gra të moshës 15–49 vjeç dhe 240 vullnetarë komunitarë.

215. Janë marrë një sërë masash për promovimin e ushqyerjes me gji. Aktualisht, mbi 50 për qind e të gjithë maternitetеve në Shqipëri, duke përfshirë edhe ato rajonale, janë certifikuar si Spitale Miqësore me Foshnjat, që i përmbahen procesit me 10 hapa të ushqyerjes me gji në shërbimet e maternitetit (nisma e OBSH-UNICEF që mbështet dhe mbron ushqyerjen me gji). Që prej vitit 2015, nisma është shtrirë në shkallë komuniteti, duke filluar me qarkun e Durrësit, ku gjashtë qendra komunitare janë certifikuar si miqësore me foshnjat.

216. Ligji për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji (1999) u rishikua dhe u përshtat me Kodin Ndërkombëtar të Tregtimit të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit (ligji nr. 53/2016), dhe u pasua me hartimin e dy rregulloreve: VKM nr. 116/2017, që rregullon etiketimin e produkteve zëvendësuese të qumështit të gjirit, dhe urdhri i ministrit të Shëndetësisë nr. 179/2017, që rregullon përmbajtjen edukuese dhe informuese për ushqyerjen e foshnjave dhe fëmijëve. Masat e parashikuara përfshijnë trajnimin e personelit të ISHP-së dhe specialistëve të Inspektoratit të Shëndetësor dhe masat për nxitjen e ushqyerjes vetëm me gji.

217. Gjatë periudhës maj-qershor të vitit 2017, ISHP-ja ndërmori studimin për kuadrin ligjor dhe politikat që mbështesin programin kombëtar të integruar shumësektorial të ushqyerjes nëpër shkolla dhe vlerësimin e situatës dhe njohurive rreth ushqyerjes, qasjeve dhe praktikave lidhur me zakonet e ushqyerjes së fëmijëve në moshë shkollore në Shqipëri për vitin 2017–2018. Studimi është në proces botimi (Aneksi 2.6.3).

218. Në vitin 2011 janë përgatitur modulet e integruara të trajnimeve për gratë shtatzëna dhe ushqyerjen e fëmijëve, mbështetur në risitë moderne të kohëve të fundit për ushqyerjen e këtyre grupeve dhe kurbave të reja të rritjes sipas monitorimeve të OBSH-së, të cilat janë miratuar falë trajnimit të personelit nga Qendra Kombëtare e Arsimit në Vazhdim. Mbi bazën e këtyre moduleve janë trajnuar 700 mjekë dhe infermierë të përgjithshëm të ISHP-së. Janë organizuar edhe disa trajnime të tjera shtesë nga ISHP-ja për përmirësimin e ushqyerjes së fëmijëve, duke u përqendruar në ushqyerjen e shëndetshme, parandalimin e obezitetit dhe treguesit e ushqyerjes.

219. Në vitin 2016, MSH-ja (aktualisht MSHMS) përgatiti një paketë trajnimi për zbatimin e kujdesit pre-postnatal dhe postnatal infermieror dhe maternitor dhe në bashkëpunim me OBSH-në/UNFPA-në u hartua paketa e trajnimit për kujdesin efikas perinatal për personelin e maternitetеve dhe kujdesit të fëmijëve në vend. Kjo paketë trajnimi ishte pjesë e programit të arsimit në vazhdim për certifikimin e personelit të shëndetësisë.

220. Në prill të vitit 2018, me vendim të ministrit të MSHMS-së u krijua Komitetit Kombëtar për Çrregullimet e Pamjaftueshmërisë Jodike. Kjo pritet të sjellë fokus dhe angazhim të ri për programin e jodizimit të përgjithshëm të kripës në Shqipëri me qëllimin përfundimtar arritjen e ushqyerjes optimale të qëndrueshme për gratë shtatzëna dhe fëmijët në Shqipëri. Me mbështetjen e UNICEF-it, u rishikua kuadri ligjor ekzistues për JPK-në nga një grup pune ndërinstitucional, i ngritur nga ministri me pjesëmarrës nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, MSHMS-ja dhe Instituti i Shëndetit Publik. Ligji i rishikuar për jodizimin e përgjithshëm të kripës u nda për komente ndërmjet ministrive të linjës, ndërsa dorëzimi i tij në parlament pritet brenda vitit 2018.

Shëndeti i adoleshentëve[51] [VP 63]

221. Me ndihmën e UNDP-së, janë hartuar dhe miratuar udhëzime dhe protokolle lidhur me shërbimet e shëndetit për adoleshentët. Këto dokumente përfshijnë edhe nevojat më të ngutshme dhe të dukshme që duhen adresuar nga shërbimi shëndetësor. Plani Kombëtar për Rininë 2015–2020 përfshin një sërë masash për përmirësimin e shëndetit të adoleshentëve. Gjithashtu, aktualisht një grup teknik pune po harton Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve dhe Adoleshentëve.

222. MSH-ja dhe MASR-ja kanë ndërmarrë reformimin rrënjësor të shërbimeve shëndetësore në shkolla, duke përcaktuar rolin e mjekëve dhe profesionistëve të tjerë të shëndetit që kujdesen për shëndetin e nxënësve në shkollat nëntë vjeçare dhe të mesme në vend. Në vitin 2012, u hartua një paketë me dymbëdhjetë kapituj/module për promocionin shëndetësor sipas modelit të OBSH-së, të cilët do të përdoreshin nga mësuesit, mjekët, infermierët, dentistët, dhe psikologët. Paketat mbulojnë një larmi temash, duke përfshirë ndër të tjera edhe dhunën, SHSR-në, shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike, ushqyerjen, HIV-in dhe përdorimin e drogës.

Përdorimi i drogës[52]

223. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përmban një nen, i cili i mbron fëmijët nga përdorimi i alkoolit, duhanit, lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope dhe i ngarkon institucionet përkatëse shtetërore një mori përgjegjësish në këtë drejtim. Dispozitat përforcojnë ligjin nr. 9518/2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit", i cili ndalon përdorimin e alkoolit nga të miturit dhe përcakton një sërë masash mbrojtëse në këtë fushë, duke përfshirë reklamimin, dhe ligjin nr. 963/2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i cili përcakton masat kufizuese për përdorimin e duhanit nga të miturit.

224. Instituti i Shëndetit Publik bëri një vlerësim të situatës së përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave nga fëmijët në moshë shkollore përmes studimit "Sjelljet Shëndetësore të Fëmijëve në Moshë Shkollore", i cili u krye në shkolla me 11, 13 dhe 15-vjeçarë (2013/2014) dhe Studimit Evropian për Përdorimin e Alkoolit dhe Drogave të Tjera nga të Rinjtë në Shqipëri, i cili synonte fëmijët 14–16 vjeç (2015)[53].

225. Dokumenti i Politikës së Strategjisë për Parandalimin dhe Minimizimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Alkooli (2011–2015) parashikon një sërë ndërhyrjesh me synim fëmijët, duke përfshirë masa informuese, edukuese (në shkolla dhe familje), ligjore dhe fiskale për të shmangur dhe minimizuar incidentet e shkaktuara nga alkooli që mund t'i ndodhin fëmijëve dhe të rinjve, si dhe pasojat e tyre.

226. Në kuadrin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Drogës 2012–2016, janë ndërmarrë një sërë veprimtarish, për të parandaluar përdorimin dhe abuzimin me substanca nga adoleshentët dhe të rinjtë shqiptarë, duke përfshirë edhe fushata ndërgjegjësimi në shkolla në kuadër të Ditës Botërore e Luftës Kundër Drogës. Pas Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është zbatuar programi "Edukim, ndërgjegjësim dhe ulje të kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme" gjatë periudhës 2014–2017, duke u përqendruar në ndërgjegjësimin për abuzimin me drogat dhe

[51] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 63
[52] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 63 B
[53] Aneksi 2.6.4 bashkëlidhur Raportit

substanca të tjera të rrezikshme për nxënësit e klasës së gjashtë në shkollat fillore. Programi depërtoi te 18.000 nxënës në vit në mbi 300 shkolla pjesëmarrëse.

227. Projektstrategjia e re Kombëtare për Kontrollin e Drogës i kushton vëmendje të madhe përmirësimit të sistemit të trajtimit kundër drogës, i cili përfshin ofrimin e trajnimeve për personelin e kujdesit shëndetësor parësor dhe në familje mbi bazën e koncepteve kryesore të parandalimit, parandalimit të hershëm, rasteve të referimit, krijimit të mjediseve për trajtimin e specializuar të varësisë nga droga dhe ekipeve shumëdisiplinore në gjashtë spitale rajonale në vend, si dhe përfshirjes së varësisë nga droga në skemat e sigurimeve etj. Këto masa do të adresojnë aktualisht kapacitetet e papërshtatshme për trajtimin dhe kërkesën në rritje për trajtim (aktualisht përllogariten rreth 8,000–10,000 përdorues problematikë të drogës të të gjitha moshave). Aktualisht, ekziston vetëm një qendër publike për shërbimet e varësisë, e specializuar në trajtimin terapeutik të varësisë, e cila kuron 800–900 pacientë në vit. Institucionet e tjera jopublike ofrojnë shërbime të kufizuara.

228. Trajnimet përqendroheshin në efektet dhe metodat e trajtimit shumëdisiplinor të varësisë nga droga, që synonin mjekët e familjeve dhe të shkollave, infermierët dhe punonjësit e promovimit të kujdesit shëndetësor parësor.

Shëndeti mendor[54]

229. Kreu III "Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët" i ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" përcakton se ofrimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët bazohet te parimi i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe është pjesë përbërëse tejet e veçantë e shërbimeve të shëndetit mendor. Është hartuar një kuadër rregullator shumë i pasur për të siguruar zbatimin e ligjit, duke filluar nga Rregulloret për Shërbimet e Shëndetit Mendor deri te standardet për ngritjen e komisioneve mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar për ata njerëz që vuajnë nga çrregullimet e shëndetit mendor etj. Ky ligj shmang edhe shtrimin fiktiv në spital në shërbimet spitalore, duke korrigjuar praktikën e papërshtatshme dhe abuzive, si nga pikëpamja e ofruesve të shërbimit edhe nga pikëpamje e përdoruesve të shërbimit, lidhur me detyrimin e pacientit me çrregullime mendore që të pranohet në shërbimet e specializuara spitalore të shëndetit mendor me qëllimin e vetëm rishikimin e diagnozës spitalore nga Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Aftësisë për Punë/Aftësisë së Kufizuar.

230. Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013–2020 u miratua në vitin 2013. PKV-ja mbështetet në parimet e mbrojtjes së të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe nevoja të veçanta, si dhe adresimin e përjashtimit dhe diskriminimit shoqëror, përmes një rrjeti të integruar shërbimesh të shëndetit mendor për trajtim social, rehabilitim dhe riintegrim. Mbi bazën e të njëjtave parime është planifikuar një plan veprimi dedikuar shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët në të ardhmen e afërt.

231. Në Shqipëri ka nëntë qendra komunitare të shëndetit mendor, tri nga të cilat kanë një ekip komunitar shumëdisiplinor të specializuar në shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve (dy në Tiranë; një Shkodër). Në Qendrën Kombëtare të Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve ofrohet kujdes i specializuar shumëdisiplinor për fëmijët 0–6 vjeç që përballen me vonesa zhvillimore të një natyre kryesisht të shëndetit mendor. Ajo ofron kujdes jospitalor për fëmijët nga Tirana dhe kujdes spitalor për fëmijët që referohen nga zonat e tjera të vendit. Klinika Psikiatrike e Fëmijëve dhe Adoleshentëve, pranë Spitalit Universitar Nënë Tereza, ofron kujdes spitalor dhe jospitalor (referuar nga kujdesi parësor dhe dytësor në mbarë vendin), duke krijuar një tipologji unike shërbimesh.

HIV/AIDS[55]

232. Pavarësisht shtimit të numrit të rasteve, Shqipëria mbetet një vend me prevalencë të ulët (më e vogël se 0,4% në vitin 2011) të HIV/SIDA-s në popullsinë e përgjithshme. Midis periudhës 1993–2017, u regjistruan 1,103 raste të diagnostikuara të infektimit me HIV në Shqipëri, nga të

---

[54] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 62.

[55] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 65

cilat 42 ishin raste të fëmijëve të infektuar me HIV (0–15 vjeç). Numri i rasteve të regjistruara së fundmi është rritur, me një mesatare nga gjashtë ose shtatë raste për vit për periudhën1993–2000, dhe në 40–60 raste pas vitit 2010, për arsye të ndryshme, si dhe shtimit të numrit të testimit pas referimeve nga mjekët. Shpërndarja sipas moshës tregon mbizotërimin e HIV/SIDA-s në gupmoshën 35–44 vjeç me 29,3%, e ndjekur nga grup-mosha 25–34 vjeç me 27,7%, grup-mosha 16–24 vjeç me 9,4% dhe fëmijët 0–15 vjeç me 3,9%.

233. Që prej vitit 2004, trajtimi me terapi antiretrovirale është ofruar falas pavarësisht gjinisë, racës, apo përkatësisë në grupe të cenueshme. Në Drejtoritë e Shëndetit Publik veprojnë katërmbëdhjetë qendra për testimin dhe këshillimin vullnetar për HIV/SIDA-n, të cilat ofrojnë shërbime parandaluese për të gjithë popullsinë. Për më tepër, ofrohet edhe këshillim për gratë shtatzëna në qendrat e planifikimit familjar në poliklinika dhe maternitete. Në Spitalin Universitar të Obstretikës dhe Gjinekologjisë u ngrit qendra e Referimit për parandalimin e transmetimit nga nëna te fëmija.

234. Në vitin 2014, u përgatitën udhëzimet kombëtare për agjentët infektivë të transmetuar nga nëna te fëmija, të cilat përcaktonin edhe standardet e analizimit për parandalimin e këtij transmetimi. Në vitin 2015, u përgatitën udhëzimet për menaxhimin e HIV-it te gratë shtatzëna, që synonin të ndihmonin dhe të informonin ofruesit e kujdesit shëndetësor në ofrimin e këtyre shërbimeve për gratë shtatzëna me HIV.

235. Reduktimi i transmetimit të HIV-it nga nëna te fëmijët përmes punës parandaluese dhe sigurimit të kujdesit të duhur për fëmijët dhe prindërit me HIV/SIDA është një prej objektivave kryesore të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e HIV/SIDA-s 2015–2019. Masa të tjera përfshijnë ndërgjegjësimin, testimin dhe njohjen e statusit dhe kujdesit për HIV-in, si dhe kujdesin perinatal të fëmijëve me nëna pozitive ndaj HIV-it, duke përmirësuar informimin e personelit mjekësor, reduktimin e stigmatizimit dhe diskriminimit etj.

236. Janë marrë masa në shkolla për transmetimin e HIV-it, të cilat përfshijnë trajnimin e mësuesve, ndërgjegjësimin e prindërve dhe nxënësve, përgatitjen e fletëpalosjeve informuese dhe transmetimin e emisioneve televizive. Në kurrikulën bërthamë të klasës së dhjetë përfshihen edhe tema për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, të cilat diskutohen në lëndën e biologjisë (shëndeti dhe sëmundjet e transmetueshme). Kurrikula u rishikua në vitin 2016 nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA). Në dhjetor të vitit 2016, IZHA organizoi konferencën kombëtare "Edukimi shëndetësor me fokus në edukimin seksual si aftësi për jetën".

Standardi i jetesës[56]

237. Sistemi shtetëror i mbrojtjes sociale përfshin masa të ndryshme që garantojnë një standard të përshtatshëm jetese dhe jete të denjë për këdo. Ai përfshin ndihmën ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar. Që prej vitit 2014, fëmijët e familjeve që përfitonin ndihmë ekonomike marrin një pagesë shtesë prej 300 lekësh në muaj për arsimin e detyrueshëm dhe 100 lekësh për çdo vaksinim.

238. Vërehen përmirësime lidhur me digjitalizimin e shërbimeve sociale. Për shembull, përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike i lehtëson përfituesit procesin e aplikimit për ndihmë ekonomike, ndërsa verifikimi i saktë i informacionit me sistemet e tjera kontribuon në reduktimin e abuzimeve me skemat e ndihmës ekonomike (deri në janar të vitit 2018, janë identifikuar 20.000 mijë familje). Shifrat pasqyrojnë një ulje gjatë viteve të fundit të numrit të familjeve përfituese me fëmijë deri në moshën 18-vjeçare: në vitin 2017 kishte 36,711 familje me fëmijë që përfitojnë ndihmë ekonomike krahasuar me 74,215 në vitin 2012. Megjithatë, kjo ulje mund të shpjegohet edhe me riorganizimin e skemës së përfitimit që synon kategoritë më të cenueshme, duke sjellë në këtë mënyrë rritjen e pagesave mujore për çdo familje dhe përjashtimin e përfitimeve të pjesshme.

---

[56] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 67.

239. Një element shtesë i sistemit të ndihmës ekonomike ka qenë edhe riorientimi i saj ndaj masave aktive të riintegrimit social. U krijua programi i ri i nxitjes së punësimit (VKM nr. 162/2018), i cili synonte përfituesit e ndihmës ekonomike, kryefamiljaret gra dhe ata që kishin dalë nga skema për shkak të reformës së ndihmës ekonomike. Programi i dha mundësinë pjesëmarrësve të regjistroheshin falas në kurset e formimit profesional dhe ofronte një pagesë mujore prej 6.000 lekësh gjatë ndjekjes së tyre. Në shkurt të vitit 2018, u nënshkrua marrëveshja midis SHSSH-së dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit për ofrimin e formimit profesional dhe integrimit në tregun e punës të anëtarëve në moshë për punë të familjeve në nevojë. Deri më sot, janë punësuar 2,475 individë që kanë qenë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike.

240. Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe disa VKM synojnë reformimin e sistemit të shërbimeve shoqërore në Shqipëri, duke siguruar një sistem më të integruar dhe funksional të mbrojtjes sociale në njësitë e qeverisjes vendore, ku përfitimet në të holla, shërbimet dhe sistemi i referimit integrohen me qëllim sigurimin e mbrojtjes sociale të atyre që janë më shumë në rrezik. Kuadri i ri ligjor parashikon disa transformime në këtë sektor për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse dhe të qëndrueshme të kujdesit shoqëror, identifikimin e individëve dhe familjeve më në nevojë, përcaktimin e nevojave të tyre, planifikimin dhe sigurimin e modeleve të ofrimit efikas të shërbimit, forcimin e kapitalit njerëzor, dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare dhe mekanizmave të kontrollit të cilësisë. Ky ligj parashikon edhe krijimin e një fondi të veçantë, një mekanizmi të ri financiar që funksionon në nivel vendor për të financuar planet e kujdesit shoqëror dhe shërbimet shoqërore.

241. Reforma parashikon ndryshime strukturore të ligjit, duke përfshirë ngritjen e drejtorive të mirëqenies sociale përgjegjëse për hartimin e planeve vendore të kujdesit shoqëror, të cilat përcaktojnë shërbimet e kujdesit që do të ofrohen në territorin përkatës, dhe për reagimin ndaj nevojave të kategorive më të cenueshme. Kjo drejtori do të mbikëqyrë njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit, sektorin e kujdesit shoqëror, NJMF-të dhe strukturat e dhunës në familje. Strukturat e reja do të mbështeten nga sistemi i integruar i informacionit.

242. Reforma parashikon edhe forcimin e rolit dhe autoritetit të punonjësve socialë, si dhe përmirësimin e aftësive profesionale. Ligji nr. 163/2014 "Për urdhrin e punonjësve socialë" përcakton kriteret për ushtrimin e profesionit dhe garantimin e standardeve etike dhe profesionale. VKM-ja nr. 826/2015 përcakton rregullat për sigurimin e kualifikimit të profesionistëve që bëjnë punë sociale.

243. Aktualisht, është ngritur Komisioni i Përkohshëm, i cili i ushtron funksionet e tij deri në zgjedhjet e para të urdhrit të punonjësve socialë. Ky komision kryesohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve publike dhe jopublike të kujdesit shoqëror, akademisë, shoqatave dhe MSHMS-së ndër të tjera.

244. Ligji i ri nr. 22/2018 "Për strehimin social", i cili do të hyjë në fuqi në nëntor të vitit 2018 dhe do të shfuqizojë ligjin e mëparshëm që rregullonte këtë fushë, ndalon dëbimin me forcë dhe përcakton procedurat që duhen ndjekur nga NJQV-të për risistemimin e familjeve. Neni 76/9 i ligjit nr. 22/2018 i jep përparësi familjeve të komuniteteve rome dhe egjiptiane si kategori parësore lidhur me aksesin në strehim social dhe parashikon për familjet e këtyre komuniteteve një kuotë jo më të vogël se 2% të vendeve në çdo program. Vlerësimi i këtyre masave parashikohet të kryhet për dy vite pas hyrjes në fuqi të ligjit.

245. Përmirësimi i kushteve të strehimit për përfaqësuesit e komuniteteve rome dhe egjiptiane është një prej objektivave të Strategjisë Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, ndërsa masat përkatëse përfshihen edhe në Strategjinë e Strehimit Social 2016–2020 dhe në Planin e saj të Veprimit (p.sh ofrimi falas i ndihmës ligjore për proceset ligjore, përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes së familjeve rome dhe egjiptiane në programin e strehimit, hartëzimi i investimeve me përparësi në këto komunitete, grantet e vogla për bashkitë për infrastrukturën e re, ujësjellësi dhe kanalizimet në komunitete).

I. Arsimi. Koha e lirë dhe veprimtaritë kulturore

Aksesi në arsim[57] [VP 71 E]

[57] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 71 E

246. Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", ndryshuar, është gjithëpërfshirës dhe i garanton gjithkujt, pa dallim, të drejtën kushtetuese për arsim. Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2014–2020 synon të sigurojë arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, duke filluar me arsimin parashkollor.

247. Janë miratuar disa akte nënligjore dhe masa për të rritur aksesin në arsim për fëmijët në situata të pafavorizuara ose të cenueshme (duke përfshirë fëmijët romë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga zonat rurale etj.). Këto masa përfshijnë transportin falas për të gjithë fëmijët që ndjekin kopshtin ose shkollën në një distancë më të largët se dy km nga shtëpitë e tyre, caktimin e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbulimin e kostove të strehimit dhe arsimimit për shkollat rezidenciale, dhe ofrimin e bursave dhe vakteve falas.

248. Çdo vit parashikohet në buxhet fondi i veçantë për ofrimin e librave shkollorë falas, përmes së cilit ofrohen libra shkollorë falas për kategori të ndryshme të fëmijëve nga grupe të pafavorizuara (fëmijët, prindërit e të cilëve marrin ndihmë ekonomike apo pagesë papunësie, jetimët, fëmijët që i përkasin pakicave kombëtare, fëmijët migrantë, fëmijët e familjeve me aftësi të kufizuara, familjet në nevojë, viktimat e trafikimit etj.)"Në vitin 2017–2018, u rimbursuan 82.815 nxënës për librat shkollorë falas në vlerën 268,7 milion lekë. Nga shtatori 2018, u ofruan libra shkollorë falas për të gjithë nxënësit nga klasa e parë në të katërtën dhe për 16 kategori nxënësish nga grupet e pafavorizuara. "Me vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", të ndryshuar, është miratuar dhënia në përdorim falas e teksteve shkollore për të gjithë fëmijët nga klasa e parë deri në të katërt, duke filluar nga viti shkollor 2018–2019. Vetëm këtë vit nga ky vendim përfituan 122 854 nxënës të klasave 1–4 të arsimit fillor.

Aksesi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsim

249. Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar në shkolla po rritet, ndërsa braktisja e shkollës prej tyre po ulet. Në vitin akademik 2016/2017, u regjistruan 12,685 vajza dhe djem romë dhe egjiptianë, të cilët ndjekin arsimin parashkollor, arsimin fillor dhe atë të mesëm të lartë[58].

250. Progresi është një rezultat i përbashkët i masave të ndryshme të përfshira në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020 në fushën e arsimit. Ato përfshijnë 1) përjashtimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë nga tarifa e arsimit parashkollor dhe të detyrueshëm, 2) organizimin e kurseve pas shkolle ku prindërit e paarsimuar romë dhe egjiptianë të mund të marrin pjesë dhe të mësojnë të shkruajnë së bashku me fëmijët e tyre, 3) përfshirja në klasat mbështetëse nga klasa e pestë deri në të nëntën për fëmijët me vështirësi në të nxënë, 4) ofrimi i librave shkollorë falas (për arsimin e detyrueshëm dhe me mbështetjen e donatorëve për arsimin dytësor), 5) sigurimi i transportit falas në shkolla nëse ndodhen më larg se 2 km nga shtëpia, 6) krijimi i një bazë të dhënash për fëmijët parashkollorë dhe ata që ndjekin arsimin e detyrueshëm (duke përfshirë romët dhe egjiptianët), 7) përmirësimi i identifikimit të vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë që nuk ndjekin arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm për të siguruar regjistrimin e tyre, 8) organizimi i mbledhjeve periodike me prindërit e romëve dhe egjiptianëve në vendbanimet e tyre për çështje që lidhen me rëndësinë e arsimit të detyrueshëm dhe 9) referimi i familjeve të fëmijëve që braktisin ose janë të predispozuar të braktisin arsimin e detyrueshëm në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe burime të tjera mbështetëse.

251. Edhe familjet rome dhe egjiptiane, fëmijët e të cilave e ndjekin shkollën rregullisht dhe janë të vaksinuar, përfitojnë nga ndihma ekonomike shtesë për të nxitur ndjekjen e rregullt të shkollës.

252. Për vitin 2018–2019, u ndryshua VKM-ja nr. 680/2015 "Për masat për nxitjen e mësimnxënies, ndjekjes dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë në shkollën nëntë vjeçare "Naim Frashëri"", e cila ndodhet në Korçë, në një zonë të populluar nga romët. Kjo masë i

[58] Aneksi 2.7.2 bashkëlidhur Raportit.

siguron afro 300 nxënësve bursa ditore (76 lekë në ditë) për 170 ditë shkollore masë i siguron afro 300 nxënësve bursa ditore (76 lekë në ditë) për 170 ditë shkollore (bursa prej 4.000.000 lekësh në total)

253. MASR-ja po i jep përparësi përfshirjes së fëmijëve romë në arsimin e hershëm. Prandaj, në kuadër të nismës "Çdo fëmijë rom në kopsht", u miratua udhëzimi nr. 21/2014 "Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë". Të dhënat tregojnë se 962 fëmijë romë dhe 1,567 egjiptianë ndoqën arsimin parashkollor në vitin akademik 2016/2017.

254. Ligji nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë" parashikon përfshirjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe fesë së pakicave kombëtare në veprimtaritë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë, në librat shkollorë të arsimit bazë dhe mbështetje për formimin e mësuesve që do të japin mësim në gjuhën e pakicave kombëtare.

255. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016–2020 parashikon zhvillimin e një kurrikule në gjuhën rome për arsimin bazë (nga klasa e gjashtë në klasën e nëntë) dhe kurrikulën e shkrim-leximit për kurset kundër analfabetizmit. Programi i gjuhës përmban informacione edhe për historinë dhe kulturën e romëve. Aktualisht, sistemi për mësuesit e diplomuar në gjuhë rome është ende në fazë zhvillimi dhe deri më tani nuk është trajnuar asnjë. Është hartuar edhe paketa e moduleve për historinë dhe kulturën rome dhe përfshirjen e tyre në kurrikul, e cila përfshin trajnimin e mësuesve, dhe hartuesve të kurrikulave dhe librave shkollorë. "Me urdhrin nr. 754, datë 9.11.2018 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është miratuar programi i gjuhës rome për nxënësit e klasës VI-IX dhe prej vitit shkollor 2018–2019, ky program mësimor është pjesë e kurrikulës zyrtare të arsimit bazë".

256. Megjithëse Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare nuk është ratifikuar ende, ajo është përfshirë si pjesë e profilit të edukimit gjuhësor.

Aksesi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim[59]

257. Numri i regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara (FAK) në sistemin arsimor është rritur, pasi gjatë vitit akademik 2016–2017 3.252 fëmijë ndiqnin shkollat e zakonshme dhe 659 shkollat speciale. Për krahasim, në vitin akademik 2013/2014, në shkollat e zakonshme dhe ato speciale ishin regjistruar 2,842 fëmijë me aftësi të kufizuara. Të dhënat për të gjitha kategoritë e FAK-s, të kategorizuara sipas moshës/gjinisë dhe aftësisë së kufizuar janë mbledhur nga arsimi parashkollor nga MASR që prej fillimit të viti shkollor 2017–2018.

258. Ligji nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" është rishikuar, duke përfshirë ndryshimet ligjore për mbështetjen e mësuesve dhe ofrimin e akomodimit të përshtatshëm. Përfshirja dhe cilësia e arsimit të personave me aftësi të kufizuara mbështetet nga planet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale. Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2016–2020) përcakton si objektiv përshtatjen graduale të infrastrukturës dhe mjediseve shkollore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe rritjen e numrit të mësuesve ndihmës për to në shkollat e zakonshme.

259. Me miratimin e ligjit për arsimin parauniversitar në vitin 2012 u krye një vlerësim shumëdisiplinor i nevojave arsimore të FAK-s nga mosha trevjeçare nga Komisioni Shumëdisiplinor, i ngritur në çdo njësi arsimore vendore. Komisionet përbëhen nga një pediatër, një psikolog, një punonjës social, një mësues i kualifikuar dhe një menaxher i shërbimit psikosocial. Në bashkëpunim me Save the Children, në vitin 2015–2016 u organizua një seancë trajnimi për Klasifikimin Ndërkombëtar për Funksionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin për Komisionet Shumëdisiplinore për FAK në të gjithë shkollat në nëntë bashki. Gjatë vitit akademik 2018/2019 do të hyjë në fuqi një rregullore për funksionimin e komisioneve shumëdisiplinore. Në gjashtë vitet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, komisionet kanë funksionuar bazuar në Dispozitën Normative të vitit 2013, që përcaktonte përbërjen, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

---

[59] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 71 d

260. Po i jepet përparësi regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë. Njësitë arsimore vendore udhëzohen çdo vit për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për arsim të cilësisë së lartë për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke filluar me informimin e prindërve dhe ndërgjegjësimin e komunitetit dhe prindërve rreth të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar në mjedise miqësore.

261. Në vitin 2014, u miratua udhëzimi nr. 38, 'Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar'. Për vitin shkollor 2017/2018, u emëruan më shumë se 610 mësues mbështetës, çka shënoi një rritje të numrit nga 65 që ishin në vitin shkollor 2014/2015. Për klasat e gjashta deri në të nënta ofrohen orë mësimore shtesë për fëmijët me vështirësi në të nxënë.

262. Trajnimet organizohen në mënyrë të vazhdueshme për profesionistët që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara në arsim. World Vision trajnoi 500 mësues (ndihmës dhe ato në klasat e zakonshme) bazuar në manualin e akreditуar "*Unë jam mes jush*". Mësuesit ndihmës janë trajnuar në bashkëpunim me Institutin e të Verbërve dhe në vitin 2018 me Fondacionin Down Syndrome Albania (rreth 200 mësues mbështetës). Të gjithë mësuesit që janë emëruar rishtas si mësues ndihmës janë trajnuar nga personeli i shërbimit psikosocial në shkolla, i cili ofron mbështetje të vazhdueshme dhe ngritje kapacitetesh për to. Në buxhetin afatmesëm 2018–2021, MASR-ja krijoi një fond të veçantë për trajnimin vjetor të rreth 200 mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

263. Janë ofruar trajnime të akredituara për 17 institucione të ndryshme, duke përfshirë edhe institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë hartuar 36 module për të gjithë mësuesit që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Në vitin 2016, me mbështetjen e UNICEF-it, u përgatit profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës, i cili u miratua me urdhrin nr. 195/2016. Moduli i trajnimit përcakton kriteret për profilin e mësuesit që punon me standarde gjithëpërfshirëse dhe është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve.

264. Fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve që vijnë nga familje me aftësi të kufizuara mbi moshën 6-vjeçare iu ofrohen libra shkollorë dhe transport falas, si dhe iu mbulohen të gjitha kostot të gjithë atyre fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin institucionet e arsimit special.

265. Në vitin 2014, u miratua edhe gjuha e shenjave dhe janë kryer studime për situatën e fëmijëve dhe të rriturve me dëmtime në dëgjim. Për më tepër, u nënshkrua edhe marrëveshja katërpalëshe (MASR, MSHMS, MFE dhe Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë), me nr. 4481/2018 "Për ndërveprimin dhe bashkëpunimin e palëve në fushën e arsimit dhe ofrimit të shërbimeve të interpretimit në gjuhën e shenjave për personat me dëmtime në dëgjim", e cila synon të ofrojë shërbime interpretimi në gjuhën e shenjave dhe të përmirësojë identifikimin e hershëm të fëmijëve me dëmtime në dëgjim. Gjithashtu, marrëveshja synon të përmirësojë identifikimin e hershëm të fëmijëve me dëmtime në dëgjim.

266. Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë në Tiranë regjistroi 91 studentë pa pagesë për vitin akademik 2017/2018, dhe iu fron atyre akomodim, vaktet e ushqimit dhe veshmbathje. Në shkollat e zakonshme janë regjistruar 88 nxënës me dëmtime në dëgjim. Megjithatë, në sistemin e arsimit parauniversitar nuk është vënë ende në zbatim arsimi në distancë. Numri i përgjithshëm i nxënësve në të gjitha shkollat speciale ishte 684 për vitin akademik 2017/2018, çka shënoi një rritje krahasuar me vitin paraardhës (659).

267. Janë përcaktuar kriteret për miratimin e projektit për ndërtimin ose rindërtimin e mjediseve të shkollave publike, si dhe për hapjen e institucioneve të reja sipas standardeve moderne të infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara. Në vitin 2017, janë hartuar edhe standardet e reja të shkollave, ku është përfshirë edhe detyrimi për të krijuar mjedise të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.

268. KMD-ja dha disa rekomandime lidhur me mosmarrjen e masave për përshtatjen e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre në shkollat e zakonshme, dhe për forcimin e detyrimit ligjor për t'i ndihmuar mësuesit në procesin e mësimdhënies[60].

[60] Referim pikave 64–67.

Braktisja para kohe e shkollës[61]

269. Norma mesatare e braktisjes së shkollës është 0.5 për qind për shkollat fillore, dhe katër për qind për shkollat e mesme. Të dhëna të tilla nuk ekzistojnë për qendrat e formimit profesional. Në arsimin e detyrueshëm, norma mesatare vjetore neto e regjistrimit dhe frekuentimit është më e lartë se 99 për qind, çka përbën një përmirësim krahasuar me vitin akademik 2012/13 (91.8%). Të dhënat janë të ndara sipas gjinisë dhe vendbanimit (urban ose rural).

270. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" parashikon mekanizmat për shmangien e rasteve të mosndjekjes së arsimit të detyrueshëm nga fëmijët për shkak të mosregjistrimit apo rasteve të braktisjes së shkollës për shkaqe financiare, ose të tjera. Ai përcakton detyrimin për organet e menaxhimit të shkollës që të adresojnë çështje të tilla, dhe detyrimin për strukturat e mbrojtjes së fëmijës që të ndërhyjnë për të siguruar regjistrimin e fëmijëve ose kthimin në shkollë të tyre pas braktisjes së saj. Për më tepër, ligji i garanton fëmijëve që e kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm mundësinë për të ndjekur studimet e mëtejshme, nëse kanë dëshirë, me mbështetjen e detyrueshme të prindërve.

271. Për zbatimin e ligjit, u hartua udhëzimi nr. 17/2018 pas konsultimeve me shoqërinë civile, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e grupeve të cenueshme. Udhëzimi lehtëson regjistrimin dhe procedurat e kthimit për ata fëmijë që, për shkak të arsyeve të ndryshme, nuk e kanë ndjekur arsimin bazë për të paktën dy vite shkollore, e kanë braktisur shkollën, ose janë identifikuar si të paregjistruar apo fëmijë në situatë rruge. Gjithashtu, udhëzimi ofron lehtësime për ndjekjen me kohë të pjesshme të arsimit bazë për të rriturit që nuk kanë arritur të ndjekin arsimin me kohë të plotë. Ai synon edhe një përllogaritje më të saktë të përqindjes së braktisjes së shkollës. Sipas tij, nxënësit që e kanë braktisur arsimin bazë më parë, nuk kanë përse të ndjekin Programin e Shansit të Dytë, por duhet të futen menjëherë në klasa të zakonshme dhe i nënshtrohen një kurrikule individuale për plotësimin e mangësive për shkak të braktisjes dhe mosregjistrimit në kohë. Është akreditуar metodologjia e trajnimit për parandalimin e braktisjes, e cila po zbatohet në katër qarqe të Shqipërisë.

272. Më parë janë marrë disa masa për përmirësimin e Programit "Shansi i Dytë", duke përfshirë vlerësimin e programit të mbështetur nga UNICEF-i në vitin 2012. Vlerësimi nxori disa rekomandime për përmirësim (p.sh., rihartimi i udhëzuesit të programit, ofrimi i librave falas, vakteve dhe shërbimeve ndihmëse, ofrimi i mbështetjes financiare dhe shpërblimeve për fëmijët e suksesshëm). Në vitin 2013, u hartua manuali për arsimin bazë me kohë të pjesshme. Ai përmban një pjesë që i kushtohet Programit "Shansi i Dytë". U rishikua udhëzimi nr. 29/2013, që adreson klasat e "Shansit të Dytë", duke ofruar një kurrikul dhe programe të reja bazuar në kompetenca dhe masat e mundshme zbutëse. Udhëzimi lejon edhe integrimin e drejtpërdrejtë të fëmijëve romë/egjiptianë në shkolla, pavarësisht nëse e kanë braktisur shkollën për një ose më shumë vite.

273. Si pjesë e zbatimit të Planit të Veprimit për Reduktimin e Braktisjes së Shkollës 2009–2013, u ndërmor nisma "Çdo fëmijë në shkollë". Nisma e përbashkët u ndërmor nga tri ministri dhe u pilotua në vitin 2015 në dhjetë shkolla në Bashkinë e Durrësit. U hartua edhe një udhërrëfyes për specialistët e shkollave për monitorimin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor dhe atyre të predispozuar për ta braktisur shkollën. Kjo ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit të institucioneve arsimore me NjVQV, NjMF-të, Policinë e Shtetit dhe OJF-të.

Cilësia e arsimit[62]

274. Raporti mësues-shkolla po përmirësohet. Në arsimin parashkollor, raporti për vitin 2015–2016 ishte 18,0 (18,7 në zonat rurale), ndërsa në vitin 2012–2013 ishte 18,6. Në shkollat fillore raporti u përmirësua nga 17,9 në vitin 2012–2013 në 16,0 gjatë periudhës 2012–2016 (14 në zonat rurale). Ka disa mundësi që mësuesit të ndjekin edukimin në vazhdim (Aneksi 2.7.1).

---

[61] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 71 a

[62] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 71 b

275. Çdo vit miratohen 2–2.5 miliardë lekë nga buxheti i shtetit ose MASR-ja për investime në rehabilitimin dhe ndërtimin e shkollave dhe mjediseve të reja. Këto shuma qëndrojnë në krye të fondeve të investuara nga investitorët e qeverisjes vendore.

J. Masat e veçanta të mbrojtjes

Fëmijët azilkërkues dhe refugjatë[63]

276. Në vitin 2013, u miratua ligji nr. 108/2013 "Për të huajt", i cili është shfuqizuar me ligjin nr. 74/2016, i ndryshuar me ligjin nr.74/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, "Për të huajt", i ndjekur nga VKM-ja 513/2013 për përcaktimin e kritereve për procedurat dhe dokumentacionin për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë. Në vitin 2014, u miratua dhe u ndryshua ligji nr. 121/2014 "Për azilin", i cili siguronte harmonizimin dhe përputhshmërinë me direktivat përkatëse të BE-së. Ligji parashikon disa masa mbrojtëse për fëmijët, duke përfshirë edhe kërkesat për caktimin e një kujdestari ligjor për fëmijën dhe dhënies përparësi të menaxhimit të aplikimeve të fëmijëve për azil dhe mosndarjes së fëmijës nga familja.

277. Të drejtat e fëmijëve azilkërkues, refugjatë apo pa shtetësi mbrohen nga ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Ligjet për shërbimet e kujdesit shoqëror (2016) dhe për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (2017) përfshijnë azilkërkuesit dhe refugjatët/personat që iu është dhënë mbrojtje shtesë.

278. Të gjithë emigrantët, pavarësisht statusit të tyre, gëzojnë të njëjtin akses me shtetasit e tjerë ndaj shërbimeve shëndetësore ose urgjencave mjekësore të financuara nga qeveria. Fëmijët azilkërkues kanë të drejtë të arsimohen dhe të mund të ndjekin një institucion arsimor që ndodhet në afërsi të qendrës (arsim parashkollor, fillor, dytësor, në varësi të interesave). Për t'u regjistruar në shkollë nuk nevojitet as statusi ligjor dhe as certifikatë lindjeje. Megjithatë, fëmija duket të jetë kartelën e vaksinimit nga qendra shëndetësore dhe të ketë një certifikatë nga shkolla për nivelin që ka përfunduar. Për t'i ardhur në ndihmë me riintegrimin, i ofrohen kurse të gjuhës shqipe.

279. Urdhri nr. 300/2015, "Për miratimin e statistikave kombëtare mbi migracionin dhe mbrojtjen ndërkombëtare " parashikon përmirësimin e unifikimit, mbledhjes dhe hartimit të strategjive kombëtare për imigrimin dhe mbrojtjen ndërkombëtare/azilin, si dhe përafrimin e tyre me kërkesat e Rregullores nr. 862/2007 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian për të siguruar raportimin në kohë. Regjistri Elektronik i të Dhënave për të Huajt përmban statistika për të huajt me vendbanim të rregullt, të kategorizuara sipas moshës, seksit dhe nënshtetësisë, si dhe statistika për të huajt e parregullt. Drejtoria e Azilit dhe Nënshtetësisë po krijon bazën e të dhënave për azilkërkuesit, e cila mundëson identifikimin e të dhënave të kategorizuara për fëmijët.

280. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 293/2015 "*Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë"*rregullon të gjitha standardet dhe proceset e identifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve, duke përfshirë edhe fëmijët e pashoqëruar në territorin e Shqipërisë, apo në pikat kufitare, si dhe përfshin kontrollin paraprak të emigrantëve të parregullt. Procedurat paraqiten më hollësisht në procedurat standarde të policisë kufitare dhe migrimit (urdhri nr. 146/2018, kategoritë e cenueshme si fëmijët e pashoqëruar apo familjet me fëmijë intervistohen në praninë e një punonjësi social apo psikologu, pasi kanë marrë ndihmë dhe janë akomoduar në mjediset e parashikuara. Procedura e përcaktimit të interesit më të lartë ndërmerret si pjesë e procesit të intervistimit.

281. Sektori i Azilit, pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, është autoriteti i vetëm që ofron mbrojtje ndërkombëtare. Kapaciteti pritës për azilkërkuesit u dyfishua në vitet 2017 dhe 2018 nëpërmjet zgjerimit të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit (QKPA), rinovimit të qendrës bashkiake për akomodim të përkohshëm në Gjirokastër, si dhe nëpërmjet disponueshmërisë së një godine që funksionon pranë fshatit "SOS" në Shkodër, për të huajt me qëndrim të parregullt, pjesë e të cilëve mund të jenë edhe azilkërkuesit.

---

[63] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 73

282. Fëmijët që kërkojnë azil akomodohen në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesit (QKPA), ku iu ofrohet menjëherë ndihmë psikosociale, ligjore dhe kujdes shëndetësor. Mbështetur në ligjin nr. 121/2014 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë", për azilkërkuesit e mitur të pashoqëruar përcaktohet një kujdestar, sipas rregullave dhe procedurës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Procedura e aplikimeve për azil realizohet nga Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë duke marrë parasysh nivelin e pjekurisë mendore dhe fizike të të miturit, dhe nëse është nevoja, në praninë e një psikologu. Krahas kësaj, njoftohet edhe NJMF-ja. Gjatë procesit dhe procedurave, interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata kryesore.

283. Fëmijët e pashoqëruar mbahen të ndarë veçmas nga azilkërkuesit e tjerë dhe monitorohen nga personeli (punonjësi social, psikologu). Mjediset e akomodimit janë të pajisura me të gjitha lehtësitë e nevojshme dhe mirëmbahen rregullisht. Në vitin 2017, me mbështetjen e CARITAS-it, është ngritur një mjedis argëtimi për fëmijët, ku ofrohen edhe mjedise të përshtatshme për të miturit, për të cilët kujdeset psikologu i qendrës pritëse.

284. Siç parashikohet në ligjin "Për të huajt", fëmijët e pashoqëruar, për të cilët është lëshuar një urdhër ndalimi, mbahen në qendrat sociale shtetërore, ose në një qendër tjetër, në kuadër të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare që punojnë me fëmijët, viktimat e trafikimit, apo me kategori të tjera të personave të cenueshëm. Fëmija mund të mbahet në një qendër të mbyllur vetëm në rast se është në interesin e tij/ të saj më të lartë ose duhet të qëndrojë në një mjedis të posaçëm, larg nga të rriturit. Qëndrimi i tij/ saj në një qendër të mbyllur do të konsiderohet zgjedhja e fundit, për një periudhë afatshkurtër dhe pas konsultimit me fëmijën, punonjësin social dhe/ose psikologun.

285. Sipas nenit 113 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", i ndryshuar, fëmija i pashoqëruar nuk mund të kthehet në vendin e origjinës, apo në një vend tjetër, nëse nuk sigurohet bashkimi familjar, apo kujdesi i duhur shëndetësor. Deri më tani, asnjë fëmijë i pashoqëruar nuk është kthyer në vendin e origjinës. Për më tepër, procesi i kthimit të fëmijëve të pashoqëruar parashikohet në ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" dhe kuadri procedural për kthimin e fëmijëve të pashoqëruar, ose fëmijëve të huaj është në proces hartimi me mbështetjen e ASHMDF-së.

286. Procedurat e azilit në Shqipëri zgjatin mesatarisht dy muaj, dhe në vitin 2016/2017, trembëdhjetë fëmijë të shoqëruar kanë përfituar nga statusi i mbrojtjes plotësuese i prindërve të tyre në fund të procesit.

287. UNHCR-ja po i ofron policisë kufitare dhe të migrimit ndihmë logjistike dhe teknike, duke përfshirë edhe trajnime për 150 efektivë të policisë kufitare gjatë vitit 2013/2014. Bashkëpunimi me agjencinë e refugjatëve arrin një nivel të kënaqshëm. Në kuadrin e ngritjes së kapaciteti institucional, UNHCR-ja po mbështet qendrën sociale për akomodimin e kategorive të cenueshme të migrantëve dhe refugjatëve. Edhe përfaqësuesit e organizatave të tjera ndërkombëtare si IOM, Kryqi i Kuq apo Caritas po ofrojnë mbështetje për kategoritë e cenueshme si fëmijët e pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë nga familja.

Fëmijët në situatë migrimi[64]

288. Kuadri ligjor shqiptar në fushën e migrimit ka pësuar disa ndryshime, duke përfshirë amendamentet e ligjit për të huajt dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së, me qëllim hartimin e një politike migratore më të fortë dhe më koherente, që respekton të drejtat e fëmijës. Zbatimi i disa akteve normative lidhur me procedurat për dokumente udhëtimi, viza, punësim, vendbanim, bashkim familjar etj., është përmirësuar.

289. Gjatë vitit 2018 është hartuar projekt Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit 2019–2022 është hartuar nga Grupi i Punës, nëpërmjet një procesi konsultimi ndërinstitucional. Strategjia dhe Plani i Veprimit është miratuar me VKM nr. 400, datë 19.6.2019. Kjo Strategji do të forcojë më tej legjislacionin dhe strukturat e menaxhimit të migracionit, do të përmirësojë mbledhjen e të dhënave për migracionin dhe do të adresojë emigracionin nga vendi.

---

[64] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 75

290. Kthimi dhe riintegrimi i qëndrueshëm i shqiptarëve të kthyer dhe familjarëve të tyre, pavarësisht formës së kthimit, u adresua nëpërmjet zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010–2015. Plani i veprimit ka forcuar kuadrin aktual legjislativ dhe institucional, si dhe kapacitetet e strukturave përkatëse në mbështetjen e riintegrimit. Shërbimet që iu ofrohen shtetasve të kthyer dhe familjarëve të tyre përfshijnë transportin nga pikat e kalimit kufitar te qendra më e afërt urbane (ndërsa grupet e cenueshme transportohen në qendrën rezidenciale më të afërt), ofrimin e informacionit, ujit dhe mjekimeve etj. Numri i shtetasve shqiptarë që aplikojnë për azil në shtetet anëtare të BE-së po bie ndjeshëm.

291. Urdhri i përbashkët nr. 332/3/2014 i drejtorit të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Social Shtetëror, "Për marrjen e masave për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen/ripranohen nga vendet e tjera", drejton procesin e trajtimit të fëmijëve të pashoqëruar që kthehen në Shqipëri. Mbështetur mbi këtë urdhër dhe një kërkesë nga ministria përkatëse, SHSSH-ja kryen një vlerësim të këtyre fëmijëve dhe familjes së tyre jashtë vendit, duke përfshirë rreziqet me të cilat përballen. Synimi është ndërgjegjësimi i familjeve për rrezikun e migracionit të parregullt dhe parashikohet një plan riintegrimi, si dhe një program për mbrojtjen sociale, që nevojitet për fuqizimin e familjes së fëmijës së kthyer.

292. Gjatë periudhës 2013 – shtator 2018, në Shërbimin Social Shtetëror janë bërë 1,131 kërkesa për vlerësim social, 845 prej të cilave janë shqyrtuar. Gjatë periudhës 2015 – 2016, u rrit numri i kërkesave për kthimin e të miturve të pashoqëruar ose të ndarë nga vendet e BE-së. Me qëllim adresimin e këtyre problemeve kritike dhe me dëshirën e mirë për ta minimizuar këtë dukuri të pazakontë të të miturve të pashoqëruar ose të ndarë, janë organizuar disa takime me përfaqësues të agjencive të migracionit nga vende, si: Gjermania, Franca, Suedia, Belgjika, Greqia etj. Bashkëpunimi në këtë fushë përqendrohet në përftimin e informacionit nga vendet pritëse dhe ofrimin e kthimit/ripranimit të sigurt të të miturve të pashoqëruar ose të ndarë te familjet e tyre ose dorëzimin e tyre te subjektet shtetërore, që parashikohen me ligj për pritjen e tyre. Bashkëpunimi i strukturave të policisë kufitare dhe asaj të migracionit me shërbimin social shtetëror ka qenë i vazhdueshëm (aneksi 2.8. 2).

293. Legjislacioni shqiptar për migracionin i jep përparësi kthimit vullnetar të personave të disa kategorive si të miturit e pashoqëruar, personat e sëmurë, ata me aftësi të kufizuara dhe prindërit me fëmijë të vegjël.

294. Ligji nr. 108/2013 "Për të huajt", i ndryshuar, garanton dhe përcakton të drejtën e të huajve dhe familjarëve të tyre që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë për të krijuar familje ose kujdesur për jetën familjare.. Pjesëtarët e huaj të familjeve shqiptare përfitojnë një leje qëndrimi, që rishikohet çdo dy vjet dhe iu jepet edhe të miturve të pamartuar, kujdestari ligjor i të cilit është një i huaj. Gjatë periudhës 2012–2017, 9,617 individë morën leje qëndrimi për arsye të bashkimit familjar.

295. Në vitin 2014, Avokati i Popullit përgatiti raportin "*Për emigrimin dhe çështjet e shumta lidhur me të*", që synonte të tërhiqte vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë dhe institucioneve shtetërore për këtë çështje. Raporti përqendrohej, ndër të tjera, te dokumentet e identifikimit të nënshtetasve shqiptarë të lindur jashtë vendit dhe në integrimin e fëmijëve të familjeve të kthyera në Shqipëri në sistemin arsimor. Raporti duhet të shqyrtohet nga Kuvendi.

296. Në nëntor të vitit 2017, UNCHR-ja, në bashkëpunim me CARITAS Shqipëri, organizoi dy workshop-e "Për forcimin e bashkërendimit institucional për identifikimin dhe referimin e rasteve imigratore" në bashkitë e Gjirokastrës dhe Sarandës dhe me policinë kufitare, përgjegjëse për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar në kufi.

Shfrytëzimi ekonomik, duke përfshirë punën e detyruar të fëmijëve[65]

297. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përforcoi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Zgjerimi i nenit 124 të Kodit Penal ka sjellë edhe ofrimin e mbrojtjes nga dhe ndjekjes penale të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve.

---

[65] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 79

298. Adresimi i punës së fëmijëve përfshihet edhe në objektivin e AKDF-së 2017–2020, e cila parashikon disa masa për këtë fushë, duke përfshirë: vlerësimin e situatës së punës së fëmijëve në Shqipëri, udhëzime për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve për vlerësimin e punës së fëmijëve, shtimin e termave të referencës dhe fushëveprimin, si dhe numrin e punonjësve të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHS). Në bazë të riplanifikimit strukturor të ri të institucionit qeveritar në vitin 2017, ISHPSHS-ja është pjesë e Inspektoratit Qendror në varësi të MFE-së.

299. Në përputhje me ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" u hartua VKM-ja "Për procedurat e identifikimit, ndihmës së menjëhershme dhe referimit të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, duke përfshirë fëmijët në situatë rruge" me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. VKM-ja në fjalë përcakton institucionet përgjegjëse dhe detyrimet e tyre lidhur me identifikimin dhe referimin e fëmijëve ekonomikisht të shfrytëzuar. Hartimi i Planit Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik 2018–2020, që do të mbulojë edhe fëmijët në situatë rruge, është në vazhdimësi.

300. Pas konsultimeve të gjera me grupet e interesit, duke përfshirë edhe organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve, të mbështetura nga ILO, ligji nr. 7961/1995 "Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë" u ndryshua në vitin 2015 për të rritur moshën minimale të punës në 16 vjeç, duke e përafruar me ligjin "Për arsimin parauniversitar" dhe direktivën e BE-së 94/33/KE "Për mbrojtjen e të rinjve në punë". Ligji i ndryshuar qartëson rregullat e kështillimit dhe formimit profesional të fëmijëve, klasifikimet e punëve të vështira dhe të rrezikshme dhe përcaktimin e kontrolleve mjekësore.

301. Plani Kombëtar i Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, duke përfshirë edhe fëmijët në situatë rruge (2019–2021) është hartuar me mbështetjen e OSBE-së konsultuar me palët përkatëse të interesit gjatë muajve të ardhshëm të vitit 2018. Për nga pikëpamja strategjike, PKV-ja synon: a) parandalimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve; b) mbrojtjen dhe ndërhyrjen/shërbimet mbështetur në nevojat e identifikuara të fëmijëve; c) kapërcimin e pengesave sociale dhe kulturore, që nxisin shfrytëzimin ekonomik; d) ndjekjen e çështjeve penale, që lidhen me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.

302. VKM-ja nr. 108/2017 "Për mbrojtjen e fëmijëve në punë" përcakton parimet dhe kërkesat e hollësishme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të fëmijëve nën moshën 18 vjeç nga shfrytëzimi ekonomik dhe çdolloj pune që mund të dëmtojë sigurinë, shëndetin, ose zhvillimin e tyre fizik, mendor, moral apo social, ose të pengojë arsimin ose pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë kulturore, tregtare dhe të ngjashme. VKM-ja e detyron punëdhënësin të vlerësojë rrezikun specifik ndaj agjentëve, proceseve apo kushteve të punës, në varësi të natyrës, shkallës dhe kohëzgjatjes së ekspozimit në vendin e punës, ku fëmijët ushtrojnë veprimtari pune. Kjo Rregullore është e zbatueshme plotësisht për çdo fëmijë nën moshën 18-vjeçare që ka kontratë pune apo që ka hyrë në marrëdhënie të një natyre të ngjashme.

303. Bazuar në nenet 98–103 të Kodit të Punës dhe VKM nr. 108/2017 "Për miratimin e Rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë" përcaktohen mosha dhe kriteret e punësimit. Për të miturit nga mosha 14–16 vjeç është e detyrueshme marrja e autorizimit për punësimin e të miturve nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Për sa i përket kësaj, fëmijët midis moshës 16 dhe 18 vjeç mund të punojnë, por kufizohen nga puna gjatë natës ose puna që konsiderohet e dëmshme për shëndetin apo rritjen e tyre, dhe në çfarëdolloj rasti angazhimi i tyre duhet të autorizohet nga Inspektorati Qendror. Sipas të dhënave të tyre, fëmijët kryesisht punësohen në ndërmarrjet e prodhimit (76%) dhe bizneset turistike (21%).

304. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale ka ndërmarrë masat ligjore në rastet kur janë shkelur dispozitat ligjore që rregullojnë punësimin e fëmijëve. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore me qëllim kontrollin e punësimit të të miturve nga mosha 16–18 vjeç, të cilët sipas kuadrit ligjor mund të punësohen në punë të lehta edhe 6 orë në ditë, por nuk pajisen me autorizim nga ky institucion ka propozuar ndryshimin e VKM nr.108/2017 "Për miratimin e Rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë. Gjatë periudhës së

raportimit, është pezulluar puna e gjashtë bizneseve për shkak të punësimit të dymbëdhjetë fëmijëve të pasiguruar dhe të padeklaruar. I është dhënë përparësi kontrollit të bizneseve që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e tregtisë, hotelerisë dhe shërbimeve bar-restorant, turizmit, bujqësisë dhe peshkimit. Fokusi i punës së inspektimeve është punësimi sezonal i punëtorëve, puna e fëmijëve, puna me turn të dytë dhe të tretë, kushtet shëndetësore dhe të sigurisë në punë.

Fëmijët në situatë rruge[66]

305. Për identifikimin pro aktiv dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge, ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton hartimin dhe përpilimin e një harte identifikuese të zonave në rrezik, ku përfshihen fëmijët në situatë rruge. Në vitin 2014, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Identifikimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Situatë Rruge. Pas sondazhit kombëtar për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri, u hartua dhe u zbatua Plani Kombëtar i Veprimit për Identifikimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Situatë Rruge 2015–2017. ASHMDF-ja monitoroi zbatimin e PKV-së, koordinoi ndërhyrjet ndërsektoriale, si dhe mbështeti palët vendore të interesit në koordinim dhe zbatim[67].

306. Mekanizmi i koordinimit dhe ndërhyrjes për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge u pilotua fillimisht në Tiranë, në vitin 2015. Duke u mbështetur në këto përvoja, u finalizua *"Udhëzuesi i procedurave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge"*, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror. Rrjedhimisht, PKV-ja u shtri në tetë bashki të tjera, si dhe bashkitë e Beratit, Sarandës, Tropojës dhe Bulqizës kanë hartuar plane sociale vendore, që përqendrohen te fëmijët në situatë rruge. Në vitin 2018, u hartua VKM-ja "Për procedurat e identifikimit, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë edhe fëmijët në situatë rruge".

307. Në bashkëpunim me OSBE-në, Save the Children dhe ARSIS, ASHMDF-ja zhvilloi trajnime për udhëzimet e sipërpërmendura, në katër bashki në vitin 2016 (duke arritur një total prej 179 punonjësish) dhe dy bashki në vitin 2017, si dhe u organizuan trajnime të tjera për ekipet shumëdisiplinore në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve[68].

308. Pranë çdo bashkie janë ngritur ekipe terreni, që janë përgjegjëse për procesin e identifikimit të fëmijëve në situatë rruge, dhënien e ndihmës së parë dhe referimin e menjëhershëm në strukturat përgjegjëse për menaxhimin e rastit. Këto ekipe do të ngrihen edhe pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror. Në të gjitha bashkitë e përfshira janë ngritur 29 ekipe aktive në terren. Shërbimet e ofruara për familjet, ndër të tjera përfshijnë këshillim, regjistrimin e fëmijëve në shkollë, kopsht dhe çerdhe, aplikime për ndihmë financiare, gjetjen e punës, kujdes shëndetësor, referimin e fëmijëve në qendra ditore dhe sistemimin e tyre në institucionet e kujdesit shoqëror në përputhje me interesin më të lartë të tyre.

309. Janë zhvilluar disa fushata dhe trajnime për të adresuar të drejtat dhe gjendjen e fëmijëve në situatë rruge, duke përfshirë fushatën e organizuar nga ASHMDF-ja "Asnjë fëmijë në rrugë për punë dhe lypje" në qytetin e Tiranës, që synon t'i ndërgjegjësojë qytetarët për shfrytëzimin e punës së fëmijëve në situatë rruge, duke shpërndarë fletushka informuese për raportimin, shërbimet e disponueshme, përgjegjësinë prindërore etj.[69]

310. Në vitin 2016 dhe 2017, janë identifikuar 963 fëmijë në situatë rruge, të cilët janë raportuar tek ASHMDF-ja. Gjatë këtyre dy viteve, në zbatim të urdhrit të përbashkët nr. 2 midis Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ASHMDF-së, një numër i konsiderueshëm fëmijësh (një total prej 549 fëmijësh) në situatë rruge ose viktima të mundshme trafikimi u regjistruan në shkollë.

---

[66] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 81

[67] Referim edhe pikës 302 të Raportit.

[68] Aneksi 2.1.5 bashkëlidhur Raportit.

[69] Aneksi 2.1.5 bashkëlidhur Raportit.

311. Ligji nr. 18/2017 i kategorizon fëmijët në situatë rruge si një kategori fëmijësh në nevojë për mbrojtje të veçantë (dhe nuk konsiderohen si kundërvajtës). Megjithatë, në rastet kur fëmijët përdoren nga familja e tyre për të lypur në rrugë, janë familjet ato që trajtohen si kundërvajtës në përputhje me Kodin Penal, që e parashikon shfrytëzimin e punës për lypje si krim.

312. Organet e policisë së shtetit kanë ndërmarrë disa masa kundër shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, duke përfshirë lypjen nga fëmijët, si pjesë e përpjekjeve për të mbrojtur fëmijët në situatë rruge. Numri i rasteve të fëmijëve që shfrytëzoheshin për të lypur, të cilët i janë referuar zyrës së prokurorit është rritur nga katër në vitin 2012 në 15 në vitin 2017.

Shitja, trafikimi dhe rrëmbimi[70]

313. Kuadri ligjor dhe institucional në fushën e trafikimit është përmirësuar, dhe përfshin ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (ligji nr. 35/2017) dhe ofron pozicion dhe akses më të mirë në procesin penal për viktimën. Neni 20 i ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" parashikon një kërkesë për të gjitha institucionet përgjegjëse për trajtimin e fëmijëve të trafikuar, që të marrin të gjitha masat dhe veprimet specifike për t'i ndihmuar dhe për t'i mbështetur derisa të rikuperohen plotësisht, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme. Miratimi i ligjit të ri "Për Policinë e Shtetit" ofron mjete shtesë për mbrojtjen dhe mbështetjen e gjithanshme të viktimave të trafikimit, dhe veçanërisht të fëmijëve. Kodi i ri i Drejtësisë Penale forcon mbrojtjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale.

314. Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Trafikimit të Personave u përgatit në mbështetje të PKV-ve të mëparshme, që mbulonin periudhat 2011–2013 dhe 2014–2017. Strategjia organizohet në katër shtylla kryesore (hetimi dhe ndjekja penale, mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimës, parandalimi dhe koordinimi). Për herë të parë, PKV-ja ka përllogaritur edhe buxhetin për veprimtaritë e saj. Takimi i parë u zhvillua në mars 2016 për të monitoruar strategjinë dhe hartuar PKV-të e mëvonshme. Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2018 -2020", është miratuar me vendimin nr. 770, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave. Mbrojtja e fëmijëve është forcuar më tej nga AKMF 2017–2020, që përfshin masa për identifikimin proaktiv të viktimave të mundshme në Shqipëri, si dhe viktimat e trafikimit jashtë vendit dhe për kthimin e tyre të vullnetshëm në Shqipëri.

315. Hartimi i Strategjisë Ndërsektoriale për "Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013–2020" dhe Plani i Veprimit 2013–2016 ka shtuar përpjekjet në luftën kundër trafikimit të personave. Një prej masave të Strategjisë është forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërinstitucional me të gjitha palët e interesit, në veçanti me Prokurorinë e Krimeve të Rënda që trajton raste të trafikimit të fëmijëve.

316. Në qershor të vitit 2012, u nënshkrua një marrëveshje e re për Mekanizmin Kombëtar të Referimit (MKR), duke angazhuar 13 institucione shtetërore dhe joshtetërore. Marrëveshja përcakton kuadrin e bashkëpunimit, duke caktuar përgjegjësitë e aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për sa i përket identifikimit, referimit, strehimit, ndihmës dhe rehabilitimit. Për më tepër, është nënshkruar edhe udhëzimi i përbashkët nr. 3799/2014 midis ministrive përkatëse të linjës për themelimin dhe funksionimin e strukturës që drejton zbatimin e MKR-së.

317.. Në vitin 2018, u miratuan procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit (miratuar me VKM nr. 449, datë 29.8.2018), duke forcuar sistemin aktual gjithëpërfshirës dhe të mirëkoordinuar të identifikimit, referimit dhe mbrojtjes (duke zëvendësuar PSV-në e vitit 2011). Procedura mbulon fëmijët, qofshin shqiptarë, të huaj ose pa shtetësi, nga të gjitha llojet e shfrytëzimit vendas ose ndërkombëtar. PSV-të, krahas kapaciteteve të fuqizuara të autoriteteve përkatëse dhe palëve të interesit (duke përfshirë OJF-të), kontribuuan në përmirësimin e identifikimit të viktimave, forcimin e bashkëpunimit midis strukturave përkatëse dhe në ofrimin e përgjigjeve në kohë dhe të përshtatshme ndaj krimeve të tilla. Për PSV-në e vitit 2011 janë zhvilluar veprimtari ndërgjegjësuese.

---

[70] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 83

318. Që prej vitit 2017, janë krijuar dymbëdhjetë Komitete Rajonale Antitrafik (KRAT), të përbërë nga zyrtarë vendorë dhe OJF që punojnë për parandalimin dhe ofrimin e ndihmës për viktimat. Komitetet Rajonale Antitrafik janë krijuar në zbatim të urdhrit nr. 6, datë 26.1.2017 të Kryeministrit. Urdhri parashikon detyrimin për pjesëmarrjen e agjencive qeveritare, përkatësisht ato të shërbimeve sociale, ligjzbatuese, inspektorëve të punës dhe përfaqësuesve të shëndetësisë. Veprimtaria e komiteteve lidhet me organizimin e takimeve të rregullta, periodike dhe orientuese me prefektët e qarqeve dhe anëtarët e KRAT-ve dhe Tryezave Teknike Antitrafik, me qëllim, garantimin e përmbushjes së rolit dhe funksioneve të tyre, si struktura kryesore lokale për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit, identifikimin e problemeve parësore në nivel rajonal, si dhe vlerësimin e gjendjes dhe përcaktimin e nevojave specifike të qarkut. Janë riaktivizuar tri njësi identifikimi të lëvizshme në tri qarqe.

319. Qeveria mbështet Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit Shtetërore për Gratë dhe Fëmijët Viktima të Trafikimit dhe tri qendra jopublike për trajtimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Një nga këto strehëza të drejtuara nga OJF-të ofron shërbime të specializuara për viktimat nën moshën 18-vjeçare. Katër strehëzat përbëjnë Koalicionin Kombëtar për Strehëzat Antitrafik, që ofron shërbime plotësuese për viktimat e trafikimit. Personat pranë qendrave/strehave përfitojnë paketën e ndihmës, që përfshin ushqim, këshillim, ndihmë ligjore, kujdes mjekësor, shërbime arsimore, libra shkollorë për fëmijët viktima, shërbime punësimi, ndihmë për fëmijët e viktimave, mbështetje financiare, strehim afatgjatë, veprimtari sociale, formim profesional dhe akses falas në kujdesin shëndetësor. Gjatë periudhës 2012–2018, në Qendrën Kombëtare janë akomoduar 198 viktima/viktima të mundshme të trafikimit, ndërsa në tri qendrat e tjera 398 persona.

320. Viktimat e huaj kanë akses në të njëjtat shërbime si viktimat vendase, por për viktimat e huaja ligji parashikon një periudhë reflektimi tremujore me status të përkohshëm vendqëndrimi dhe leje pune deri në dy vjet.

321. Në kuadër të Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Planeve të Veprimit, janë ndërmarrë një sërë masash të rëndësishme drejt parandalimit dhe goditjes së trafikimitkonkretisht: krijimi i një strukture ndërsektoriale për bashkërendimin e përpjekjeve antitrafik, e cila përbëhet nga Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Personave; Koordinatori Kombëtar/Zëvendësministri i Brendshëm, Njësia Antitrafik, Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave (MKR), Komitetet Rajonale Antitrafik (KRAT; krijimi i një kuadri të plotë rregullator për luftën kundër trafikimit, i cili përmirësohet vazhdimisht, për të qenë në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare/evropiane dhe për të përballuar sfidat e reja të trafikimit; forcimi i kapaciteteve në bashkëpunim me autoritetet ligjzbatuese dhe gjyqësore. Në këtë kuadër janë marrë masa nga shkollat, drejtoritë dhe stafi akademik i shkollave, si dhe njësitë e shërbimit psikosocial, duke përfshirë ndërgjegjësimin e fëmijëve ndaj trafikimit, në module të posaçme të integruara në kurrikulën me zgjedhje dhe veprimtari të tjera, si edhe veprimtari informuese e edukuese dhe fushata në shkolla. Në këtë fushë janë organizuar një sërë trajnimesh dhe veprimtarish ndërgjegjësuese. Në bashkëpunim me shoqërinë civile, janë trajnuar disa punonjës policie, punonjës vendorë ligjzbatues, punonjës të policisë kufitare, gjykatës dhe prokurorë për mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit[71].

322. Çdo qytetar që dëshiron të raportojë çdo rast apo shqetësim lidhur me trafikimin e personave mund të telefonojë falas në numrin e telefonit 116 006 ose të denoncojë përmes aplikacionit "Raporto! Shpëto!", që mund të shkarkohet nga Google Play.

323.Duke u mbështetur në të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjatë periudhës 2013–2017 janë identifikuar 529 raste të viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Nga të gjithë këta, 253 (49%) ishin fëmijë, dhe shumica prej tyre ishin vajza. Numri i dënimeve penale për veprat penale lidhur me trafikimin e fëmijëve janë

[71] Aneksi 2.5.1 bashkëlidhur Raportit.

shtuar nga tre në vitin 2012, në 20 në vitin 2017, dhe gjatë periudhës 2012–2017 janë regjistruar gjithsej 80 vepra penale të trafikimit të fëmijëve ndaj 91 kundërvajtësve. Gratë dhe vajzat trafikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë shfrytëzimin seksual dhe lypjen, teksa është vërejtur edhe dukuria e familjeve shqiptare që udhëtojnë drejt vendeve evropiane dhe braktisin fëmijët e tyre.

324. Megjithatë, pavarësisht angazhimit ndërsektorial dhe ndërinstitucional lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe organizimin e veprimtarive ndërgjegjësuese, identifikimi i hershëm, ndjekja dhe kompensimi i viktimave të trafikimit mbetet ende sfidë.

Administrimi i Drejtësisë për të Mitur[72]

325. Garantimi i procedurave ligjore cilësore, të efektshme dhe të shpejta është qëllimi më i rëndësishëm i reformës së sistemit të drejtësisë penale. Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" (KDPM) dhe ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", si dhe një sërë dispozitash ligjore procedurale për çështjet penale, synojnë përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në tërësi dhe pozicionin e të miturve në cilësinë e autorit, dëshmitarit ose viktimës së veprës penale në veçanti.

326. Ligji KDPM, që hyri në fuqi në janar 2018, përfaqëson një zhvillim ligjor të pashembullt dhe kalim filozofik në qasjen drejt trajtimit të fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale. Kodi parashikon në hollësi të drejtat dhe garancitë procedurale të të miturve në konflikt me ligjin, dhe i përafron me standardet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur. Drejtësia restauruese përfshihet në dispozitat ligjore që drejtojnë çdo hap procedural në drejtësinë për të mitur. Gjatë fazës së provës, Kodi zgjeroi kompetencën e seksioneve institucionale për të miturit dhe të rinjtë deri në moshën 23 vjeçare. Kodi parashikon se dënimi me burgim është masa e fundit që mund të merret kundrejt të miturve që kanë kryer një vepër penale.

327. Në kuadrin ligjor, këto zhvillime kërkojnë përpjekje dhe investime të konsiderueshme për garantimin e zbatimit në një mënyrë ndërsektoriale dhe të koordinuar. Aktualisht, të gjitha institucionet përgjegjëse po ndërmarrin masa ligjore, institucionale dhe infrastrukturore për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Kodi. Janë hartuar një sërë projekt aktesh nënligjore dhe disa urdhra për zbatimin e Kodit dhe do të jenë në fazë miratimi në pjesën e parë të vitit 2018[73].

328. Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018–2021, miratuar në shtator 2018, dhe shoqëruar me Planin e Veprimit, është dokumenti i parë i politikave që i përgjigjet kuadrit ligjor dhe situatës aktuale të fushës. Strategjia ka pesë objektiva dhe ofron një qasje ndërdisiplinore që do të integrohet në të gjithë dokumentet e tjera ekzistuese kombëtare, të shoqëruar me veprimtari konkrete. Secili objektiv strategjik ka synime dhe tregues, që mundësojnë matjen e ecurisë në zbatimin e PKV-së.

329. Aktualisht, shtatë gjykata të rrethit gjyqësor (nga 29 gjykata të rrethit gjyqësor dhe të shkallës së parë) kanë një seksion penal, që trajton kriminalitetin e të miturve. Kodi thekson se çështjet e drejtësisë për të mitur do të trajtohen vetëm nga personat e specializuar dhe të trajnuar në këto çështje[74].

330. Në bashkëpunim dhe me asistencën e Programit "ICITAP" *(International Criminal Investigative Training Assistance Program),* është shënuar progres përsa i përket zhvillimit të implementimit të "Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes", në të cilin hidhet dhe regjistrohet çdo informacion për ngjarjet kriminale dhe ngjarjet aksidentale, të cilat evidentohen nga strukturat vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit. Si rezultat i këtij bashkëpunimi (në muajin dhjetor 2018) është bërë e mundur dhe ka përfunduar trajnimi i të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, si dhe shtrirja dhe zbatimi i këtij sistemi në të gjitha strukturat vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit.

---

[72] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 85

[73] Aneksi 2.8.6 bashkëlidhur Raportit.

[74] Aneksi 2.8.8 bashkëlidhur Raportit.

331. Në vitin 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit vuri në përdorim aplikacionin e sistemit elekronik "Komunikimi Ditor", në të cilën administrohen të gjitha ngjarjet kriminale dhe aksidentale të evidentuara nga strukturat policore, si dhe mundëson statistika gjithpërfshirëse dhe të standardizuara lidhur me kriminalitetin. Të dhënat për të miturit janë të ndara sipas veprave penale dhe grup-moshës (nën 14 vjeç dhe 14 – 18 vjeç)..

332. Megjithatë, për adresimin e sfidave të mbetura (mungesa e një sistemi të kompjuterizuar, mbledhja manuale e të dhënave, përpunimi dhe raportimi, mungesa e një metodologjie të unifikuar për kundërvajtësit e mitur) në mbledhjen e të dhënave për rastet penale, që përfshijnë fëmijët në konflikt me ligjin, ose një fëmijë që është viktimë apo dëshmitar i një vepre penale, Kodi prezanton krijimin e një Sistemi të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. Prototipi i sistemit, i cili do të publikojë informacione të hollësishme për statusin e një çështjeje penale, që përfshin të miturit dhe përcakton të dhënat që duhen hedhur nga të gjitha institucionet përkatëse, është përgatitur me mbështetjen e UNICEF, dhe zbatimi i saj do të nisë në fillim të vitit 2019. (Për thuajse një vit) është ngritur një njësi ose sektor i veçantë, që mbulon çështjet e drejtësisë për të mitur në Ministrinë e Drejtësisë, që ndër të tjera është përgjegjës për rishikimin dhe garantimin e koherencës së të dhënave statistikore për drejtësinë për të mitur dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare të raportimit.

333. Statistikat e disponueshme për kriminalitetin e të miturve gjatë periudhës së raportimit 2012–2017 tregojnë një luhatje të dukurisë, me rënie të përgjithshme që prej vitit 2014. Vjedhja e pronës dhe shkeljet gjatë drejtimit të makinës përbëjnë pjesën më të madhe të veprave penale të kryera nga shkelësit e mitur. Nuk janë mbledhur të dhëna për fëmijët si dëshmitarë të veprave penale, dhe fëmijët kanë nivele të ulëta të kryerjes së veprave penale (0.83%).

Ofrimi i ndihmës juridike dhe ndihmave të tjera[75]

334. Ligji nr. 37/2017 "Kodi Penal i Drejtësisë për të Mitur" parashikon se fëmija në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, ose fëmija në çdo fazë të procedimeve administrative dhe civile, gëzon të drejtën për ndihmë ligjore dhe psikologjike falas, të ofruar nga shteti. Krahas kësaj, Kodi parashikon se Dhoma Kombëtare e Avokatisë do të vërë në dispozicion një listë me avokatët, që specializohen dhe trajnohen në drejtësinë për të mitur për institucionet e ndihmës juridike falas.

335. Pika e mëparshme përsëritet në ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", që hyri në fuqi në qershor 2018 dhe që reformon procedurat dhe mekanizmat e ofrimit të ndihmës së garantuar nga shteti. Ligji njeh dy lloj ndihmash ligjore, atë parësore dhe dytësore, si dhe mundësinë e përjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Kategoritë e reja të përfituesve të ndihmës ligjore përfshijnë fëmijët viktima dhe fëmijët në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimeve penale, fëmijët që jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror, fëmijët nën kujdestari që dëshirojnë të nisin procedime pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër tyre etj. Parashikohet një sistem regjistrimi për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave të kategorizuara sipas moshës, dhe menaxhimin e aplikantëve, përfituesve dhe ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat e aksesit të fëmijëve ndaj ndihmës juridike falas aktualisht nuk administrohen.

336.Në praktikë, të gjithë personat, veçanërisht fëmijët, që mbahen në paraburgim ose në arrest në strukturat policore, informohen menjëherë dhe hollësisht për të drejtat e tyre, iu caktohet menjëherë një avokat dhe i ofrohet ndihmë mjekësore. Gjykimi i tyre realizohet brenda një date të arsyeshme, siç parashikohet në Kushtetutë. Ndihma ligjore iu ofrohet edhe viktimave të veprave penale, si rrjedhojë e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, që hynë në fuqi në gusht të vitit 2017. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë nuk administron të dhënat e kategorizuara sipas moshës për ofrimin e ndihmës juridike falas.

337. Nëpërmjet protokollit nr. 432/1/2016, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi midis Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) për ofrimin e ndihmës psikologjike dhe ligjore falas për të miturit nga

[75] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 85 d

specialistët e QSHPLI-së gjatë fazës hetimore paraprake. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, u mbajtën katër seanca trajnimi njëditore me në qendër teknikat e intervistimit dhe trajtimin e përshtatshëm të të miturve në mjediset policore, kur janë të dyshuar, dëshmitarë ose viktima të një vepre penale.

338. Fëmijëve viktima të veprave penale iu ofrohet mbështetje psikologjike në çdo fazë të hetimeve paraprake nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit.

Aksesi në arsim dhe shërbime shëndetësore[76]

339. Në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, midis MASR-së dhe MD-së është miratuar Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 526/2018 "Për arsimimin e individëve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri" dhe urdhri i përbashkët nr. 3348/1/2018 "Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur". Këto urdhra parashikojnë rregullat dhe procedurat organizative për arsimin e detyrueshëm, atë të mesëm dhe të lartë për të kundërvajtësit e mitur.

340. Për arsimimin e individëve në moshë shkollore në institucionet e paraburgimit, është miratuar një kurrikul, siç specifikohet në udhëzimin nr. 42/2014 "Për arsimimin e individëve në moshë shkollore që vuajnë dënimin në institucionet e paraburgimit", që përcakton strukturën e vitit shkollor dhe mënyrën e realizimit të procesit mësimor në institucionet e paraburgimit. Gjithashtu, sipas planit, parashikohen 10 orë për module jashtëkurrikulare dhe module me zgjedhje. Fëmijët pajisen falas me tekstet shkollore. Për vitin shkollor 2017–2018, iu ofrua arsim bazë tetë fëmijëve në mjediset e paraburgimit dhe katër fëmijëve të dënuar.

341. Në shtator të vitit 2016, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kreu një studim për vlerësimin e nevojave të të burgosurve, për të përmirësuar aksesin në arsim dhe formim profesional. Në studim morën pjesë shtatëdhjetë të burgosur, ndër të cilët 20 ishin fëmijë dhe 10 gra.

Kushtet e paraburgimit dhe burgimit[77]

342. Koncepti i qendrave të paraburgimit, që funksionojnë si struktura rehabilitimi, ka qenë objekt përmirësimi të vazhdueshëm lidhur me procedura dhe mekanizma të ndryshme, siç janë mekanizmat e kërkesave dhe ankesave, mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialitetit, si dhe përmirësimi i kushteve të përgjithshme të institucioneve penitenciare. Janë ndërtuar dhe rikonstrukuar dhoma sigurie në Drejtorinë Vendore të Policisë në Tiranë dhe në shtatë komisariate për të plotësuar kushtet e sigurimit të trajtimit njerëzor të individëve të ndaluar ose të arrestuar. Fëmijëve të arrestuar ose të ndaluar iu sigurohet akomodim në dhoma të ndara veçmas nga të rriturit. Ndërkohë, është shkurtuar kohëzgjatja e paraburgimit dhe ka rënë numri i fëmijëve në paraburgim (84 në vitin 2012; 44 në vitin 2017).

343. Janë marrë një sërë masash për të përmirësuar kushtet e të miturve në sistemin penitenciar (vuajtjes së dënimit), duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të integruara në bashkëpunim me institucione të tjera qeveritare. Ndër të tjera, këtu përfshihet zgjerimi i fushëveprimit dhe larmisë së veprimtarive arsimore, përmirësimi dhe zgjerimi i programeve të rehabilitimit dhe riintegrimit, duke përfshirë formimin profesional për rritjen e mundësive të punësimit pas lirimit, kurset për kontrollimin/reduktimin e sjelljes agresive dhe menaxhimin e stresit, si dhe aftësimin dhe përvetësimin e njohurive prosociale. Programi i individualizuar i trajtimit planifikohet sipas vlerësimit të nevojave psikosociale të të burgosurit. Çdo javë organizohen veprimtari për të miturit, të cilët marrin pjesë në veprimtari sportive, arsimore, formimi profesional, veprimtari argëtuese, shërbime bibliotekare, këshillim social dhe psikologjik dhe trajnime të tjera.

344. Janë përmirësuar mjediset e sistemit penitenciar, duke përfshirë edhe ato të fëmijëve, teksa kostoja e rinovimit ka arritur 35.000 euro. Mjediset janë në përputhje me Standardet Evropiane për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin.

---

[76] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 85 g

[77] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 85 g

345. Situata e numrit të lartë të të burgosurve në sistemin e burgut është përmirësuar ndjeshëm, duke arritur shifrën më të ulët në pesë vitet e fundit prej gjashtë për qind (prill 2018). Numri mesatar i të burgosurve ishte 5,460, prej të cilëve 27 ishin të mitur dhe 99 gra. Gjatë periudhës 2012 – 2017, 88 fëmijë janë dënuar me burg, përkatësisht trembëdhjetë fëmijë në vitin 2012 dhe dhjetë në vitin 2018.

346. Gjatë periudhës 2012–2017, 277 fëmijë iu kthyen rrugës së krimit. Megjithatë, pas një periudhe rritjeje, në vitin 2017 u vërejt një rënie e recidivizmit. Në bashkëpunim me organizatën Meridia Albania, nga viti 2015 deri tani, 77 të mitur janë liruar me sukses nëpërmjet formimit profesional dhe programeve të punësimit. Asnjë nga këta të mitur nuk i është kthyer ciklit të krimeve.

347. Në nëntor 2014, u rinovua një Memorandum Mirëkuptimi (MM) ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe ish-Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, duke forcuar angazhimin e të dyja institucioneve në programet e riintegrimit, veçanërisht për kategoritë e cenueshme, duke përfshirë të miturit dhe gratë. Në vitin 2015, u krye një studim për recidivizmin dhe u miratua dokumenti "Për Mekanizmin e Sistemit të Referimit për Riintegrimin e Fëmijëve".

Masat alternative ndaj burgosjes[78]

348. Ndërmarrja e masave alternative ndaj arrestimit është rritur ndjeshëm, nga 109 raste në vitin 2010, 455 në vitin 2012 dhe 390 në 2016. Në vitin 2017, u vendosën dënime alternative për 53% të të pandehurve të mitur, kryesisht pezullimi i vendimit për burg ose provë, ndërsa në vitin 2016, është vendosur një dënim alternativ për 48 për qind të autorët e mitur të veprave penale. Kohëzgjatja e dënimit me burg (dhe kërkesat e prokurorëve për dënim me burg) është ulur, teksa situata në vitin 2016 dhe në vitin 2017 paraqiti një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me periudhën e mëparshme. Përshpejtimi i ecurisë në këtë fushë synohet të arrihet nga disa masa të parashikuara në Strategjinë e re të Drejtësisë për të Mitur. Midis vitit 2012 dhe muajit mars të vitit 2018, Shërbimi i Provës ka mbikëqyrur gjithsej 2.835 të mitur.

349. Shërbimi i Provës ka nisur bashkëpunimin me disa institucione për mbështetjen e fëmijëve në provë, duke përfshirë Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Shërbimin e Toksikologjisë në Qendrën Universitare "Nënë Tereza", ndër të tjera. Me ndihmën e zyrave rajonale të punësimit, fëmijët referohen për formim profesional. Aktualisht, marrëveshjet e bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë nën shqyrtim dhe modalitetet e vendosjes së marrëdhënieve të reja të bashkëpunimit me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve janë nën negocim.

350. Ministri i Drejtësisë, së bashku me kryetarët e bashkive të ndryshme si Korça, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për sigurimin e kuadrit infrastrukturor dhe institucional për zbatimin e masave alternative për shmangien e ndjekjes penale dhe të ndëshkimit të të miturve në konflikt me ligjin. Qendra Shumëdisiplinore, punonjësit e Shërbimit të Provës dhe stafi i NJMF-së, në bashkëpunim me shërbimet sociale dhe me mbështetjen e organizatave që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këto qytete, pritet të ofrojnë mbështetje për zbatimin e masave alternative për shmangien..

351. Në vitin 2015, Shërbimi i Provës me ndihmën e OSBE-së krijoi Sistemin e Vlerësimit të Rrezikut për të Miturit dhe Adoleshentët, si edhe një udhëzues për përdorimin e tij. Instrumenti në fjalë përdoret për të ndihmuar me hartimin e raportit të vlerësimit për Gjykatën ose Prokurorinë, si edhe për procesin e mbikëqyrjes së kësaj grup-moshe. Aktualisht, në kuadër të zbatimit të Programit shqiptaro-suedez për Drejtësinë për të Mitur dhe hyrjes në fuqi të Kodit për Drejtësinë Penale për të Mitur, u zhvillua një workshop dyditor, për të finalizuar Modelin e Raportit të Vlerësimit Individual për të Miturit në konflikt me ligjin.

352. Me mbështetjen e projektit dyvjeçar të binjakëzimit të BE-së "Mbështetje për Shërbimin e Provës dhe Alternativat ndaj Burgimit"në vitet 2011–2013, filloi hartimi dhe zbatimi i Sistemit

[78] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 85 f

të Vlerësimit të Rrezikut për mbikëqyrje dhe u prezantuan programe për ekipe vëzhguesish dhe vëzhgues individualë (të mitur dhe të rritur) për përpunimin e veprave penale të kryera, si edhe abuzimet me substancat. Stafi i provës ka përfituar trajnime.

353. Në vitin 2013, është vënë në funksion një Sistem Elektronik Vëzhgimi. Në përputhje me Kodin për Drejtësinë Penale për të Mitur, edhe një fëmijë që qëndron në shtëpi mund të jetë objekt i vëzhgimit elektronik.

354. Që prej vitit 2014, Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me OSBE-në, ka realizuar trajnime të punonjësve për standardet ndërkombëtare lidhur me fëmijët në shërbim prove, kuadrin e drejtësisë për të mitur, teknikat e intervistimit të të miturve, këshillimin ligjor për fëmijët dhe të afërmit e tyre, si ndërmjetësim në konfliktin midis viktimës dhe autorit.

355. Në vitin 2015, duke marrë parasysh specifikat e trajtimit të të miturve dhe një numër relativisht të lartë të miturish me masa alternative, veçanërisht në zyrat vendore në Tiranë, Shkodër dhe Fier, tre punonjës janë caktuar në zyrën vendore të Tiranës me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm dhe 21 punonjës në 21 Zyra vendore të tjera të Shërbimit të Provës si specialistë të miturish në lidhje me intervistimin dhe vlerësimin e të miturve, si dhe me respektimin e të drejtave të tyre. Krahas kësaj, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës janë caktuar dy oficerë përgjegjës për të miturit (një inspektor dhe një specialist).

Trajnim dhe orientim për stafin ligjzbatues[79]

356. Në vitin 2013, u hartua Manuali për Oficerët e Policisë për Detajimin e të Drejtave të të Pandehurve, Viktimave dhe Dëshmitarëve të Mitur gjatë Fazës së Hetimit dhe Teknikat Miqësore të Intervistimit të të Pandehurve, Viktimave dhe Dëshmitarëve të Mitur. Pas konsultimeve, manuali u përkthye në PSV për trajtimin e fëmijëve gjatë hetimeve paraprake (miratuar në vitin 2013; urdhri i DPPSH-së nr. 300). 500 kopje të këtij dokumenti u botuan dhe iu shpërndanë efektivëve të policisë.

357. Rregullorja e Përgjithshme për Burgjet, e miratuar me VKM-në nr. 437/2015 ka një kre që trajton masat për mbrojtjen dhe trajtimin e të miturve, të cilëve iu është mohuar liria e tyre. Këto masa mbështeten mbi respektimin e të drejtave themelore dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Personeli i policisë dhe ai civil trajnohen rregullisht për procedurat e kriminalitetit të të miturit, sipas moduleve specifike për të miturit, të hartuara nga Sektori i Trajnimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme së Burgjeve. Aktualisht, kjo rregullore është objekt ndryshimi si rrjedhojë e miratimit të Kodit të ri të Drejtësisë për të Mitur.

358. Në vitin 2016, është miratuar urdhri nr. 306 i DPPSH-së për PSV-të "Për rregullat teknike të shoqërimit policor", që përcakton rregullat e shoqërimit dhe trajtimit të fëmijëve.

359. Gjatë periudhës së raportimit, janë organizuar një sërë trajnimesh të ofruara nga institucione të ndryshme për personelin ligjzbatues lidhur me trajtimin e fëmijëve mbështetur në KDF. Gjatë periudhës 2012–2018, 585 efektivë policie kanë ndjekur trajnimet për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës dhe trajtimin e individëve të ndaluar/arrestuar.

360. Krahas kësaj, Shkolla e Magjistraturës, një institucion publik i specializuar në rekrutimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, zhvilloi disa seanca trajnimi për të drejtat e fëmijëve. Pritet të mbështetë një sërë trajnimesh që parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit për gjyqtarët dhe prokurorët e specializuar.

361. Në janar të vitit 2018, nisi zbatimi i projektit: "Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese dhe gjykatave shqiptare për përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut në drejtësinë për të mitur", me fokus në një qasje të gjithanshme kundrejt zinxhirit të drejtësisë, me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA).

K. Ratifikimi i dokumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

362. Në vitin 2013, Republika e Shqipërisë ratifikoi Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës me anë të një procedure komunikimi, dhe në vitin 2012 ratifikoi Konventën për

[79] Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CRC/C/ALB/2–4 – Rekomandimi 85 c

të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Protokollin e saj Opsional, dhe Konventën e KE-së për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

L. Bashkëpunimi me organet rajonale dhe ndërkombëtare (VP 87)

363. Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve përfaqëson Shqipërinë në Komisionin Monitorues të Konventës së Këshillit të Evropës KiE "Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual" (Konventa e Lanzarotës). KiE-ja ka mbështetur zhvillimin e dokumentit të politikave "E ardhmja e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri".

Raporti mbi zbatimin e Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur

A. Hyrje

1. Ky raport paraqitet sipas pikës 2 të nenit 8 të Protokollit Opsional për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura. Ky RAPORTIM përfshin të njëjtë periudhë kohore janar 2013– prill 2019.

2. Sipas udhëzimeve dhe vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës[80], raporti paraqitet si pjesë e Raportit për zbatimin e KDF-së nga Republika e Shqipërisë dhe duhet të lexohet bashkë me informacionet e parashtruara në raport.

B. Masat e përgjithshme për zbatim

Legjislacioni[81]

3. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", neni 28 parashikon mbrojtjen e fëmijëve nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe situata të emergjencave civile, duke përfshirë ndalimin e përfshirjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të fëmijës në një konflikt të armatosur.

Plani Kombëtar i Veprimit[82]

4. Është hartuar "Plani i Veprimit Ndërinstitucional për Pritjen dhe Trajtimin e Shtetasve Shqiptarë që janë kthyer nga Konflikti në Siri dhe Irak". Plani parashikon: ngritjen e një grupi ndërinstitucional pune, me përfaqësues nga të gjitha institucionet shtetërore që janë përgjegjëse për procedurat e pritjes, trajtimit dhe riintegrimit të qytetarëve të kthyer; 2) ngritjen e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e mbërritjes të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit; 3) bashkërendimin midis institucioneve përgjegjëse në çdo fazë dhe raportimin lidhur me masat dhe nevojat. Plani parashtron detyra konkrete për të gjitha institucionet e përfshira në veprimet e mësipërme.

5. Në Axhendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës nuk parashikohen masa konkrete për përfshirjen e fëmijëve në Konflikte të Armatosura.

Bashkërendimi[83]

6. Bashkërendimi i Protokollit Opsional është përgjegjësi e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Akademisë së Forcave të Armatosura, që është edhe organ në varësi të saj.

7. Siç përmendet edhe më lart, Plani i Veprimit Ndërinstitucional parashikon ngritjen e një grupi ndërinstitucional pune, ku marrin pjesë të gjithë institucionet shtetërore që janë përgjegjëse për procedurat e pritjes, trajtimit dhe riintegrimit të qytetarëve të kthyer.

Shpërndarja dhe trajnimi

8. Sipas Marrëveshjes së Standardizimit të NATO-s, përditësuar në mars 2013, KDF-ja dhe Protokollet Opsionale, si dhe standarde të tjera për të drejtat e njeriut përfshihen në përgatitjen e

---

[80] Vëzhgimet Përfundimtare (VP) të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPAC/ALB/1, 6 dhjetor 2012.

[81] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPAC/ALB/1, pika 7

[82] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPAC/ALB/1, pika 9

[83] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPAC/ALB/1, pika 10

stërvitjes së ushtarëve, në Shkollën e Trupave, dhe për forca të tjera të armatosura, si dhe në stërvitjen e Nënoficerëve në Akademinë e tyre, stërvitjen e oficerëve në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe strukturave të tjera të forcave të armatosura. Vëmendje e veçantë i kushtohet përgatitjes së Oficerëve, që janë pjesë e stafit të lartë të forcave të armatosura, që merren me përgatitjen e ushtarëve dhe Nënoficerëve.

9. Janë marrë masa lidhur me njohjen dhe përfshirje e Protokollit Opsional në kurrikulat e shkollave ushtarake dhe në trajnimin e përgatitjen e trupave, veçanërisht, të kontingjenteve të forcave të armatosura që marrin pjesë në operacionet e OKB-së, BE-së dhe NATO-s, në mbështetje të paqes dhe sigurisë në botë. Në këtë drejtim, Akademia e Forcave të Armatosura ofron një sërë modulesh që përqendron në ligjin për konfliktet e armatosura dhe që përfshijnë tema të lidhura me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në operacionet ushtarake dhe, në veçanti, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në konflikte të armatosura. Këto module përfshihen në kurset e trajnimit të oficerëve të rinj (75 orë mësimore), kursin bazë të oficerëve të personelit ushtarak, kursin e komandës dhe personelit ushtarak (1 modul me 125 orë mësimore) dhe kursin për oficerët e lartë (100 orë mësimore).

Parandalimi

Arsimi për paqen[84]

10. Në arsimin parauniversitar ofrohet edukimi qytetar (Klasat 1–10), ku integrohen të drejtat e njeriut, respekti për të tjerët, larmia, dhe zgjidhja paqësore e konflikteve. Reforma në sistemin e formimit, dhe në veçanti, kualifikimet e mësuesve, po zbatohen me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të mësuesve për sa iu përket çështjeve të tjera të ndjeshme, si: larmia etnike, parandalimi dhe adresimi i dhunës.

11. Si pjesë e Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në vitin 2014 midis MASR-së dhe Korpusit të Paqes së SHBA-së në Shqipëri, Ministria dhe njësitë rajonale arsimore japin direktiva të gjitha institucioneve arsimore ku punojnë vullnetarët e Korpusit të Paqes, për t'i përfshirë në veprimtari dhe projekte të ndryshme që janë me interes për shkollën dhe komunitetin, dhe për të mbështetur mësuesit të marrin pjesë në trajnime të sponsorizuara dhe të zhvilluara nga Korpusi i Paqes.

V. Ndalimi dhe çështjet përkatëse

Ndalimi i rekrutimit nga grupe të armatosura joshtetërore

12. Nuk është prezantuar asnjë legjislacion për të ndaluar në mënyrë specifike rekrutimin dhe përdorimin e vullnetshëm dhe të detyruar në konflikte të personave nën moshën 18 vjeç nga grupe të armatosura joshtetërore.

E. Mbrojtja, rikuperimi dhe riintegrimi

Masat e miratuara për të mbrojtur të drejtat e viktimave fëmijë[85]

13. Sipas të dhënave të disponueshme nga Policia e Shtetit (Drejtoria Antiterror)dhe nga shërbimet shqiptare dhe të huaja të inteligjencës, nuk është regjistruar asnjë rast i rekrutimit të fëmijëve shqiptarë në luftë në një vend të huaj ose në konflikt të armatosur jashtë vendit. Gjatë periudhës së raportimit (2012–2018) nga Shqipëria ishin larguar gjithsej 38 fëmijë bashkë me prindërit e tyre drejt zonave të prekura nga konflikti (shumica me nënat e tyre për bashkim familjar), por jo për t'u përdorur në konflikt, ose kanë lindur atje. Aktualisht, në zonat e konfliktit ndodhen 30 fëmijë shqiptarë, duke qenë se në vitin 2014, tetë fëmijë u kthyen bashkë me prindërit e tyre, dhe jetët e tyre janë stabilizuar dhe normalizuar.

14. Plani Ndërinstitucional i Veprimit udhëzon qartësisht MASR-në në bashkëpunim me MSHMS-në dhe NJQV-të, për të zhvilluar programe konkrete për riintegrimin e fëmijëve pas kthimit nga zonat e konfliktit. Këto programe duhet të përfshijnë riintegrimin social dhe arsimor që identifikojnë nevojat psikosociale të fëmijës, mbështetjen më të nevojshme parashkollore dhe

---

[84] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPAC/ALB/1, pika 14

[85] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPAC/ALB/1, pika 20

shkollore, zhvillimin e planeve individuale shkollore për fëmijën, duke angazhuar mësues ndihmës dhe ofruar tekste shkollore falas. MSHMS-ja duhet të angazhohet më tej në pritjen dhe ofrimin e ndihmës për fëmijët, kontrollet mjekësore, ofrimin e vlerësimeve psikosociale duke përgatitur plane individuale dhe ndërmarrë monitorim të vazhdueshëm

Ndihma dhe bashkëpunimi ndërkombëtare

Bashkëpunimi ndërkombëtar[86]

15. Në vitin 2014, Shqipëria pati rolin kryesor në Bashkëpunimin Civilo-Ushtarak (CIMIC) në SHAPE, Bruksel, dhe organizoi një konferencë për fëmijët dhe konfliktet e armatosura. Përfundimet e konferencës, si dhe referencat e fëmijëve të përfshirë në konfliktet e armatosura, si Rezoluta nr. 1612 "Fëmijët dhe konfliktet e armatosura", ligji ndërkombëtar për konfliktet e armatosura, dhe ligji ndërkombëtar humanitar, ndër të tjera, kanë qenë pjesë e kurseve institucionale të mbajtura në Akademinë e Forcave të Armatosura. Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit zhvillon koncepte të reja në këtë fushë, duke përfshirë trajtimin e fëmijëve të personelit në situatat posttraumatike, që janë kthyer nga misionet paqeruajtëse.

16. Raporti mbi zbatimin e Protokollit Opsional për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë

A. Hyrje

1. Ky raport paraqitet sipas pikës 1 të nenit 12 të Protokollit Opsional të Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës lidhur me shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë. Ky Raportim mbulon periudhën kohore janar 2013 – prill 2019.

2. Sipas udhëzimeve dhe vëzhgimeve përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës[87], raporti paraqitet si pjesë e Raportit për zbatimin e KDF-së nga Republika e Shqipërisë dhe duhet të lexohet bashkë me informacionet e parashtruara në raport.

3. Për pasojë, ky raport, veçanërisht seksionet që ofrojnë informacion për progresin e shënuar në fushën e dhunës ndaj fëmijëve dhe për shitjen, trafikimin dhe rrëmbimin e fëmijëve, duhet të lexohet së bashku me Raportin e përgjithshëm të Shtetit Palë mbi KDF-në.

B. Mbledhja e të dhënave[88]

4. Shitja e fëmijëve nuk parashikohet si vepër e veçantë në Kodin Penal, dhe rrjedhimisht nuk ka të dhëna statistikore konkrete për këtë problematikë. Gjatë periudhës 2012 - shtator 2018, janë regjistruar 35 vepra penale të prostitucionit me fëmijë dhe tri raste të pornografisë me fëmijë.

C. Masat e përgjithshme të zbatimit

Legjislacioni[89]

5. Miratimi i ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2013, dhe të Kodit të Procedurës Penale (ligji nr. 35/2017) ofruan mundësinë për përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me PO. Përkufizimi i pornografisë është rishikuar, por nuk është bërë asnjë ndryshim në përkufizimin e prostitucionit.

Plani Kombëtar i Veprimit[90]

6. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2018–2020 përmban një sërë masash për forcimin e hetimeve dhe ndjekjes penale, mbrojtjes dhe ofrimit të ndihmës për viktimat, parandalimin nëpërmjet ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimit të bashkërendimit në këtë fushë.

7. Me qëllim forcimin e përgjigjes ndaj fëmijëve, Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, në Shtyllën Strategjike 2, parashikon: Eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, për një sërë masash gjithëpërfshirëse në fushën e mbrojtjes së fëmijës, që mbulon të gjithë fëmijët në nevojë.

---

[86] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPAC/ALB/1, pika 21

[87] Vëzhgimet Përfundimtare (VP) të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPSP/ALB/1, 6 dhjetor 2012.

[88] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPSP/ALB/1, pika 7

[89] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPSP/ALB/1 pika 9

[90] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPSP/ALB/1 pika 11

8. Plani i Veprimit 2018–2020 "Për internet më të sigurt për fëmijët" paraqet nisma dhe veprimtari të bashkërenduara ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi në internet.

Koordinimi dhe vlerësimi

9. Është forcuar bashkërendimi në fushën e trafikimit, nëpërmjet forcimit të burimeve për Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik (ZKKAT). ZKKAT-ja publikon rregullisht raporte për veprimtarinë e saj në faqen e saj të internetit dhe organizon mbledhje me palë interesi të përfshira në MKR. Në vitin 2014, Komiteti Shtetëror Antitrafik, që është përgjegjës për përcaktimin e prioriteteve strategjike që formësojnë përgjigjen kombëtare ndaj trafikut, ka shtuar numrin e anëtarëve të tij.

Shpërndarja, ndërgjegjësimi dhe trajnimi[91]

10. KDF-ja dhe PO-të e saj përfshihen në kurrikulat shkollore të të gjitha niveleve arsimore me fokus edukimin qytetar. Kjo përfshirje ndërthuret me veprimtari shkollore për ndërgjegjësimin ndaj trafikimit, shfrytëzimit dhe abuzimit të fëmijëve, përdorimit të mjeteve dhe kanaleve të ndryshme (fushata mobilizimi, aplikacione raportimi etj.)

Shpërndarja e burimeve[92]

11. Si Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, ashtu edhe Strategjia për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2018–2020 kanë buxhetin përkatës për zbatimin e tyre. Alokimi i burimeve për ZKKKTP-në po rritet ndjeshëm (Aneksi 2.1.2).

D. Parandalimi i shitjes së fëmijëve, prostitucionit të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë

Masat e mara për parandalimin e veprave të ndaluara në kuadër të Protokollit Opsional[CO20]

12. Janë marrë disa masa për forcimin e sistemit social dhe të mbrojtjes së fëmijës, që kontribuojnë në parandalimin e shkeljeve të ndaluara nga PO-ja.

Turizmi i seksit me fëmijët[93]

13. Me qëllim adresimin e trafikimit të fëmijëve brenda territorit të vendit, është nënshkruar në vitin 2007 një Memorandum Mirëkuptimi (MM) midis Ministrisë së Punëve të Brendshme; Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit;[94] dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm. Një nga detyrimet e parashikuara në MM ishte prezantimi i Kodit Botëror të Etikës, si dhe Kodi i Sjelljes, në rregulloret e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Rinisë dhe Sportit, si një nga kërkesat për lëshimin dhe tërheqjen e operatorëve turistikë në Shqipëri, si dhe në rregullat e tyre për kualifikimin dhe standardet e shërbimeve që ofrojnë.

14. Në kuadër të zbatimit të fazës së dytë të projektit rajonal "Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimit të organizuar", Koordinatori Kombëtar dhe Drejtoria Antitrafik kanë organizuar seminare për t'i ndihmuar qendrat turistike bregdetare të pushimit që të parandalojnë dhe të luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore. Në to morën pjesë shtatëdhjetekatër përfaqësues të shoqatave dhe shërbimeve të hoteleri-turizmit dhe të inspektoratit të punës dhe zyrave vendore të tij

Pornografia me fëmijë[95]

15. Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, që u themelua në vitin 2017, është autoriteti qendror për sigurinë në internet, me objektiv mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit në fushat e nënshkrimit elektronik, identifikimit elektronik të shërbimeve të

---

[91] VP të Komitetit mbi zbatimin e Protokollit CRC/C/OPSP/ALB/1 pika 14–16

Raste të mbylluara për arsye të mbylljeve						

Fëmija është mbi 18 vjeç				49	39	44
Zvogëlimi i nivelit të rrezikut, mungesa e rrezikut / rrezik i ulët				137	287	284
Fëmija jashtë rrezikut deri në 18 vjeç				33	29	24
Fëmija vdes				0	0	1
Fëmija transferohet në një vendbanim tjetër				61	87	145
Numri total i rasteve të mbyllura				285	442	498
Numri i fëmijëve që ndjekin rastet, sipas problemeve						
Dhunë në familje				155	150	286
Trafikim				15	17	15
Shfrytëzimi i fëmijëve				285	318	387
Probleme financiare				645	588	672
Paaftësi				29	30	29
Të paregjistruar				35	53	51
Braktisja e shkollës				72	96	80
Tjetër				60	100	130
Numri i rasteve të fëmijëve të ndjekur sipas llojit të abuzimit						
Abuzim fizik				71	104	189
Abuzim seksual				26	27	39
Abuzimi psikologjik				106	186	290
Neglizhim				352	619	683
Rastet e fëmijëve të referuara nga NJMF në struktura të tjera				272	192	

Burimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Tabela 39: Rastet e dhunës në familje të regjistruara në Sistemin Kombëtar për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Të gjitha rastet që prej lancimit të sistemit	2016	2017
2649	861	758

Burimi: Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Tabela 40: Numri i fëmijëve të akomoduar në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje

	2012	2013	2014	2015	2016	2017 – Mars 2018
Totali	38	41	55	47	59	54
Vajza	15	19	26	23	22	32
Djem	23	22	29	24	37	22
Fëmijë të pashoqëruar	4	4	3	3	6	6
Fëmijë të pashoqëruar – të kthyer tek familjet biologjike	4	1	3	3	5	6
Fëmijë të pashoqëruar të referuar në institucione të tjera	0	4	0	0	1	0

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual

Tabela 41: Të dhëna mbi krimet seksuale kundrejt fëmijëve të raportuara nga Policia e Shtetit

VEPRA PENALE	2012		2013		2014		2015		2016		2017	
	Të cënuar											
	Deri në moshën 18 viecare	Femra	Deri në moshën 18 viecare	Femra	Deri në moshën 18 viecare	Femra	Deri në moshën 18	Femra	Deri në moshën 18	Femra	Deri në moshën 18 viecare	Femra
Neni 100 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur	10	7	15	12	10	8	22	19	15	12	18	16
Neni 101 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur	5	4	12	10	19	14	18	14	6	6	6	4
Neni 103 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur	1	3	0	2	0	1	2	1	1	1	1	1
Neni 105 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 106 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari	0	0	1	4	4	4	3	2	4	4	1	1
Neni 107 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 107/a Dhuna seksuale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	5	3	20	20	8	5	32	22	19	15	25	18
Neni 108/a Ngacmimi seksual	0	0	0	0	8	5	6	4	20	15	15	15
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	0	0	0	0	3	3	9	9	10	10	8	8
Neni 117 Pornografia	0	0	0	0	0	0	1	1	2	1	0	0

Burimi: Ministria e Brendshme

Shtojca 2.4.2: Ndëshkimi fizik

Tabela 42: Raste të dhunës të trajtuara nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes në shkollë

Viti	Raste në total	Dhunë fizike	Dhunë emocionale	Dhunë seksuale	Shpërfillje
2015/2016	2824	771	1680	6	637
2017/2018*	2342	548	1433	3	358

Burimi: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
** Në 2017/2018, nga 2342 raste, 530 kishin të bëjnë me dhunën e nxënësve-mësues dhe 1812 raste që kishin të bënin me dhunën studentore-studentore.*

Shtojca 2.4.3: Praktikat e dëmshme
Martesat nën moshë

Rekomandimet e dala nga dy raportet e përgatitura nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinisë (Observatori) dhe Shkolla e Magjistraturës (SoM) për monitorimin e vendimeve gjyqësore për periudhën 2011–2017 në 9 gjykata të shkallës së parë (Korçë, Pogradec, Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë) me objekt lejimin e martesës nën moshë përfshijnë:

- Për gjykatën, mbajtja në vëmendje e interesit të të miturit, duhet të jetë konsiderata kryesore dhe ky kujdes i veçantë nevojitet të pasqyrohet në mënyrë sa më të qartë përmes analizës konkrete sipas rastit, në përmbajtjen e vendimit.
- Vetëm i miturit që kërkon të lidhë martesë nën moshë është ai që legjitimohet aktivisht në bërjen e kërkesës.
- Prindi, sipas KF, ka të drejtën e kundërshtimit të martesës. Në këto kushte nuk mund të jetë ai që vepron në emër të të miturit dhe nuk mund të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësisë prindërore.
- Legjislacioni shqiptar nuk e njeh pranimin ose pëlqimin e prindërve si detyrim për lidhjen e martesës nën moshë. Duke qenë se prindërit kanë të drejtën e kundërshtimit të martesës, vlerësimi i mendimit të tyre nga ana e gjykatës duhet bërë kundrejt interesit të të miturit dhe për të parë sa ndikim kanë prindërit në cenimin e vullnetit të lirë.
- Bashkëshorti i ardhshëm nuk mund të legjitimohet aktivisht, në lejimin e lidhjes së martesës në moshë. Ky është subjekt që nevojitet domosdoshmërish të thërritet në proces me cilësinë e personit të tretë.
- Parim shumë i rëndësishëm që duhet të mbahet nën kontroll nga ana e gjykatës është autonomia e vullnetit të të miturit/ës që kërkon leje për lidhjen e martesës nën moshë. Për të vlerësuar këtë vullnet, i miturit duhet të jetë prezent personalisht gjatë gjithë procesit. Gjykata duhet të garantojë të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe informuar, gjykata të mbajë në vëmendje se sa më e vogël mosha aq më lehtë manipulimi i të miturit në lidhjen e martesës pa pëlqimin e lirë.
- Gjykata që investohet për lejimin e martesës nën moshë, e jep vendimin pas një analize tërësore të shkaqeve me rëndësi të pretenduara; arsimi jashtë shtetit mund të sigurohet edhe pa lidhur detyrimisht martesën me një person që jeton jashtë shtetit; raste të tilla duhet të monitorohen me kujdes sepse mund të jenë burim shfrytëzimi, trafikimi, punë e detyruar etj
- Nëse gjykata e çmon, i miturit mund të pyetet veçmas. Gjykata është e inkurajuar të marrë mendimin e të miturit në kushte ku nuk ka asnjë ndikim ndaj tij/saj. Pra i miturit nevojitet të merret në pyetje jo në prani të prindërve, kujdestarit ose bashkëshortit të ardhshëm dhe të të rriturve të tjerë; një listë pyetjesh e gatshme mund të lehtësojë gjykatën në komunikimin me të miturin për të kuptuar lirinë e vullnetit dhe aspekte të tjera.
- Gjykata nevojitet të verifikojë dhe pasqyrojë në vendim pjekurinë fiziko-psikike të personit nën moshën 18 vjeç që bën kërkesë për lidhje martese nën moshë. Për këtë ajo mund të përpilojë një listë me pyetje edhe të thjeshta për të parë reagimin e të miturit. Pjekuria psikike përfshin qartësinë e kërkuesit/es lidhur me rëndësinë e martesës në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve. Pjekuria psikike duhet konstatuar prej veprimeve të subjekteve dhe jo thjesht prej deklarimeve të tyre. Gjykata në këtë vendimmarrje duhet të mbrojë të miturit dhe martesën. Duke qenë se nga martesa lindin të drejta, detyrime e përgjegjësi, gjykata duhet të vlerësojë se sa në harmoni është personi me pjekurinë e vet kundrejt këtyre të drejtave dhe detyrimeve që imponon martesa dhe të informojë të miturin.

- Gjykata nevojitet të verifikojë rëndësinë e motivit/shkakut të pretenduar dhe që shoqëron kërkesën për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë. Motivi duhet trajtuar në raport me atë se çfarë i shtyn subjektet të kërkojnë lejen e gjykatës për lidhjen e martesës përpara kohe dhe jo sipas rregullave të martesës. Duhet të ketë arsye të mira për të lidhur këtë martesë. A po lidhet martesa nga turpi? Presioni? Nevoja ekonomike? Detyrimi? Etj.

- Gjykata nevojitet të verifikojë bazueshmërinë e motivit. Është ky një motiv fiktiv apo real? Kjo realizohet përmes pyetjeve. Nëse është real sa i bazuar është për të bërë një kërkesë në shkelje të rregullit të përgjithshëm të moshës? Arsyet duhet të jepen qartë. Ato duhet të jenë konkrete e reale. Pas shkaqeve që justifikohen si të rëndësishme mund të qëndrojnë të tjera që mund të sjellin rrezik për të miturin/ën.

- Marrja e mendimit të psikologut lidhur me anën psikologjike, pëlqimin e lirë dhe situatën sociale është një detyrim ligjor dhe ndihmesë e madhe për gjykatën që të japë një vendim të drejtë dhe të gjykojë mbi rëndësinë e shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre si dhe pjekurinë fiziko-psikike duke e bërë këtë verifikim edhe përmes psikologut. Gjykata edhe në gjykime të tilla duhet të respektojë parimin e nenit 6 të Kodit të Familjes dhe të KDF sipas të cilit: "Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën sociale". Një rol të veçantë ndihmës për gjykatën në vendimmarrje të tilla mund të luajnë Njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel vendor, si edhe punonjësit socialë.

- Reduktimi drejt eliminimit të martesave nën 16 vjeç duhet të jetë në vëmendje të gjykatës dhe të bëhet praktikë e saj. Pra, në asnjë rast, të mos lejohet lidhja e martesës nën këtë moshë pavarësisht justifikimeve.

- Gjykata nevojitet të mbajë në vëmendje se të miturat me gjendje të vështirë ekonomike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të martesave fiktive apo premtimeve për martesë që përfundojnë në shfrytëzim për prostitucion, trafikim ose çdo lloj forme tjetër shfrytëzimi.

- Në këndvështrimin e legjislacionit, ende ka vend për përmirësime për sa i përket legjitimimit aktiv të të miturës dhe përcaktimit të një moshe minimum nën të cilën nuk mund të lejohet për asnjë arsye martesa nën moshë. Gjithashtu, shumë nga sugjerimet e përfshira në këtë dokument, mund të shoqërohen edhe me përmirësime ligjore. Mbetet ende me rëndësi përqasja me standardet ndërkombëtare të cituara në raport.

Aneks 2.4.4: Tortura ose trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese

Përmbledhje e gjetjeve nga 'Me zërat e fëmijëve të privuar nga liria' botuar në vitin 2017 nga AP, UNICEF dhe Observatori i të Drejtave të Fëmijëve.

-Vetëm një e treta e fëmijëve që morën pjesë në monitorimin e Avokatit të Popullit kishin përfunduar arsimin e tyre të detyrueshëm.

-Shumica e tyre zbulojnë historitë e varfërisë dhe përjashtimit social që i kanë sjellë ato në konflikt me ligjin.

-Stacionet e policisë nuk ofrojnë dhoma të ndara dhe të përshtatshme për të mbajtur ose intervistuar fëmijët, 43% e fëmijëve pra, pothuajse gjysma, pranojnë se janë lënduar, në stacionet e policisë.

-Vendet e paraburgimit në mënyrë të konsiderueshme kanë mungesa të personelit të mjaftueshëm për të mbështetur siç duhet fëmijët me shërbime individuale të trajtimit, rehabilitimit dhe riintegrimit.

-Higjiena, kujdesi shëndetësor dhe kujdesi psikologjik, madje edhe siguria e fëmijëve, veçanërisht në objektin Shen Koll, në Lezhë u duk problematike.

-Raporti i disponueshëm në*: http://observator.org.al/with-the-voice-of-children-deprived-of-their-liberty/*

Tabela 43: Të dhënat për kutitë e ankesave të vendosura në institucionet rezidenciale për fëmijët dhe të monitoruara nga Shërbimi Social Shtetëror (të gjitha IPS-të)

Viti	Totali i letrave të mbledhura	Letra që shprehin komente pozitive	Letra që përmbajnë kërkesa	Letra ankese
2017	51	20	14	17
2018	73	26	20	27

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Shtojca 2.5: Mjedisi familjar dhe kujdesi alternative

Shtojca 2.5.1: Fëmijët e privuar nga kujdesi familjar

Tabela 44: Numri i institucioneve sipas tipologjisë së përkujdesjes shoqërore

Institucionet	2012		2013		2014		2015		2016		2017		2018	
Publik (P) / Jopublik (JP)	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP
Shtëpia e fëmijës	9	15	9	15	9	15	9	18	9	18	8	19	9	18
Prej të cilave: Shtëpi familje	3	13	2	13	3	13	2	15	3	15	3	16	3	15
Qendra Zhvillimi Rezidenciale (PAK 0–25 vjeç)	6		6		6	5	6	5	6	5	6	5	6	5
Qendra Ditore për fëmijë me aftësi të kufizuar	8	11	8	11	8	7*	8	11	12	13	15	18	19	18
Qendra ditore për të gjithë fëmijët	7	40	4	34	4	14*	4	24	5	25	12	29	13	28

Burimi: Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

** Informacioni mungon në këtë vit për Durrësin, Tiranën dhe Elbasanin*

Tabela 45: Numri i fëmijëve sipas tipologjisë së shpërblimit të përkujdesjes shoqëror, në fund të vitit, në sistemin publik (P) dhe jopublik (JP)

Tipi i shërbimit për fëmijët	2012		2013		2014		2015		2016		2017		2018 [Gusht]	
Publik / Jopublik	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP
Shtëpia e fëmijës	266	332	306	312	246	314	223	342	179	335	189	350	213	317
Prej të cilave: Shtëpi familje	70	60	72	63	37	76	49	22	46	60	45	43	40	44
Qëndra Zhvillimi Rezidenciale (PAK 0–25 vjeç)	72		58		73		77		62		61		56	
Qëndra Ditore për fëmijë me aftësi të kufizuar	268	6757	205	4472	94**	1337**	183	2191	300	2277	459	2839	567	2751

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

**Referuar shërbimeve në qendrat ditore të mundësuara nga Qendrat e Zhvillimit në Lezhë, Shkodër, Korçë të menaxhuara nga Shërbimi Social Shtetëror*
*** Informacioni mungon në këtë vit për Durrësin, Tiranën dhe Elbasanin*

Tabela 46: Numri i fëmijëve të cilët kanë hyrë në institucionet e fëmijëve pa kujdesin prindëror të ndara sipas rastit

Viti/Rasti	**2012**		**2013**		**2014**		**2015**		**2016**		**2017**		**2018 [Maj 2018]**	
Institucion Publik / Jopublik	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP
Varfëria (Probleme socio-ekonomike)	26	25	59	17	43	16	16	21	25	44	20	30	26	5
Braktisje (fëmijë i braktisur)	29	0	41	0	29	0	20	0	17	1	19	0	7	0
Vdekja e të dy prindërve													5	
Totali	**55**	**25**	**100**	**17**	**72**	**16**	**36**	**21**	**42**	**45**	**39**	**30**	**33**	**7**

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror
** Të dhënat statistikore më të disponueshme janë në numrin e pranimeve të fëmijëve me vendim të SHSSH*

Tabela 47: Numri i fëmijëve që kthehen në familje

	2014		**2015**		**2016**		**2017**		**Gusht 2018**	
	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP	P	JP
Fëmijë në Shtëpinë e Fëmijës	38	69	36	51	49	42	32	21	11	29
Fëmijë me aftësi të kufizuara në Qendrat e Zhvillimit Rezidenciale	13		21		19	0	11		5	

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Tabela 48. Raporti ndërmjet numrit të stafit dhe përfituesve në institucionet rezidenciale për fëmijët

Institucioni	**Numri i stafit**	**Numri i përfituesve**	**Raporti**
Shtëpia e foshnjës Vlorë (0–5 vjeç)	20	17	1,17
Shtëpia e foshnjës Durrës (0–5 vjeç)	39	33	0,8
Shtëpia e foshnjës Tiranë (0–5 vjeç)	39	33	0,8
Shtëpia e foshnjës Korçë (0–5 vjeç)	14	17	0,8
Shtëpia e foshnjës Shkodër (0–5 vjeç)	14	14	1
Shtëpia e fëmijës Shkodër (6–15	24	33	0,7

vjeç)			
Shtëpia e fëmijës Tiranë (6–15 vjeç)	36	32	0,9
Shtëpia e fëmijës Sarandë (6–15 vjeç)	23	32	1,3
Shtëpia e fëmijës Shkodër (16–18 vjeç) *	14	10	

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

**Qëndra Rinore Shkodër është hapur në Tetor 2018*

Tabela 49: Numri i fëmijëve të vendosur nën kujdesin tutorial/fisnor

	2014	2015	2016		2017	2018
Fëmijë total	120	193	226		271	287
Prej të cilëve: Fëmijë me aftësi të kufizuar	22	15	13		12	24

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Grafiku 1: Numri i fëmijëve të kthyer në familje, adoptuar ose vendosur në kujdestari të përkohëshme përgjatë viteve



Grafiku 2: Alokimi i burimeve njerëzore, teknike dhe financiare në institucionet e përkujdesjes alternative



Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Shtojca 2.5.2: Adoptimi i fëmijëve

Tabela 50: Të dhëna mbi fëmijët e adoptuar

Viti	Numri total i adoptimeve të përfunduara	Numri total i adoptimeve brenda vendit	Numri total i adpotimeve jashtë vendit	Mosha dhe gjinia e fëmijës së adoptuar				Nr. i fëmijëve me nevoja të veçanta	Vendndodhja e fëmijës para adoptimit		
				<1 F/M	1–4 F/M	5–9 F/M	>10 F/M		Institucion	Kujdesi tutorial	Familja nga origjina
2012	69	42	27	4F/2M	23F/25M	2F/ 2M	3F/8M	7	55	-	14
2013	47	30	17	4F/ 8M	15F/13M	-	6F/1M	8	37	-	10
2014	67	42	25	20F/14M	12F/13M	5F/2M	1F	6	62	-	5
2015	54	28	26	16F/11M	3F/10M	4F/4M	5F/1M	3	48	-	6
2016	34	17	17	5F/6M	5F/9M	3F	5F/1M	3	29	1	5
2017	43	33	10	12F/9M	7F/4M	2F/5M	3F/1M	4	30	-	13
Gusht 2018	21	16	4	4F	3F/11M	1F/1M	1F	3	20	-	1

Burimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve

Shtojca 2.6: Aftësia e kufiuar, shëndeti dhe mirëqenia
Shtojca 2.6.1: Fëmijët me aftësi të kufizuar

Tabela 51: Numri i fëmijëve që marrin pagesa për aftësinë e kufizuar*

	Numri total i fëmijëve me aftësi të kufizuar				Numri i femrave nga totali				Sistemi arsimor që ndjekin			
					Sipas grup-moshës							
Viti	Totali	0–6 vjeç	6–15 vjeç	15–18 vjeç	Totali	0–6 vjeç	6–15 vjeç	15–18 vjeç	Totali	Parashkollor	Shkollë 9-vjeçare	Shkollë e mesme
2013	18,474	5,266	8,970	4,238	8,189	2,508	3,869	1,812	9,563	2,511	5,389	1,663
2014	17.801	4,815	8,753	4,209	8,079	2,455	3,833	1,791	9,453	2,441	5,276	1,736
2015	17,560	5,172	8,435	3,953	7,760	2,440	3,595	1,725	9,004	2,438	4,986	1,580
2016	14,742	4,148	7,056	3,538	6,271	1,874	2,875	1,522	8,568	2,062	4,827	1,679
2017	14,155	4,025	6,943	3,187	6,060	1,918	2,836	1,306	7,808	1,969	4,342	1,497

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
** Përfshihen kategoritë e mëposhtme: fëmijët me dëmtime dëgjimi, fëmijë paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike*

Shtojca 2.6.2: Kujdesi shendetsor dhe sherbimet shendetesore

Tabela 52: Shëndeti i fëmijës- treguesit kryesorë

Treguesi	Burimi	2013	2014	2015	2016	2017
Vdekshmëria foshnjore	INSTAT	7.9	7.9	7	8.7	8

Vdekshmëria amënore	MSHMS	11.8	3	10.2	3.5	10.9
Lindje të ndihmura nga staf i specializuar	MSHMS	99.98	99.98	99.98	99.98	99.98
Përqindja e fëmijëve të lindur nën-peshë	MSHMS	4.7	4.6	4	3.4	3.2

Burimi: INSTAT, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Tabela 53: Shkalla e vaksinimit të fëmijëve

Vaksinimi/Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Turbekulozi	99.7	99.7	99.7	99.7	99.2
Difteria	98.9	99	98.5	98.8	98.7
Tetanozi	98.9	99	98.5	98.8	98.7
Kolla e mirë	98.9	99	98.5	98.8	98.7
Fruthi-Shytat-Rubeola	98.6	98.7	97.6	97.8	96.3
Poliomieliti	99	99.1	97.6	98.8	98.3

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Tabela 54: Shifrat për vizitat në klinikat e Konsultorit të fëmijëve (kujdesi parësor shëndetësor)

Treguesi	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Numri i konsultoreve të fëmijës	1974	2024	2159	2095	2100
Urbane	165	176	149	154	158
Rurale	1.809	1.848	2.010	1.941	1.942
Numri i vizitave në konsultore	915.216	932.986	943.759	990.563	929.330
Nga këto: sa nga mjeku	511.735	542.490	530.701	501.523	534.059

Burimi: Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Shtojca 2.6.3: Ushqyerja e fëmijës dhe ushqyerja ekluzive me gji

Tabela 55: Ushqimi i foshnjave vetëm me gji (0–6 muaj)

Treguesi	përkufizimi	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
% e fëmijëve që ushqehen vetëm me gji	Nr. i fëmijëve që ushqehen vetëm me gji si përqindje ndaj lindjeve të regjistruara në konsultoret e fëmijëve	82	82	83	78.6	78.4

Burimi: Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Studime të kryera nga Instituti i Shëndetit Publik mbi Ushqyerjen

1. Vlerësimi i obezitetit në moshën fëminore (2012–2013 dhe 2015–2016)

E njëjta qasje metodologjike u ndërmor për të dyja studimet, duke siguruar të dhëna në seri mbi temaitkën për fëmijët e moshës 8–9-vjeçare. Gjetjet kryesore janë si më poshtë:

-Djemtë dhe vajzat kanë të njëjtat trend të mbipeshës dhe obezitet si fëmijët në vendete e Evropës perëndimore.

-Krahasimi i të dhënave tregon se ka një trend të uljes së mbipeshës nga 22.4% në 2013 krahasuar me 21.7% në 2016; gjithsesi, vihet re një trend rritjeje i obezitetit - 9.2% në 2016 krahasuar me 7.9 në 2013.

-Ndër vite, vajzat janë përmirësuar më mirë sesa djemtë. Krahasuar me vitin 2013, rastet e mbipeshës janë paksa më të ulëta sesa të djemve; gjithsesi, obeziteti është në nivele më të larta (12.3% në 2016 krahasuar me 9.9 në 2013).

-Prevalenca e obezitetit lidhet me peshën në lindje – djemtë dhe vajzat lindur me peshë të vogël kanë më tepër shance për të pasur mbipeshë dhe obezitet.

-Niveli i ushqyerjes me gjë raportohet më i ulët sesa tek Studimi Demografik dhe Shëndetësor në 2009.

-Studimi është publikuar në link-et më poshtë:

http://www.ishp.gov.al/multimedia/Vleresimi_%20i_%20Obezitetit_%20ne_%20moshen_feminore_V2.pdf

http://ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/RAPORTI-OBEZITETI-TEK-FEMIJET.pdf

2. Vlerësimi i gjendjes së jodit në popullatën shqiptare pas përmirësimit të profilaksisë së pamjaftueshmërisë jodike – Studim Kombëtar me 1027 fëmijë të moshës 6–13 vjec (2014)

Shqipëria rezulton me një pamjaftueshmëri jodike të lehtë (mediana e jodit në urinë 86,2µg/L), por 28.9% e fëmijëve të marrë në studim kanë një përqëndrim të jodit në urinë midis 50–99µg/L, 19.9% kanë një përqëndrim të jodit në urinë 20–49µg/L dhe 6.8 % e tyre <20µg/L. Zona e brendshme në fshat paraqet një pamjaftueshmëri jodike të ndjeshme në raport me yonat e tjera. Situata në yonat bregdetare paraqitet më e mirë. Rreth 10.5 % e fëmijëve rezulton të kenë përqëndrime të jodit në urinë të rendit 200–299µg/L.

3. Studimi mbi kornizën rregullatore dhe politikat mbështetëse për një program kombëtar multi-sektorial të ushqyerjes në shkolla (Maj- Korrik 2017)

Tabela 56: Gjetjet Kryesore

Fusha	**Ndërhyrjet e propozuara**	**Pikat e dobëta/risqet**
Ndërhyrjet në legjislacionin primar		
Amendime të ligjit aktual të Kujdesit Shëndetësor në Shqipëri	Amendim i ligjit aktual për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe përfshirja e dispozitave ku përcaktohet roli i shërbimit shëndetësor në shkolla. Rekomandohet të shtohet një nen i veçantë pas nenit 17, me përmbajtjen.	Meqenëse shërbimi shëndetësor në shkolla nuk ka të njëjtën mënyrë organizimi dhe funksionimi në të gjithë Shqipërinë, vihet në rrezik zbatimi i njëjtë i tij.
Ndërhyrjet në legjislacionin sekondar		
Marrëveshjet e bashkëpunimit	Përditësim/rifreskim i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve në të cilën të specifikohen rolet dhe përgjegjësitë e të dyja institucioneve lidhur me futjen e ushqimit në shkolla.	

Urdhri i ministrit të Shëndetësisë	Përditësimin e Rregullores së shërbimit shëndetësor në shkolla, e cili do të specifikojë rolin dhe përgjegjësitë e stafit shëndetësor në shkolla dhe kontributin që ata mund të japin në ushqyerjen e shëndetshme.	Shërbimi shëndetësor në shkolla ka staf të dedikuar vetëm në qytetin e Tiranës dhe Durrësit. Ky shërbim në qytetet e tjera mbulohet nga punonjësit e promocionit shëndetësor dhe ata të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor në DSHP. Rrjedhimisht, ky shërbim nuk ofrohet njësoj në të gjithë Shqipërinë, çka e vështirëson funksionin monitories të përditshëm.
Urdhri i ministrit të Shëndetësisë	Përditësimin e Standardeve higjeno-sanitare të shkollave, si një mjet i domosdoshëm për monitorimin e mjediseve që do të ofrojnë shkollat për konsumimin e vakteve ushqimore.	Roli monitorues mund të konfondojë rolin e Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror.
Urdhri i ministrit të Shëndetësisë	Hartimi i standardeve kombëtare nutricionale për vaktet që ofrohen në shkollë sipas grup-moshave të ndryshme.	

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

4. Studimi mbi sjelljet e shëndetshme te fëmijët e shkollës 11, 13, 15 vjeç - HBSC (2013 dhe 2014)

Studimi është kryer në nivel kombëtar dhe përfshiu rreth 4898 nxënës (2507 vajza dhe 2391 djem) të moshave 11, 13 dhe 15 vjeç, që ndjekin shkollën. Ky studim fokusohet në sjelljet që ndikojnë në shëndetin e adoleshentëve.

Zakonet e të ushqyerit

- 43,7% e fëmijëve 11–15 vjeç që ndjekin shkollën konsumojnë mëngjes çdo ditë të javës. Vajzat konsumojnë më pak mëngjes krahasuar me djemtë.
- Një në dy fëmijë të moshës 11–15 vjeç konsumon fruta *çdo ditë,* dhe një në tre fëmijë konsumon fruta *më shumë se një herë në ditë.*
- Një në tre fëmijë konsumon perime *çdo ditë,* dhe një në katër fëmijë konsumon perime *më shumë se një herë në ditë.*
- Vajzat konsumojnë më shumë fruta dhe perime krahasuar me djemtë.
- Vajzat konsumojnë më shumë ëmbëlsira, ndërsa djemtë më shumë pije që përmbajnë sheqer.

Aktiviteti fizik dhe jeta sedentare

- 74.2% e fëmijëve 11–15 vjeç janë përfshirë në aktivitet fizik gjatë 3 ditëve të fundit të shkollës.
- Djemtë (82%) kryejnë më shumë aktivitet fizik *mbi 3 herë në javë* krahasuar me vajzat (70%).
- Tre në katër fëmijë të moshës 11–15 vjeç shpenzojnë *dy ose më shumë orë* në fundjavë duke parë televizor apo video.
- Djemtë luajnë lojëra në kompjuter më shumë se vajzat, si gjatë fundjavës ashtu edhe gjatë ditëve të javës.

Sjelljet që kontrollojnë peshën trupore. Imazhi trupor dhe Indeksi i Masës Trupore

- 6.7% e fëmijëve 11–15 vjeç janë në dietë për të rënë në peshë.
- Proporcioni i vajzave që kanë vetëperceptim negativ për peshën e tyre dhe/ose mbajnë dietë është më i lartë në krahasim me meshkujt (7.9% vs. 5.6%).
- 70.2% e fëmijëve 11–15 vjeç që ndjekin shkollën janë me peshë normale kundrejt 3.2% të klasifikuar si obezë.

- Krahasuar me djemtë, vajzat janë më shumë nënpeshë (8.7% vs.7%).
- Fëmijët 11- vjeçarë raportojnë më shumë nënpeshën, mbipeshën dhe obezitetin krahasuar me 13 dhe 15-vjeçarët.
- Vajzat tentojnë më shumë të raportojnë peshë normale krahasuar me djemtë.

Publikimi gjendet tek:
http://www.ishp.gov.al/wpcontent/uploads/2015/raporte/HBSC_EN.pdf

Shtojca 2.6.4: Shëndeti i Adoleshentëve

Gjetjet nga studimi i Institutit të Shëndetit Publik mbi sjelljen e shëndetshme tek fëmijët e shkollës 11, 13, 15 vjeç (2013/2014)

Mjedisi familjar

- Në përgjithësi, fëmijët raportuan më shumë lehtësi në komunikim me nënat (61.7%) në krahasim me baballarët e tyre (37.4%).
- Me rritjen e moshës, për të dyja gjinitë, vërehet se komunikimi me shumë lehtësi vjen duke u zvogëluar si për nënën dhe për babanë.
- Shumica e nxënësve e shohin familjen si një mjedis shumë të rëndësishëm për të diskutuar gjërat e rëndësishme (75%) apo për të sqaruar të gjitha keqkuptimet (67%) midis anëtarëve të familjes.

Cilësia e komunikimit dhe mbështetja e familjes

- Pjesa dërrmuese e fëmijëve 11–15 vjeç që ndjekin shkollën, mendojnë se mund të mbështeten tek familja e tyre për t u ndihmuar (83%), për të marrë vendime (80%), për t'u mbështetur emocionalisht (74%) dhe për të folur për problemet e tyre (68%).

Pëlqyeshmëria e shkollës

-61.9% e fëmijëve të moshës 11, 13 dhe 15 e pëlqenin shumë shkollën krahasuar me 2.4% nuk e pëlqenin aspak. Djemtë kishin më pak gjasa ta pëlqenin shkollën krahasuar me vajzat (58% vs. 66% respektivisht).

Performanca në shkollë

- 57.1% e fëmijëve të moshës shkollore 11, 13 dhe 15 vjeç raportojnë një performancë shumë të mirë në shkollë, kundrejt 1.7% që raportojnë performancë nën mesatare.
- Vajzat raportojnë më shumë performancë shumë të mirë (66% vs. 48%) në shkollë kurse djemtë raportojnë më shumë performancë nën mesatare (2.5% vs. 1.1%).

Marrëdhëniet midis bashkëmoshatarëve

- 42% e fëmijëve 11,13,15 vjeç kanë kontakte të përditshme me shokët e tyre (47.6% djem dhe 36.7% vajza), dhe kjo dukuri është më e shprehur tek 15-vjeçarët.
- Djemtë (25%) kanë më shumë gjasa se vajzat (7%) të takojnë shokët pas orës 8 të mbrëmjes, dhe kjo dukuri ndodh më shpesh për nxënësit e moshës 15 vjeç.
- Lidhur me komunikimin e përditshëm elektronik, 40.6% e nxënësve raportuan se komunikonin me shokët nëpërmjet mesazheve të çastit, (p.sh. chat në Facebook); 32% raportuan se komunikonin nëpërmjet SMS-ve; 25.3% nëpërmjet e-mailit dhe 30% nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit elektronik, duke përdorur media sociale, si Facebook, (duke postuar në mur, jo nëpërmjet chat-it), My Space, Twitter, Apps (p.sh. histagram), lojëra (p.sh. Xbox), YouTube etj.
- Djemtë raportuan shifra më të larta të komunikimit elektronik, krahasuar me vajzat
- Shumica e fëmijëve (73%) raportuan se kanë shokë me të cilët mund të ndajnë gëzime dhe hidhërime, ndërsa vajzat kanë më shumë besim se djemtë për të pasur shokë dhe miq të tillë (76% vs. 69%).

Larja e dhëmbëve

- Rreth 55% e fëmijëve të moshës 11, 13, 15 vjeç deklaruan se i lanin dhëmbët më shumë së një herë në ditë.
- Krahasuar me djemtë, vajzat raportuan se i lanin dhëmbët më shumë se një herë në ditë më shpesh se djemtë (65% vs. 44.7%)

- Nga ana tjetër, u konstatua se rreth 59% e nxënësve që hanin mëngjes rregullisht (në të shtatë ditët e javës) i lanin dhëmbët më shumë se një herë në ditë, krahasuar me 49% të tyre që nuk hanin mëngjes asnjëherë

Mirëqenia dhe shëndeti

- 50% e nxënësve të moshës 11, 13, 15 vjeç, apo një në dy nxënës, raportuan një gjendje të shkëlqyer shëndetësore, ndërsa vetëm 5% e nxënësve deklaruan se gjendja e tyre shëndetësore ishte e keqe. Përgjithësisht djemtë shprehen më pozitivisht për shëndetin e tyre krahasuar me vajzat, ndërkohë që kjo ndodh më shumë në moshë më të vogël

Ankesat shëndetësore

- Të paktën një herë në muaj, 40.5% e nxënësve të moshës 11, 13, 15 vjeç raportuan se kishin dhimbje koke, 22.4% e tyre kishin dhimbje stomaku, dhe 27.3% kishin dhimbje shpine.

- Lidhur me komponentët e shëndetit mendor, të paktën një herë në muaj 45.3% të nxënësve raportuan se kishin prishje të humorit ose irritim, 47.6% se ishin nervozë dhe 24.2% se kishin çrregullime apo probleme të lidhura me gjumin.

-Krahasuar me 11-vjeçarët, fëmijët 15-vjeçarë dhe vajzat raportojnë më shumë ankesat e mësipërme

Pabarazitë sociale

- Perceptimet e Pasurisë së Familjes

- Rreth 24% e baballarëve dhe 59% e nënave të fëmijëve 11,13,15 vjeç që ndjekin shkollën, që jetojnë me të dy prindërit, janë të papunë.

- Një në dy fëmijë 11,13,15 vjeç që ndjekin shkollën raportojnë se gjendja ekonomike e familjeve të tyre është mesatare; rreth një në tre fëmijë raportojnë një nivel të mirë të të ardhurave dhe (14.5%) të nxënësve që deklaruan se kishin një gjendje ekonomike të keqe në familjet e tyre

- Një në dy fëmijë 11,13,15 vjeç që ndjekin shkollën kanë në shtëpi një kompjuter.

- 8% e nxënësve 11,13,15 vjeç raportuan se ishin të paktën një herë të uritur para se të flinin në darkë ose kur shkojnë në shkollë, kundrejt 92% që nuk ishin kurrë. Nuk kishte dallime moshore ndërkohë që djemtë kishin më shumë gjasa të shkonin në shtrat të uritur krahasuar me vajzat

Marrëdhëniet seksuale

- 19.5% e nxënësve të moshës 15 vjeç raportuan se kishin 63 kryer marrëdhënie seksuale (95% djem dhe 5% vajza). Moshat më të shpeshta të fillimit të kryerjes së marrëdhënieve seksuale ishin moshat 14 vjeç dhe 15 vjeç

Përdorimi i kontraceptivëve

-Nga të rinjtë që kanë kryer marrëdhënie seksuale, 63.7% e tyre përdorin kontraceptivë gjatë marrëdhënieve seksuale. 66% e djemve dhe 40% e vajzave raportuan se kishin përdorur kondom në marrëdhënien e fundit seksuale. Metodat e tjera kontraceptive nuk ishin shumë të përdorshme nga të rinjtë

Cyberbulling

- Rreth 7% e nxënësve raportuan se ishin nëpërkëmbur nëpërmjet mesazheve apo fotove të ndryshme. Në të gjitha rastet, djemtë rezultuan se ishin nëpërkëmbur më shumë sesa vajzat

Dëmtimet

- 35% e nxënësve raportuan se gjatë vitit të fundit ishin dëmtuar të paktën një herë, aq sa të kishin nevojë për ndihmë mjekësore, 11% e të cilëve kërkuan ndërhyrje të rëndësishme mjekësore deri në hospitalizim. Mjedisi rreth shtëpisë (11%), ambientet sportive (8%) dhe rruga (4%) ishin mjediset më të shpeshta ku kishin ndodhur dëmtimet (grafiku 28). Rreth 14% e nxënësve ishin dëmtuar gjatë stërvitjes, kurse 7% e tyre ishin dëmtuar duke ecur në rrugë. Në të gjitha rastet kishte dallime të rëndësishme gjinore, ku djemtë rezultonin më të dëmtuar se vajzat.

Gjetjet nga studimet e Institutit të Shëndetit Publik mbi përdorimin e alkoolit, duhanit dhe drogave.

Studimi mbi sjelljet e shëndeteshme tëk fëmijët e shkollës 11, 13, 15 vjeç - HBSC (2013 dhe 2014)

Duhan pirja:

Afërsisht një në dhjetë fëmijë 11,13,15 vjeç që ndjekin shkollën kanë provuar duhanin, dhe 2.6% deklaruan se pinin aktualisht duhan me raste ndërsa 1.7% raportuan se pinin aktualisht duhan në mënyrë të rregullt. Kishte një diferencë gjinore midis konsumatorëve aktualë të duhanit (ku 2.6% ishin djem dhe 0.8% vajza). Këto shifra vinin duke u rritur me rritjen e moshës; 1.1% e nxënësve 11-vjeçarë ishin konsumatorë aktualë të duhanit, krahasuar me 1.2% të 13-vjeçarëve dhe 2.6% të 15-vjeçarëve

Konsumi i alkoolit

11.2% nxënës të 11, 13 dhe 15 moshës deklaruan se kishin pirë alkool me raste, ndërsa 13.4% raportuan të kishin pirë alkool rregullisht. Lidhur me sasinë e alkoolit të konsumuar në një ditë tipike, 1.4% nxënës raportuan që konsumonin të paktën 5 njësi alkool (pesë pije), ndërkohë që 13.5% nxënës deklaruan se konsumonin vetëm një njësi alkool.

Përdorimi i kanabisit:

Nga nxënësit 15-vjeçarë që u përfshinë në këtë pyetje, vetëm 5.7% e tyre deklaruan se kishin konsumuar kanabis të paktën një herë gjatë gjithë jetës së tyre, ndërsa 2.3% e tyre deklaruan se kishin konsumuar kanabis të paktën një herë gjatë 30 ditëve të fundit (para intervistës). Gjatë analizës u konstatua një diferencë gjinore në konsumin e kanabisit (të paktën një herë gjatë jetës), ku djemtë raportuan një shpeshtësi më të lartë se vajzat (10.5% vs.1.4% respektivisht).

Studimi Evropian mbi përdorimin e alkoolit dhe drogave të tjera midis të rinjve në Shqipëri 2015 – ESPAD

Konsumi i duhanit

• Rreth një e treta (34.9%) e pjesëmarrësve kanë konsumuar duhan të paktën një herë në jetën e tyre. Prevalenca e konsumit të duhanit gjatë jetës është në mënyrë domethënëse më e lartë tek djemtë sesa vajzat (47.1% vs. 24.8%, përkatësisht), tek shkollat private (44.4%) sesa publike (33.6%), shkollat urbane sesa rurale (38.9% vs. 25.6%, përkatësisht) dhe tek shkollat tekniko-profesionale (61%). Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re një ulje e prevalencës së duhanpirjes gjatë jetës në tërësi me 4.8 pikë përqindje dhe për çdo grup në studim, me përjashtim të shkollave profesionale. Ulja midis vajzave ishte më e vogël sesa midis djemve.

• Rreth 5.4% e nxënësve kanë përdorur duhanin në 40 ose më shumë raste gjatë jetës së tyre dhe proporcione në mënyrë domethënëse më të larta të djemve raportojnë këtë sjellje krahasuar me vajzat. Përqindje më të larta të nxënësve në shkollat tekniko-profesionale, shkollat private dhe shkollat urbane raportuan të kenë përdorur duhan në 40 ose më tepër raste gjatë gjithë jetës krahasuar me kolegët e tyre. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u reduktua përqindja e djemve që kanë konsumuar 1–39 herë duhan në jetë, por u rrit lehtë përqindja e vajzave që kanë konsumuar 20–39 dhe 40+ herë duhan në jetë (rritje në rendin e 0.1–0.4 pikë përqindje).

• Afërsisht një në dhjetë nxënës (10.6%) kanë konsumuar të paktën një cigare gjatë muajit të fundit (17.4% e djemve dhe 5.0% e vajzave), një ulje prej 2.2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2011. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 prevalenca e duhanpirjes gjatë muajit të fundit u reduktua më shumë tek djemtë (4.2 pikë përqindje) sesa tek vajzat (0.7 pikë përqindje), në Tiranë (me 4.5 pikë përqindje) dhe në klasat e 9–ta (me 3.3 pikë përqindje). Prevalenca e konsumimit e të paktën një cigareje në ditë ishte 5% (krahasuar me 5.5% në 2011) dhe sërisht më tepër djem sesa vajza ishin konsumues ditorë të duhanit.

Konsumi i Alkoolit

• Pothuajse dy në tre nxënës (65.7%) kishin konsumuar një ose më shumë pije alkoolike të paktën në një rast gjatë jetës (krahasuar me 72.4% në vitin 2011). Prevalenca e konsumit të alkoolit të paktën një herë në jetë rezultoi në mënyrë domethënëse më e lartë tek djemtë, nxënësit e shkollave social-kulturore dhe tekniko-profesionale, shkollat private dhe ato në zonat urbane. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re një ulje e prevalencës së konsumit të alkoolit të paktën një herë në jetë për çdo grup në studim. Më pak se një në dhjetë nxënës (8.2%) kanë përdorur alkool në 40+ raste gjatë jetës (krahasuar me 7.8% në vitin 2011). Konsumi i shpeshtë i alkoolit (40 raste ose më shumë gjatë jetës) u raportua nga 12.5% e djemve dhe 4.6% e vajzave

(krahasuar me 13.4% dhe 3.4% në vitin 2011, përkatësisht). Vihet re që ky indikator është rritur tek vajzat por është ulur tek djemtë në vitin 2015. Prevalenca e konsumit të shpeshtë të alkoolit (≥40 herë në jetë) është në mënyrë domethënëse më e lartë tek djemtë, nxënësit e shkollave teknikoprofesionale, në shkollat private dhe shkollat e zonave urbane. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 në përgjithësi ky indikator është ulur vetëm tek djemtë, nxënësit e gjimnazeve, shkollave private dhe nxënësit e Tiranës por është rritur në të gjithë grupet e tjera. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 rritja ishte më e madhe tek nxënësit e shkollave tekniko profesionale (me 2.3 pikë përqindje), vajzat dhe nxënësit e shkollave social-kulturore (me 1.2 pikë përqindje secila)

• Prevalenca e konsumimit të alkoolit të paktën një herë gjatë 12 muajve të fundit ishte 51.3% (krahasuar me 52% në vitin 2011). Në mënyrë domethënëse më shumë djem (64%) sesa vajza (41.1%,) konsumuan pije alkoolike të paktën në një rast gjatë vitit të fundit. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re një ulje e prevalencës së konsumit të alkoolit të paktën një herë gjatë vitit të fundit tek vajzat, klasat e 9–ta, gjimnazet dhe shkollat tekniko-profesionale, shkollat private, ato rurale dhe shkollat e Tiranës dhe rritje në grupet e tjera.

• Më pak se një e treta e nxënësve (30.6%) konsumuan të paktën një pije alkoolike gjatë 30 ditëve të fundit nga momenti i kryerjes së studimit (30.8% në vitin 2011). Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re rritja e konsumit të alkoolit gjatë muajit të fundit tek djemtë, nxënësit e shkollave tekniko-profesionale dhe nxënësit e rretheve të tjera përveç Tiranës kurse në grupet e tjera ky indikator u reduktua.

• Prevalenca e konsumimit të birrës, verës dhe pijeve alkoolike të forta gjatë 30 ditëve të fundit ishte 39.6% për birrën (41.5% në 2011), 32.7% për verën (33% në 2011) dhe 21.4% për pijet alkoolike të forta (20.1% në 2011). Në mënyrë domethënëse më shumë djem konsumuan birrë, verë dhe pije alkoolike të forta gjatë muajit të kaluar krahasuar me vajzat (birrë: 51.6% vs. 29.8%, përkatësisht; verë: 36.4% vs. 29.6%, përkatësisht; pije alkoolike të forta: 29.5% vs. 14.9%, përkatësisht). Prevalenca e konsumimit të birrës, verës dhe pijeve alkoolike të forta ishte më e lartë në Tiranë krahasuar me gjithë rrethet e tjera, më e lartë midis nxënësve të shkollave urbane dhe atyre që studiojnë në shkollat private.

• Një në gjashtë nxënës (16.7%) raportoi që rasti i fundit gjatë të cilit kanë konsumuar alkool ishte brenda 7 ditëve të kaluara nga momenti i studimit (krahasuar me 17.4% në vitin 2011), dhe në mënyrë domethënëse më shumë djem e raportuan këtë krahasuar me vajzat. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 prevalenca e konsumit të alkoolit gjatë javës së fundit u rrit tek vajzat, shkollat social-kulturore dhe në shkollat e rretheve të tjera përveç Tiranës, ndërsa u ul ose nuk ndryshoi në grupet e tjerë në studim.

• Gjatë rastit të fundit të konsumimit të alkoolit 45.8% e nxënësve përdorën birrë, 18.8% përdorën verë dhe 9.5% përdorën pijet alkoolike të forta. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 është rritur prevalenca e nxënësve që kanë konsumuar birrë gjatë rastit të fundit të konsumimit të pijeve alkoolike (me 9.4 pikë përqindje në total dhe me 10.3 pikë përqindje tek djemtë dhe 8.5 pikë përqindje tek vajzat) por është ulur prevalenca e nxënësve që kanë konsumuar verë ose pije alkoolike të forta.

• Lidhur me moshën e fillimit të përdorimit të alkoolit, më shumë djem sesa vajza e filluan atë në mosha më të reja për çdo tip të pijeve alkoolike. Rreth 12.6% e nxënësve raportuan të kishin provuar birrë për herë të parë në moshën 9 vjeç ose më pak (17.3% e djemve dhe 8.8% e vajzave) [krahasuar me 14.5% të nxënësve në 2011: 21.6% e djemve dhe 8.9% e vajzave].

Konsumi i drogave

• Më shumë se një në njëzet nxënës (6.6%) kanë provuar mariuanën të paktën një herë në jetë (krahasuar me 4.4% në vitin 2011). Prevalenca e konsumit të mariuanës të paktën një herë në jetë rezultoi më e lartë tek djemtë, shkollat tekniko-profesionale dhe socialkulturore, shkollat private, shkollat urbane dhe shkollat e Tiranës. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re një rritje e prevalencës së konsumit të mariuanës të paktën një herë në jetë me 2.2 pikë përqindje në tërësi (nga 4.4% në 6.6%) dhe për çdo grup në studim (rritja ishte më e madhe tek nxënësit e shkollave

tekniko-profesionale (me 7.8 pikë përqindje), nxënësit e shkollave private (me 3.8 pikë përqindje) dhe tek djemtë (me 3.5 pikë përqindje).

• Prevalenca e përdorimit të mariuanës të paktën një herë gjatë 12 muajve të fundit ishte 5% (krahasuar me 3.7% në vitin 2011) dhe më shumë djem sesa vajza e raportuan këtë (6.5% dhe 1.4%, përkatësisht). Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re një rritje e prevalencës së konsumit të paktën një herë të mariuanës gjatë vitit të fundit për çdo grup në studim. Rritja ishte më e madhe tek nxënësit e shkollave tekniko-profesionale (me 5.7 pike përqindje) dhe ato social-kulturore (me 2.6 pikë përqindje), nxënësit e shkollave private (me 2.4 pikë përqindje) dhe tek djemtë (me 2.2 pikë përqindje)

• Prevalenca e përdorimit të mariuanës të paktën një herë gjatë 30 ditëve të fundit ishte 3.5% (krahasuar me 2.2% në vitin 2011) dhe sërish në mënyrë domethënëse më shumë djem sesa vajza e raportuan këtë (6.4% vs. 1.2%, përkatësisht).

• Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re një rritje e konsiderueshme e përqindjes së nxënësve që mendojnë se mund të gjejnë lehtë apo shumë lehtë mariuanë nëse do të donin, në tërësi me 9.4 pikë përqindje (nga 11.8% në 21.2%) dhe për çdo grup në studim. Konsumi i substancave të tjera psikoaktive

• Rreth 15.3% e nxënësve të klasave të 9–ta dhe të 10–ta raportuan të kishin provuar minimalisht një lloj droge të paligjshme të paktën një herë gjatë gjithë jetës (përfshirë mariuanën, sedativët pa recetë mjekësore, alkoolin të kombinuar me pilula dhe medikamentet kundër dhimbjes). Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2015 u vu re një rritje e prevalencës së konsumit të të paktën një lloj droge ilegale të paktën një herë në jetë me 1.8 pikë përqindje në tërësi (nga 13.5% në 15.3%) dhe për çdo grup në studim.

• Prevalenca gjatë gjithë jetës e përdorimit të sedativëve pa recetë mjekësore ishte 7.2% (krahasuar me 7.1% në vitin 2011) dhe më tepër vajza sesa djem e raportuan këtë (7.7% dhe 6.4%, përkatësisht). Kokaina është droga e dytë më prevalente e përdorur nga nxënësit e klasave të 9–ta dhe të 10–ta në vitin 2015 (në vitin 2011 vendin e dytë e zinte ecstasy) ku 3.7% e tyre e raportuan këtë (nga 1.6% në vitin 2011).

• Në vendin e tretë renditen inhalantët me 3.5% (krahasuar me 2.7% në vitin 2011). Medikamentet kundër dhimbjes dhe alkooli i përzier me pilula zënë vendin e 4–t dhe të 5– të përkatësisht me 3.3% dhe 2.7% kurse ecstasy ka zbritur në vendin e 6–të me 2.4%.

• Konsumi gjatë jetës i drogave ilegale varionte mjaft midis djemve dhe vajzave. Në pothuajse të gjitha rastet proporcione në mënyrë domethënëse më të mëdha të djemve kanë përdorur drogat e paligjshme krahasuar me vajzat. I vetmi përjashtim ka të bëjë me përdorimin e sedativëve ose qetësuesve pa recetë mjekësore që u raportua nga përqindje më të larta të vajzave sesa djemve.

• Në të gjitha rastet prevalenca e përdorimit të kokainës, heroinës dhe amfetaminave gjatë gjithë jetës ishte në mënyrë domethënëse më e lartë midis djemve sesa midis vajzave.

Shëndeti mendor

Tabela 57: Vizita në Qendrën Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve (për fëmijët deri në 6 vjeç)

Viti	Vizita spitalore	Vizitat ambulatore
2013	669	332
2014	758	349
2015	773	339
2016	662	285
2017	957	295

Burimi: Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Tabela 58: Vizitat ambulatore për shëndetin mendor në polikliniat rajonale

Vizita	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Vizita totale	38,651	40,334	39,473	42,504	54,212
Vetëm për 0–14 vjeç	5,328	4,969	4,533	4,167	6,650

Burimi: Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Tabela 59: Vizitat spitalore për shëndetin mendor në spitale (niveli terciar)

Viti	Grup-moshat				Totali
	0–1 vjeç	**1–4 vjeç**	**5–14 vjeç**	**15–24 vjeç**	
2013	12	51	144	493	**700**
2014	12	47	139	422	**620**
2015	10	439	313	347	**1,109**
2016	6	26	145	417	**594**
2017	12	376	373	441	**1.202**
Totali	**52**	**939**	**1.114**	**2120**	**4,225**

Burimi: Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Shtojca 2.6.5: HIV/AIDS

Tabela 60: Numri i rasteve të reja në vit me HIV (≤ 15 vjeç)

Viti	1997	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Numri i rasteve të reja	1	4	1	3	4	4	1	2	1	3
Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Tot			
Numri i rasteve të reja	4	6	5	1	1	1	42			

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Shtojca 2.6.6: Standardi i jetesës

Tabela 61: Numri i familjeve me fëmijë deri në moshën 18 vjeçare që marrin ndihmë ekonomike

2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
74,215	77,172	42,242	43,940	59,915	60,345	36,711

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Shtojca 2.7: Arsimi, koha e lire dhe aktivitetet kulturore
Shtojca 2.7.1: Të dhëna të përgjithshme mbi arsimin

Tabela 62: Numri i nxënësve dhe studentëve të regjistruar në arsim

Niveli ISCED	Shkolla/ Viti akademik	2012–12	2013–14	2014–15	2015–16	2016–17
1–8	Totali	719,509	704,782	665,994	622,156	596,624
	Në arsimin bazë					
1	Në fillore	198,897	195,720	188,371	179,564	174,836

2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	191,940	181,354	175,037	163,935	153,264
3	Në arsimin e mesëm:					
	Në gjimnaz	130,137	124,619	112,775	104,952	101,995
	Në profesional	24,288	27,318	27,267	25,428	25,119
4	Në arsimin pas të mesme jo të lartë	1,686	1,952	2,017	1,521	1,803
6+7+8	Në arsimin e lartë	172,561	173,819	160,527	146,756	139,607

Burimi: INSTAT, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Shënim: Niveli i arsimit i referohet klasifikimit ISCED 2011

Tabela 63: Raporti i regjistrimit bruto-GER, sipas nivelit të arsimit

Niveli ISCED	Shkolla/ Viti akademik	2012–13	2013–14	2014–15	2015–16	2016–17
	Fëmijë në arsimin parashkollor	79.5	80.1	82.3	83.3	81.5
1	Nxënës në fillore	99.8	102.7	103.7	103.0	104.0
2	Nxënës në ciklin e lartë të arsimit bazë	103.1	101.7	102.2	100.6	96.7
3	Nxënës në arsimin e mesëm	95.5	100.0	96.9	93.2	94.7
6+7+8	Studentë në arsimin e lartë	63.1	64.1	60.5	56.8	56.0
